



Strategjia Rajonale e Zhvillimit

Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit

Qarku Lezhë



Strategjia Rajonale e Zhvillimit

Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit

Qarku Lezhë
2005

Përgatitja e kësaj strategjia u drejtua nga:

Bardh Rica, Llesh Hila, Bardhok Ndreca, Dylbere Meshi,
Nikoleta Marku dhe Ndrece Gjini

Në bashkëpunim të ngushtë me:

Drejtorinë e Zhvillimit dhe të Programimit, Drejtoria Rajonale e Shërbimeve, Drejtoria e Personelit dhe Bruimeve Njerëzore, Drejtoria e Ligjeve dhe Punëve të Jashtme, Drejtoria e Financës, Drejtoria e Urbanistik, Zyra e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, Zyra për Marrëdhëniet me Publikun dhe Median, Drejtoritë e Arsimit, Drejtoria e Bujqësisë, Drejtoritë e Shëndetit Publik, Drejtoritë e Shërbimit Pyjor, Zyra Rajonale e Ndihmës Ekonomike, Zyra Rajonale e Punës, Agjencia Rajonale e Mjedisit, Administrata e Prefekturës, Bashkive dhe Komunave të Qarkut.

si dhe:

Pashk Biba, Pashk Gjoka, Linda Maçi, Aleksander Selala,
Vitore Isufi, Shan Gerdhati, Martin Dedaj, Ndue Kaza,
Zef Gjoni, Fatmir Dushku, Bardhok Frroku, Zef Vokri,
Jak Gjini

Përgatitja e strategjisë u realizua me ndihmën e:



Qendra Rajonale e Mjedisit (REC)
për Evropën Qendrore dhe Lindore
Zyra në Shqipëri

Për më shumë informacion, ju lutemi të kontaktoni me:
Drejtorinë e Programimit dhe Zhvillimit
Këshilli i Qarkut Lezhë
Tel/Faks: +355 215 2470

REC Shqipëri
Rr. Durrësit, P. 11/2, Ap 12, Tiranë
Tel/Fax: +355 4 239 444
E-mail: rec@albania.rec.org
Internet: <http://albania.rec.org>

dhe:

UNDP Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 4 233122
E-mail: registry.al@undp.org

Ky dokument gjendet elektronikisht në:
<http://www.undp.org.al> dhe
<http://www.regions.org.al> (zgjidh Lezha)

Redaktor i gjuhës shqipe
Alken Myftiu

Hyrje

Këshilli i Qarkut të Lezhës, si nivel i dytë i qeverisjes vendore, në aktivitetin e tij, që nga krijimi e në vijim, ka patur dhe ka si prioritete kryesore:

- hartimin e politikave rajonale të zhvillimit dhe harmonizimin e tyre me politikat kombëtare.
- evidentimin dhe promovimin e vlerave më të spikatura të rajonit në tërësi dhe pjesëve përbërëse të tij në veçanti.
- Zhvillimin aktual dhe perspektiv të rajonit, duke shfrytëzuar me efektivitet, burimet natyrore e njerëzore të shumta si dhe kontributin e donatorëve dhe aktorëve të tjerë të interesuar.

Hartimi i Strategjisë së Zhvillimit Rajonal të qarkut Lezhë, përbën një arritje të rëndësishme tonën dhe njëherësh një shërbim të vyer ndaj banorëve të këtij rajoni e më gjerë.

Ky dokument i rëndësishëm, u realizua falë një bashkëpunimi, kontributi dhe angazhimi maksimal të kapaciteteve teknike, administrative, profesionale, intelektuale, qytetare dhe njerëzore të rajonit të Lezhës dhe të një ekspertize të kualifikuar të UNDP dhe REC, që asistuan hartimin dhe përgatitjen e këtij dokumenti.

Administrata e Këshillit të Qarkut Lezhë dhe veçanërisht Drejtoria e Programim - Zhvillimit kanë dhënë një kontribut të admirueshëm, në mbarëvajtjen e këtij procesi.

Gjithashtu, kanë ndihmuar me kontributin e tyre drejtuesit e njësive vendore, administratat e tyre, si dhe drejtuesit dhe administratat e tjera vendore dhe rajonale.

Të gjithë aktorët e përfshirë në procesin e hartimit të Strategjisë së Zhvillimit Rajonal të Qarkut të Lezhës, meritojnë vlerësime të sinqerta për bashkëpunimin dhe kontributin e tyre.

Strategjia e Zhvillimit Rajonal të Qarkut të Lezhës, përbën në vetvete, një dokument të rëndësishëm, analitik dhe orientues për një sërë problemesh që i merr në analizë.

Ky dokument shërben si urë lidhëse ndërmjet shqetësimeve në nivel komune bashkie dhe qarku dhe trajtimit të tyre, të harmonizuara me ato në nivele kombëtare dhe rajonale, mbështetur në Objektivat e Mijëvjeçarit. Gjithashtu, orienton rrugë dhe mënyra të përmirësimit të gjendjes, duke synuar zgjidhjen e këtyre shqetësimeve, të cilat do të ndikojnë edhe në përmirësimin e jetesës së qytetarëve në komunitetet ku ata jetojnë.

Pozita e favorshme gjeografike e qarkut të Lezhës, me 38 km vijë bregdetare, që ndodhet në kryqëzimin e të gjitha arterjeve të transportit rrugor, detar, ajror dhe hekurudhor, ku alternohen relievet e spikatura të natyrës shqiptare, burime të bollshme ujore, florë dhe faunë me shumëllojshmëri llojesh, e plot bukuri të tjera mahnitëse, që zoti dhe natyra kanë dhuruar këtu, krijojnë kushte dhe mundësi të padiskutueshme zhvillimi dhe prosperiteti për

banorët e këtij rajoni e më gjerë.

Pavarësisht këtyre resurseve, politikat diskriminuese shtetërore, të aplikuara ndaj këtij rajoni, kanë bërë që ai të renditet ndër më të varfërit në vend.

Nëse në të ardhmen do të aplikohen politika favorizuese, qarku i Lezhës me resurset dhe potencialet natyrore dhe njerëzore që mbart, shumë shpejt do të dalë nga lista e rajoneve më të varfëra dhe do të kthehet në një rajon të begatë. Për rrjedhojë, banorëve aktualë dhe të tjerëve që do të vijnë do t'u kthehet shpresa e jetës dhe e të ardhmes së tyre.

Strategjia e Zhvillimit Rajonal të qarkut të Lezhës, u shtohet studimeve dhe realizimeve të tjera të administratës së këtij këshilli, si: botimi i librit “Realiteti dhe Perspektiva”, projekti për “Zhvillimin Lokal Ekonomik dhe Punësimin në qarkun e Lezhës”, “Studimi i Fenomeneve Sociale të Rajonit”, “Studimi i vijës bregdetare të qarkut të Lezhës prej 38 km”, “Studimi i faktorëve që ndikojnë në përmbytjet dhe emergjencat e tjera civile”, botimi i librit “300 vjetori i Kuvendit të Arbërit”, realizimi i dokumentarit televiziv “Kurbini” dhe i librit “Nëpër Kurbin”, që do të realizohen dhe për rrethet Lezhë e Mirditë, organizimi i një sërë aktiviteteve kulturore dhe artistike, ngritja e Qendrës së Informimit për Publikun, botimit “Guida e Qarkut Lezhë” etj., duke synuar një prezantim sa më dinjitoz të vlerave të qarkut të Lezhës.

Strategjia e Zhvillimit Rajonal të Qarkut të Lezhës është një dokument i vlefshëm për të gjithë banorët e qarkut, administratat e njësive vendore dhe drejtuesit e tyre, administratat e tjera vendore e rajonale, OJF, donatorët e ndryshëm e të gjithë të interesuarit për të njohur dhe kontribuar në zhvillimin e këtij rajoni.

Hartimi i këtij dokumenti të zhvillimit rajonal, ka patur mirëkuptimin e të gjithë aktorëve, që përbën dhe garancinë e shndërrimit të tij në një program orientues për zhvillimin aktual dhe perspektiv të qarkut të Lezhës. Së bashku kemi nisur një rrugë që shpresojmë të jetë e gjatë në interes të komunitetit ku jetojmë.

Këshilli i Qarkut të Lezhës dhe administrata e tij do të japë kontributin e vet në mundësimin e dhënies jetë të projekteve të parashikuara në këtë strategji. Të gjithë së bashku, me kontribute gjithashtu të përbashkëta, duhet të kthehemi në misionarë të zhvillimit aktual dhe perspektiv të rajonit tonë dhe më gjerë.

Bardh RICA

Kryetar
Këshilli i Qarkut Lezhë

Parathënie

Në Takimin e Kombeve të Bashkuara për Mijëvjeçarin, në shtator 2000, udhëheqësit e botës, u angazhuan të bashkonin forcat, për realizimin e një numri objektivash, për të zvogëluar varfërinë, sëmundjet, analfabetizmin, dhe forma të tjera të vuajtjeve njerëzore në botë, të gjitha këto deri në 2015.

Agjencitë e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri kanë ndërmarrë një program të gjerë, për të ndihmuar vendin në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit, duke mbështetur, në të njëjtën kohë, objektivin e Shqipërisë për integrimin në Bashkimin Europian.

UNDP në Shqipëri ka bërë përpjekje të mëdha për ta sjellë këtë angazhim në nivel vendor, duke ndihmuar qeverisjet vendore në hartimin e raporteve të zhvillimit rajonal, ose strategjive me fokus OZHM-të. UNDP mbështetën Raportet/Strategjitë rajonale të OZHM-ve, si një mjet për të fuqizimin e qeverisjeve vendore, duke orientuar përpjekjet për zhvillim vendor dhe për të përqendruar interesat e donatorëve në aktivitete për zhvillimin rajonal. Raportet/Strategjitë e OZHM-ve rajonale kanë bërë të lindin debate publike, mbi kërkesat për zhvillimin vendor në të gjitha rajonet, duke ndikuar mbi legjislacionin dhe duke kontribuar në procesin e decentralizimit administrativ dhe financiar, një mjet kryesor për zhvillimin vendor. Në këtë pikë, Shqipëria është i vetmi vend në botë, që ka ecur përpara në procesin e lokalizimit të OZHM-ve, nëpërmjet realizimit të tetë Raporteve/Strategjive rajonale me një pjesëmarrje të gjerë aktorësh.

Lezha është rajoni i tetë, që ka sjellë, në mënyrë të sukseshme, OZHM-të në nivel vendor. Siç edhe theksohet në këtë dokument, Lezha është rajon me burime të bollshme njerëzore dhe natyrore. Të gjitha këto burime përfaqësojnë mundësi të mëdha për zhvillimin rajonal dhe për t'i ofruar një jetë më të mirë banorëve të tij. Duke patur një strategji të fortë dhe duke qenë në gjendje për ta zbatuar atë i shton këto mundësi dhe kontribuon në zbutjen e varfërisë dhe në një zhvillim të shpejtë. Objektivat e paraqitura janë ambicioze dhe realiste në të njëjtën kohë. Ky dokument është përgatitur në një moment kyç, prandaj është koha për të ndërmarrë veprime të qëndrueshme dhe serioze, për të përshpejtuar progresin për të përmbushur OZHM-të.

Do të doja të përshëndesja Këshillin e Qarkut të Lezhës, përfaqësuesit e komunave, bashkive, aktorëve, Qendrës Rajonale të Mjedisit (REC), përfaqësuesit e medias, organizatat e shoqërisë civile dhe publikun në përgjithësi për ndihmesën e dhënë për të përgatitur këtë material cilësor.

Do të doja të theksoja në mënyrë të veçantë, rëndësinë e pjesëmarrjes gjatë procesit të planifikimit të kësaj strategjie, e cila është thelbësore për të garantuar një vizion realist për një zhvillim të suksesshëm.

Anna Stjarnerklint

Përfaqësuese e Përhershme e Kombeve të
Bashkuara
Kombet e Bashkuara, Shqipëri

Lista e shkurtimeve

ARM	Agjencia Rajonale e Mjedisit
BE	Bashkimi Evropian
DA	Drejtoria Arsimore
DRNE Lezhë	Drejtoria Rajonale e Ndhmës Ekonomike
FSHZH	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
INSTAT	Instituti Shqiptar i Statistikave
ISO	Njësia e Standarteve Evropiane
IUCN	Unioni Botërore për Ruajtjen e Natyrës
KESH	Korporata Energjetike Shqiptare
KQ	Këshilli i Qarkut
MA	Ministria e Arsimit
MPÇS	Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale
MPV	Ministria e Pushtetit Vendor
MRrTT	Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit
NHDR	Raporti I zhvillimit Njerëzor
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OBT	Organizata Botërore e Tregëtisë
QSH	Qeveria Shqiptare
REC	Qendra Rajonale e Mjedisit

Përmbajtja

Hyrje	5
Parathënie	7
Lista e Shkurtimeve	8
Përmbajtja	9
Përmbleshja paraqitëse	10 - 13
Vlerësimi i gjendjes aktuale në Qarkun e Lezhës	15
Programi i Zhvillimit	53
Shtojca	95

Procesi i OZHM-ve

Në shtator të vitit 2000, udhëheqësit e 191 vendeve të botës nënshkruan Deklaratën e Mijëvjeçarit, e cila, duke sintetizuar Konventat dhe Deklaratat e mëparshme mbi zhvillimin, përcakton 8 Objektivat e Mijëvjeçarit për Zhvillimin. Nëpërmjet këtyre objektivave, çështje të tilla si: zhdukja e varfërisë, kryerja universale e arsimit bazë, nxitja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i rolit të gruas, zvogëlimi i vdekshmërisë foshnjore, rritja e kujdesit për shëndetin e nënës, lufta kundër sëmundjeve të rrezikshme, sigurimi i një mjedisi të qëndrueshëm dhe partneriteti për zhvillim global, u vlerësuan si kërkesat më themelore për të nxitur një zhvillim të qëndrueshëm të secilit vend. Më pas, këto Objektiva u zbrërthyen në 18 synime e 48 tregues, që ndihmojnë për matjen e përparimit të secilit vend. Si firmëtare e Deklaratës së Mijëvjeçarit, Shqipëria, e mbështetur nga UNDP, është përfshirë në një proces të gjerë njohjeje, ndërgjegjësimi, zbrërthimi e zbatimi të secilit prej Objektivave të Mijëvjeçarit. Strategjia Kombëtare e Zhvillimit Ekonomik e Social, që përcakton drejtimet themelore të zhvillimit të

Shqipërisë për një periudhë afatmesme, tashmë merr parasysh edhe këta Objektiva, duke përzgjedhur tregues sasiore për çdo sektor. Këta tregues janë në harmoni dhe po kombinohen me të gjithë treguesit e reformave që po ndërmerren në kuadrin e procesit të Stabilizim-Asociimit, i cili konsiderohet si një objektiv mjaft i rëndësishëm për integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Zyra e UNDP në Tiranë u bë, gjithashtu, nismëtare për lokalizimin në nivel qarku e rrethi të synimeve dhe treguesve të këtyre Objektivave, duke shndërruar ato në instrumente nxitëse të zhvillimit të gjithanshëm rajonal. Nevoja për këtë zbrërthim u pohua gjatë debateve të gjera e mjaft të frutshme të përfaqësuesve të aktorëve vendorë në kuadrin e një turneu rajonal të Objektivave të Mijëvjeçarit, ku u mbështet idea e shndërrimit të Objektivave në instrumente nxitëse të zhvillimit të gjithanshëm rajonal.

Karakteristika të përgjithshme

Popullsia në qarkun e Lezhës është mjaft e shpërndarë në të gjithë territorin e tij. Kjo popullsi shtrihet në një zonë prej 1619 km², e ndarë në tre rrethe: Kurbin, Lezhë dhe Mirditë, që përfshijnë 5 bashki dhe 16 komuna. Gjithashtu, qarku ka vlera të shumta natyrore, që paraqesin një kombinim të maleve, fushave, dhe bregdetit. Për periudhën 1989-2002, popullsia e qarkut të Lezhës ka patur rritjen më të madhe në të gjithë vendin (28,1%) dhe ka arritur në 46.279 banorë.

Popullsia në zonat rurale zë afro 60.6%. Sidoqoftë, gjatë viteve '90, ka patur një rritje të lëvizjeve migruese në drejtim të zonave urbane. Një tjetër tregues i tendencave të migracionit është fakti që popullsia Mirditë është në rënie (16,9%), në Kurbin dhe veçanërisht në Lezhë, ajo është në rritje në mënyrë konstante. Lezha është pjesa me popullsinë më të madhe të qarkut, 44% e numrit të përgjithshëm të popullsisë. Dendësia më e madhe është në Kurbin, 57,6%. Zonat rurale të qarkut janë më pak të populluara, sidomos krahasuar me Fierin (67%), Elbasanin (65% dhe Shkodrën (62,3%). Qarku i Lezhës është ndërmjet qarqeve me vlerë mesatare të Indeksit të Zhvillimit Njerëzor (HDI): Lezha dhe Kurbinin me HDI 0,798 dhe Mirdita me një vlerë më të vogël 0,632.

Informacioni i mbledhur nga njësitë e qeverisjes vendore në qarkun e Lezhës tregon se 12,5% e popullsisë ka emigruar (26.342 banorë), me një shpërndarje të ndryshme ndërmjet zonave: nga 5,4% në komunën e Fanit, Mirditë në 22,9% në komunën e Shëngjinit. Komunitat me vlerat më të ulëta të emigracionit janë Selita me 5,7%, Kaçinari me 5,8%, Ungrej me 6,2%. Në të gjithë qarkun, vlera më ulët e migacionit është regjistruar në Mirditë. Një shpjegim i mundshëm i kësaj mund të jetë kultura tradicionale dhe konservatore e zonës, për shkak të së cilës banorët e saj tentojnë më shumë drejt migracionit të brendshëm, sesa ndaj atij jashtë vendit. Vlerat më të larta të emigracionit janë regjistruar në komunat e Shëngjinit, Balldrenit, Fushë Kuqes, Kallmetit dhe Blinishtit. Kjo lidhet me kushtet e favorshme të vendndodhjes gjeografike të zonës, krahasuar me pjesët e tjera të qarkut, por dhe me konceptet e përpëraura dhe qëndrimet për t'iu përshtatur sfidave të jetës. Niveli i papunësisë, 28% në shkallë qarku, është afro 2 herë më shumë se niveli i papunësisë në shakllë kombëtare, që është një tregues i

nivelit të lartë të varfërisë në qark. Kurbinin, në veçanti, ka shkallën më të lartë të papunësisë, tre herë më të lartë se mesatarja kombëtare. Femrat zenë 39,1% të të punësuarve. Pjesa tjetër e femrave merret me kujdesjen për shtëpinë dhe fëmijët dhe të moshuarit, duke hequr dorë nga konkurimi në tregun e punës.

Në bashkinë e Rubikut, shkalla e papunësisë është 34%, pjesa më e madhe e së cilës përbëhet nga grupmosha 20-34 vjet, (afro 70% nga kjo grupmoshë kërkojnë punë). Bashkia e Lezhës ka një papunësi prej 23,7%.

Qarku i Lezhës ka mjaft burime natyrore dhe njerëzore dhe, në veçanti, mjaft mundësi të paeksploruara dhe të pashfrytëzuara për turizmin. Vlerat më të rëndësishme turistike përbëhen nga pasuri historike të shumta, të shoqëruara me pejsazhe të ndryshme natyrore (bregdet, lumenj, ligatina, male, etj.) Mbështetur në këto burime të shumta, qarku po bën përpjekje të konsiderueshme për rritjen sociale e ekonomike dhe uljen e varfërisë. Në kuadër të këtyre përpjekjeve, strukturat e qeverisjes vendore, në bashkëpunim me Këshillin e Qarkut dhe aktorë të tjerë vendorë, nisën përgatitjen e këtij dokumenti strategjik për zhvillimin e rajonit, me synimin për përcaktimin e qëllimeve për zhvillimin rajonal dhe veprimet prioritare, në harmoni me Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit.

Procesi

Procesi i hartimit të këtij plani është drejtuar nga një Komision Drejtues, i përbërë nga përfaqësues të qeverisjes vendore, institucioneve të qeverisë qendrore që veprojnë në nivel vendor dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile. Komisioni ka përcaktuar fushat kyçe të zhvillimit, që kërkojnë analiza të thelluara dhe veprime prioritare për të realizuar progresin drejt përmirësimit të OZHM-ve. Pesë fusha janë veçuar në këtë mënyrë: rritja e të ardhurave, rritja dhe përmirësimi i mundësive për shkollim, barazia gjinore, kujdes shëndetësor i përmirësuar për nënën dhe fëmijën dhe mjedisi i qëndrueshëm. Afro 50 specialistë nga qeverisja vendore në nivel qarku, bashkie e komune, agjencitë vendore të qeverisë qendrore, organizatat jofitimprurëse, si dhe përfaqësues të sektorit privat kanë kontribuar në këtë proces.

Të ndarë në grupe pune për secilën nga fushat e përzgjedhura, këta specialistë kanë punuar intensivisht për përgatitjen e një baze të dhënash dhe terguesve

kyç, nëpërmjet analizave dhe duke u përqendruar në prioritetet e zhvillimit që lidhen me Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit. Pas përgatitjes së materialeve nga çdo grup, ato janë diskutuar, në takime të ndryshme, ku kanë marrë pjesë komunat, sektori i biznesit dhe media, të cilët ofruan një kontribut praktik dhe të mirëinformuar për gjendjen, prioritetet e përcaktuar si dhe burimet e qarkut për t'i zbatuar këto plane të hartuara. Këto diskutime sigurojnë kontribut mjaft të vlefshëm për përcaktimin e objektivave dhe treguesve lokalë për secilin nga Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit. Media lokale shërbeu si një mjet mjaft i rëndësishëm për të përçuar mesazhin se OZHM ndikojnë në jetën e gjithkujt dhe për këtë arsye është e nevojshme të përfshihen sa më shumë njerëz në procesin e përgatitjes së raportit.

Ky proces u mbështet nga të gjitha agjencitë e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri, të cilat ofruan ekspertizë në përpunime me fushat problematike. Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) mbuloi pjesën kryesore të mbështetjes nëpërmjet ekspertizës së projekteve të tij në Shqipëri, e shoqëruar kjo me kualifikimin e stafit të administratave vendore dhe aktorëve të tjerë. Në këtë mënyrë, përgatitja e këtij dokumenti strategjik shërbeu, në të njëjtën kohë, si mjet për informimin e publikut, në nivel qarku, mbi OZHM dhe ndikimin e tyre në zhvillimin njerëzor. Ky proces ndihmoi në forcimin e kapaciteteve të administratave vendore dhe strukturave të zgjedhura dhe ka mundësuar pjesëmarrjen e publikut dhe medias në diskutimet dhe debatet mbi mundësitë reale të përmbushjes së OZHM-ve.

Procesi, në të njëjtën kohë, nxiti rrahjen e mendimeve për veprimet prioritare që duhen kryer në qarkun e Lezhës, për të përmbushur objektivat e zhvillimit dhe përshpejtimin e këtij procesi. OZHM-të shërbyen si një instrument i fuqishëm për nxitjen e pjesëmarrjes publike në diskutime konstruktive mbi tendencat e zhvillimit të qarkut.

Përmbajtja

Profili i varfërisë së qarkut është analizuar në mënyrë të veçantë për zonat rurale dhe ato urbane. Në zonat urbane, punësimi, nëpërmjet zgjerimit të biznesit privat, shfrytëzimit të potencialeve turistike dhe përshatjes ndaj tregut të punës janë identifikuar si parakushte për uljen e varfërisë.

Në zonat rurale, rritja e prodhimit të fermave, ndryshimi rrënjësor i strukturës së prodhimit, rritja e

kapaciteteve për përpunimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale, menaxhim i qëndrueshëm i pyjeve dhe zgjerimi i zonave të mbrojtura konsiderohen si drejtimet kryesore për rritjen e të ardhurave në zonat rurale. Analiza të specializuara janë zhvilluar kundrejt mundësive të turizmit, kushteve të infrastrukturës rrugore në qark, dhe mundësive reale për t'u shfrytëzuar nga të gjithë banorët. Për sigurimin e mundësive më të mira për shkollim, analiza është fokusuar në rëndësinë e rritjes së mundësisë së shkollimit, në përcaktimin e shpërndarjes optimale të burimeve njerëzore dhe infrastrukturore, si dhe në përcaktimin e standardet kombëtare për edukimin. Arsimi profesional është veçuar si një drejtim prioritar për zhvillimin e arsimit në qarkun e Lezhës. Bazuar në analiza të detajuara, janë planifikuar masa të rëndësishme për përmirësimin e gjendjes në këtë sektor. Ato përfshijnë optimizimin e arsimit profesional, rritjen e llojshmërisë së aftësive për arsimin profesional dhe rritjen e autonomisë financiare.

Përpjekjet për barazinë gjinore përqendrohen në nivelin e arsimit të femrave, punësimin dhe përfshirjen e tyre në çështjet politike e sociale në nivel vendor. Analiza të veçanta janë kryer për kontributin e femrave në sektorin e arsimit dhe strukturat vendimarrëse vendore në të gjitha nivelet, si dhe për përfaqësimin e femrave në strukturat drejtuese lokale të partive. Nevoja për rritjen e shkallës së ndërgjegjësimit publik për zgjerimin e pjesëmarrjes së femrave në të gjitha nivelet e jetës politike, sociale e ekonomike është theksuar si prioritet, duke u nisur dhe nga vlerat mjaft të ulëta të këtyre treguesve në nivel qarku. Çështja e kujdesit shëndetësor për nënën dhe fëmijën është përqendruar në analizat e mortalitetit infantil dhe atij të nënave, në analizat e sigurimit të kujdesit shëndetësor parësor, veçanërisht në lidhje me sigurimin e tij në zonat rurale. Zhvillimi mjedisor i qëndrueshëm merr në konsideratë vlerat e shumta natyrore dhe përdorimin racional të burimeve natyrore. Prioritet përmbledhin zhvillimin e turizmit detar, malor dhe rekreativ, rehabilitimin e dy pikave të nxehta të ndotjes në qark si dhe në ruajtjen e florës dhe faunës.

Janë përcaktuar tregues sasiore dhe hartuar tendencat zhvillimore për afate kohore të shkurtra, të mesme dhe të gjata, për drejtimet e zhvillimit. Kështu, për qarkun e Lezhës, paketa përmbledh 5 objektiva, 19 synime dhe 23 indikatorë përmbledhës. Dokumenti përbëhet nga tre kapituj kryesorë: i) vlerësimi i gjendjes aktuale; ii) strategjia e zhvillimit; iii) shtojcat.

Kjo strukturë ndihmon lexuesin të përqendrohet më mirë në hapat konkretë të zhvillimit, ndërkohë që u siguron autoriteteve vendore dhe sektorit të biznesit një dokument pune gjithëpërfshirës.

Një mënyrë e re

Bazuar në natyrën e ndërthurur dhe të ndërvarur të Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit, pothuaj të gjitha çështjet e trajtuara në këtë dokument janë të ndërlidhura. Punësimi ka ndikim të drejtëpërdrejtë në uljen e varfërisë, ndërkohë që varfëria është e lidhur me nivelin e ulët të arsimimit dhe trajnimeve profesionale. Çështjet gjinore janë të lidhura me punësimin dhe mundësinë për t'u arsimuar dhe për të patur kujdes shëndetësor. Niveli i vdekshmërisë foshnjore dhe amësore janë të lidhura me kushtet ekonomike dhe sociale të familjes dhe me arsimimin e anëtarëve të saj. Për pasojë, zhvillimi ekonomik i qarkut nuk mund të sigurohet pa zhvillimin e qëndrueshëm të mjedisit, pa përmirësimin e gjendjes të burimeve natyrore dhe pyjeve dhe pa zgjerimin e zonave të mbrojtura. Në vijim, pjesa më e madhe e ndërhyrjeve prioritare në nivel vendor mund të zbatohet nëpërmjet trajtimeve të integruara, për të kursyer kohë dhe burime financiare.

Analiza të tilla paraqesin një mënyrë të re që merr parasysh nivelin e të ardhurave në komuna, mundësinë që popullsia të ketë arsimin dhe kujdesin shëndetësor të nevojshëm, si dhe mundësinë e fermerëve privatë për të dalë në treg. Synimet dhe treguesit vendorë të zhvillimit të qarkut, në përputhje me objektivat e vendosur, janë përmbledhur në 11 synime dhe 36 tregues të matshëm. Treguesit do të përdoren për të vlerësuar në mënyrë periodike përmbushjen e objektivave.

Procesi i përcaktimit të synimeve dhe indikatorëve ka marrë parasysh, veçanërisht, Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit, tabelën e masave prioritare në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit Ekonomik e Social (SKZHES), si dhe treguesve afatgjatë të përcaktuar në strategji për secilin sektor. Pasi është kryer një analizë e thelluar e gjendjes aktuale dhe mundësive të zhvillimit për secilin sektor, puna ka vijaur për diksutimin e rishikimin e treguesve të zhvillimit për qarkun e Lezhës. Sidoqoftë, synimet dhe treguesit e përcaktuar në nivel vendor nuk duhet të konsiderohen si të përcaktuara njëherë e mirë. Ata do të verifikohen dhe do të përmirësohen në mënyrë sistematike gjatë monitorimit dhe rishikimit të kësaj strategjie.

Vlerësimi i progresit

Ky dokument strategjik është një fillim i mirë në përpjekjet për të përcaktuar dhe hartuar projekte prioritare dhe për të mobilizuar burime financiare, së apri nga burimet e brendshme të buxheteve të qeverisë qendrore dhe asaj vendore. Këshilli i Qarkut


e konsideron përgatitjen e këtij dokumenti si një hap të parë në rrugën për zhvillimin e rajonit. Këto përpjekje, përveçse janë të një rëndësie të veçantë, janë dhe në momentin e përshatshëm, duke u nisur nga angazhimi i fortë i qeverisë për zhvillimin e reformës së decentrealizimit fiskal. Ky dokument shërben, gjithashtu, dhe si udhëzues për donatorët ndërkombëtarë, përfshi agjencitë e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri, të interesuara për prioritetet e zhvillimit në qarkun e Lezhës. Përmbajtja e këtij dokumenti përbën bazën e monitorimit të progresit në fushat prioritare përkundrejt treguesve vendorë të përcaktuar për qarkun. Kjo mënyrë synon, njëkohësisht, nxitjen e pjesëmarrjes së gjerë të publikut në proceset vendimmarrëse, si një shprehje e kontributit të aktorëve të ndryshëm në zhvillimin e qarkut të Lezhës.

Kapacitetet vendore në hartimin dhe zbatimin e strategjive

Në Shqipëri procesi i decentralizimit po ecën përpara së bashku me përcaktimin më të mirë të kompetencave për nivelet e ndryshme të drejtimit nga niveli qendror drejt atij rajonal dhe vendor. Qarku i Lezhës është pjesë e këtyre zhvillimeve. Ky Qark ka zhvilluar në mënyrë të vazhdueshme kapacitetet e tija për zhvillimin dhe menaxhmin e drejtë të rajonit dhe burimeve të tij. Në këtë kuadër, autoritetet e Qarkut po punojnë me devotshmëri për të përballuar problemet e shumta me të cilat ndeshen, dhe për të cilat kërkohen edhe zgjidhje të shpejta. Pavarësisht progresit të bërë në transferimin e përgjegjësisë, dëshirës së mirë dhe punës së madhe në nivel rajonal dhe lokal, kapacitetet dhe burimet në dispozicion të Qarkut mbeten ende të kufizuara (burimet njerëzore, infrastruktura dhe mjetet financiare). Për këtë arsye vazhdimisht punohet që të vendosen prioritete të sakta për të arritur efektivitetin maksimal në ndërhyrjet që bëhen.

Drejtoria e Programimit dhe Zhvillimit në Qarkun e Lezhës kujdeset për të gjitha çështjet që lidhen me zhvillimin e zonës në tërësi. Përfshirja e stafit të tyre në hartimin e dokumentave strategjike, i ka ndihmuar të rrisin kapacitetet dhe fitojnë përvojën e duhur për të zbatuar modele të ngjashme edhe në nisma të tjera për zhvillimin e rajonit.

Në nivelin e bashkive të Qarkut, përfaqësuesit kanë marrë pjesë aktivisht në hartimin e strategjive lokale të zhvillimit dhe të planifikimit. Pavarësisht nga arritjet, vërehen vështirësi të shumta lidhur me numrin e njerëzve që mund të angazhohen dhe burimet në dispozicion të tyre. Në të gjitha komunat ende nuk ka personel të mjaftueshëm për të mbuluar të gjitha problematikat e zhvillimit dhe kualifikimi i tyre mbetet ende i ulët. Bazuar në këto vlerësime, është e nevojshme planifikimi dhe zbatimi në Qarkun e Lezhës i programeve të veçanta të asistencës teknike prej institucioneve të kualifikuara në nivel kombëtar apo më gjerë.



Vlerësimi i gjendjes në Qarkun e Lezhës

Kapitulli I Eleminimi i varfërisë ekstreme dhe urisë

Popullsia

Popullsia e qarkut Lezhë ka një shtrirje gjeografike mjaft të gjerë, në 1619 km², ku natyra i ka dhuruar malin, fushën dhe bregdetin. Siç vërehet edhe nga tabelat, popullsia e qarkut Lezhë ka një rritje ndër më të lartat në vend që nga viti 1989 deri në vitin 2003, me rreth 46.279 banorë (ose 28.1 %).

Ekziston një numër afërsisht i barabartë mes meshkujve dhe femrave. Popullsia që jeton në zonat rurale, është 60.6 %, gjë që tregon një prirje të lëvizjes së popullsisë drejt zonave urbane pas viteve 90-të. Gjithashtu, vihet re që, në Mirditë, popullsia është në rënie (16.9 %), ndërsa në Kurbin e sidomos në Lezhë popullsia është rritur ndjeshëm.

Dallohet qartë se ka një ndryshim me 46.830 banorë ndërmjet regjistrave të gjendjeve civile dhe INSTAT (Repoba 2001), kjo, ngaqë INSTAT nuk ka përfshirë emigrantët dhe një pjesë të familjeve që nuk janë regjistruar.

Jetëgjatësia e femrave është më e madhe se e burrave, kështu që edhe raporti në grupmoshen 75 vjeç e lart është 60.47 % (pra 100 meshkuj për 150 femra).

Për efekte të vështirësive të nxjerrjes së të dhënave sipas grupmoshave nga zyrat e gjendjes civile, jemi bazuar në të dhënat e INSTAT 2001.

Rreth 31.1 % e popullsisë është nën moshën 15 vjeç, 55.8 % është nën moshën 30 vjeç, ndërsa vetëm 6.9 % është mbi 65 vjeç.

Vihet re një prirje e popullsisë së re për t'u larguar nga vendi duke mos gjetur këtu mundësinë për një jetë më të mirë.

Gjendja Civile

Vihet re që si rezultat i moshës së re të popullsisë ka më shumë individë të pamartuar sesa të martuar.

Gjithashtu, ka më shumë gra të veja sesa burra të tillë. Kjo si

	Popullsia	Femra	Zonat urbane	Zonat rurale	Nr.Familjeve
Qarku Lezhë	210.416	104.878 (49.8 %)	83.041 (39.4 %)	127.357 (60.6 %)	51.677
Kurbin	72.543 (35 %)	36.184 (49.8 %)	41.816 (57.6 %)	30.727 (42.4 %)	17.928
Lezhë	93.172 (44 %)	46.292 (49.6 %)	26.977 (28.9 %)	66.195 (71.1 %)	22.167
Mirditë	44.701 (21 %)	22.402 (50.1 %)	14.248 (31.8 %)	30.453 (68.2 %)	11.582

Tab.1 - Popullsia sipas zyrave të gjendjeve civile, Dhjetor 2003

Rreth 20 % e popullsisë së qarkut Lezhë ka emigruar për një jetë më të mirë për veten dhe për një të ardhme më të mirë për fëmijët e tyre. Largimi i tyre, në përgjithësi, është afatshkurtër, për të punuar në vende fqinje si: Greqi, Itali por edhe në Gjermani, Angli, USA, etj.

Veçori është se zakonisht largohet kryefamiljari dhe, pavaresisht vlerave monetare që ai sjell, kjo ndikon në ngarkesën e punës së gruas, e cila duhet të marrë përsipër punë shtesë.

Dendësia e popullsisë

Qarku i Lezhës ka një dendësi popullore më të lartë se mesatarja në shkallë vendi (106.76). Kjo e ndarë sipas rrethëve rezultoi si më poshtë (Tab.2)

rezultat edhe i jetëgjatësisë më të madhe të grave apo procesit të gjakmarrjes. Po kështu, numri i divorceve është mjaft i ulët si rezultat edhe i presionit apo trysnisë të zakoneve të këtyre zonave për këtë fenomen, megjithë tendencën në rritje vitet e fundit.

Jetëgjatësia

Edhe jetëgjatësia ndikohet nga një tërësi faktorësh si kequshqyerja, ndotja e mjedisit, infrastruktura, shërbimi shëndetësor, gjinia, etj. Siç vihet re dhe në tabelat e mësipërme gratë jetojnë më gjatë se burrat dhe popullsia mbi 75 vjeç është mjaft e vogël. Për t'u theksuar është fakti se janë rreth 35 banorë me moshë mbi 100 vjeç.

	Sip. km ²	Dendësia sipas	Dendësia sipas	Diferenca e dendësisë
		INSTAT	GJ. Civile	
		2001	2003	
Shqipëria	28749	106.76		
Qarku Lezhë	1619	98.3	129.9	+ 31.6
Kurbini	274	198.9	264.7	+ 65.8
Lezha	478	141.4	194.5	+ 53.1
Mirdita	867	42.7	51.5	+ 8.8

Tab. 2 - Dendësia e popullsisë Burimi: Këshilli i Qarkut, Lezhë



Struktura moshore

Edhe nga trajtimi i deritanishëm vihet re që raporti midis meshkujve dhe femrave, për qarkun e Lezhës, është pothuaj i barabartë (100.6 meshkuj për 100 femra).

Për vitin 2002 jetëgjatësia në qarkun e Lezhës është 67 vjeç, që e krahasuar me qarqe të tjera apo me jetëgjatësinë në Shqipëri (73.2 vjeç) është jo e kënaqshme.

Shpërndarja e popullsisë në nivel komune

Burimi: Gjendja Civile 2003



Mosha (vjeç)	Qarku i Lezhës		Rrethi Kurbin		Rrethi Lezhë		Rrethi Mirditë	
	Popullsia	%	Popullsia	%	Popullsia	%	Popullsia	%
Totali	159.182	100	54.392	100	67.734	100	37.056	100
0 - 14	49.501	31,1	17.311	31,9	20.821	30,7	11.369	30,7
15 - 29	39.276	24,7	13.118	24,1	16.146	23,8	10.012	27
30 - 44	33.546	21,1	11.827	21,7	14.482	21,4	7.237	19,5
45 - 64	25.757	16,2	8.696	16	11.408	16,9	5.653	15,3
65 +	11.102	6,9	3.440	6,3	4.877	7,2	2.785	7,5

Tab. 3 - Stuktura moshore e popullsisë (Instat 2001)

Varfëria

Zhdukja e varfërisë ekstreme dhe e urisë është objektivi i parë i mijëvjeçarit për zhvillim, ku përgjysmimi brenda vitit 2015 i popullsisë që jeton në varfëri ekstreme, është synimi kryesor i këtij objektivi.

Edhe në qarkun e Lezhës, varfëria, si tregues, ka dimension rajonal dhe gjeografik. Varfëria, si koncept, është mjaft i gjerë dhe përfshin disa tregues si: pamundësia për t'u ushqyer, pamundësia për të patur një strehë ku mund të jetosh, pamundësia që fëmijët të ndjekin shkollën, mungesa e ujit të pijshëm, privimi nga liria dhe përfaqësimi.

Në qarkun e Lezhës, varfëria ka specifikat e saj si në zonat rurale, ku është më e theksuar në verilindje, ashtu edhe në zonat urbane.

Duke parë Strategjinë Kombëtare për Zhvillim Social-Ekonomik (SKZHES) të vitit 2001, dallohet qartë që zonat e thella në veri dhe verilindje janë më të varfëra. Pothuaj gjysma e këtyre banorëve, në këto zona, janë të varfër dhe më shumë se një e pesta jetojnë në varfëri ekstreme. Incidenca dhe ashpërsia e varfërisë është më e lartë në familjet ku kryefamiljari është i papunë. Në familjet e varfra, burimi kryesor i të ardhurave është aktiviteti bujqësor dhe ndihma ekonomike.

pushtetit vendor, në vitin 2001, është 206.622 banorë dhe ka një diferencë prej 47440 banorësh me regjistrimin sipas INSTAT. Ky numër banorësh përcakton dhe uljen e theksuar të raportit të investimeve për frymë.

Sipas raportit të UN, për vitin 2003, Shqipëria është renditur e 95-ta në nivel global, me HDI 0.735, për vitin 2004 është renditur e 65, me HDI 0.781. Për 2004, indeksi i jetëgjatësisë 0.81 (73.6 vite jete), indeksi i arsimit 0.89 (joanalfabetë 98.7 %, përfshirja në arsim 69%), indeksi GDP 0.65 – GDP për frymë 4,830 (PPP US\$).

Qarku Lezhë llogaritet ndër qarqet me nivel të mesëm të HDI. E llogaritur kjo për rrethet Lezhë dhe Kurbin, është në shifrën 0.798, ndërsa Mirdita renditet në rrethet me HDI të ulët, 0.632.


Vihet re që niveli i varfërisë në Kurbin dhe Mirditë është mjaft i theksuar, ndërsa në nivel qarku rreth 36.7 % e popullsisë janë të varfër nga 25.4 % që është në nivel vendi.

Niveli i lartë i varfërisë në këto zona shfaqet për shkak të mundësive të kufizuara të punësimit dhe nga të ardhurat e ulëta që sigurohen nga bujqësia, ku rreth 75 % e familjeve të varfra zotërojnë më pak

Treguesi për frymë sipas rretheve



Të varfër në përqindje sipas rretheve



Raporti i zhvillimit njerëzor (HDR)

Në vitin 2001, Shqipëria renditej e 92-ta nga 173 vende të Botës me HDI (Indeksi i Zhvillimit Njerëzor) 0.773, ndërsa qarku Lezhë renditet në qarqet me HDI të ulët (0.752), i nënti nga 12 qarqet e Shqipërisë.



Duhet theksuar që popullsia sipas zyrave të gjendjes civile të

se 1000 m² tokë për frymë, pjesa më e madhe e së cilës është e një kategorie të dobët.

Si rezultat i papunësisë rreth 31.7 % e të rinjve (14 – 25 vjeç), në qarkun e Lezhës, janë përdorues alkooli, droge apo me sjellje kriminale, kjo krahasuar me 22.8 % në shkallë vendi, ndërsa fëmijë në rrezik (0 – 14 vjeç), jetime biologjike dhe sociale, që jetojnë me një prind, lypsat dhe ata që punojnë, që nuk ndjekin

Indeksi i Zhvillimit Njerëzor

Burimi: Raporti për Zhvillimin Njerëzor, Shqipëria 2004



shkollën, etj., përbëjnë rreth 10.2 %, që është rreth 50 % më e lartë se mesatarja në shkallë vendi. Kjo tregon se varfëria prek më shumë të rinjtë, gjë që duhet marrë parasysh për të arritur një balancim më të mirë të varfërisë dhe programeve sociale. Politikat sociale, që do të ndiqen, sjellin nevojën e garantimit të nivelit minimal të domosdoshëm të të ardhurave si dhe të shërbimeve jetike për të varfërit dhe grupet / individët në nevojë.

Ndihma ekonomike

Varfëria shprehet qartë edhe në numrin e familjeve të trajtuara me ndihmë ekonomike dhe bazuar në këtë tregues pothuajse arrihet në të njëjtin përfundim siç tregohet nga HDI- ja.

Në qarkun e Lezhës janë të përfshira në skemën e ndihmës ekonomike 17 % (25 % sipas INSTAT 2001) e familjeve çfarë tregon për nivelin e lartë të varfërisë. Këtu duhet sqaruar se një pjesë e mirë e familjeve të varfëra, që kanë lëvizur për në zonat urbane, janë përjashtuar nga skema, për kalim afatesh dhe mosnjohje të legjislacionit.

Varfëria në fshat (4 në çdo 5 veta janë të varfër) është rreth 3 herë më e lartë se në qytet.

Mendojmë që një vëmendje më e madhe i duhet kushtuar programeve të punësimit nëpërmjet ndihmës ekonomike, gjë

që është me mjaft interes për përmirësimin e standardeve në komunitet.

Punësimi





Ekzistenca e një sektori të mbizgjeruar informal, e bashkëshoqëruar nga punësimi informal si dhe vetëpunësimi në bujqësi sa për mbijetesë, e bëjnë të vështirë saktësinë e të dhënave mbi punësimin në qarkun e Lezhës. Vetëpunësimi në bujqësi, sidomos në zonat rurale, ndikon në rritjen fiktive të punësimit, por që realisht nuk ndikon dukshëm në të ardhurat e këtyre familjeve: rreth 48 % e njerëzve, që punojnë në bujqësi, janë të varfër dhe rreth 28% e banorëve të zonave rurale bëjnë pjesë në kuantilin e fundit të niveleve të të ardhurave.

Shkalla e papunësisë, prej 28 % në nivel qarku, është rreth 2 herë më e lartë se mesatarja kombëtare e papunësisë në Shqipëri, që

Rrethet	Forcat aktive	Të punësuar	Të papunë	Shkalla e papunësisë në %
Kurbini	18.844	10.557	8.287	44,0
Lezhë	26.789	23.237	3.552	13,3
Mirditë	14.806	10.960	3.846	26,0
Qarku	60.439	44.754	15.685	28,0



Tab.4 - Gjendja e forcave të punës në Qarkun e Lezhës (Burimi: INSTAT 2003)

Punësimi sipas sektorëve për të gjithë rrethet



Familjet me ndihmë ekonomike

Burimi: Këshilli i Qarkut Lezhë, Dhjetor 2003



është 14.6 % (ose 15%), që tregon për nivelin e lartë të varfërisë. Për t'u veçuar është Kurbin, ku shkalla e papunësisë është 3 herë me e lartë sesa mesatarja kombëtare. Nga të punësuarit vetëm 39.1 % janë femra. Pjesa tjetër e femrave qëndrojnë në shtëpi, që të kujdesen për femijet apo për punë shtëpie, gjë që i pengon të konkurojë në tregun e punës.

Në bashkinë Rubik, shkalla e papunësisë llogaritet në 34 % dhe grupmosha më e prekur nga papunësia është 20-34 vjeç (rreth 70 % e të papunëve punëkërkues). Bashkia Lezhë ka rreth 23.7 % të papunë.

Zonat rurale kanë një përqindje më të lartë të forcës punëtore aktive që kërkon punë. Lëvizja e popullsisë rurale drejt qendrave urbane ka rritur shkallën e papunësisë në mënyrë të ndjeshme.

Sistemi i ngrohjes

Mungesa e shërbimeve bazë si energjia elektrike, ngrohja e brendshme apo uji i rrjedhshëm janë faktorë që ndikojnë për shkallën e varfërisë.

Energjia elektrike është një problem mjaft i theksuar ndërsa burimet ujore ekzistojnë por mungon infrastruktura e shpërndarjes. Në zonat rurale mungon plotësisht ngrohja qendrore dhe numri i njësive ekonomike pa ngrohje është mjaft i lartë, rreth 713 njësi. Përsa i përket mënyrës së ngrohjes, më shumë përdoret ngrohja me dru, në 28830 njësi, shifër kjo sa dyfishi i njësive që ngrohen me energji elektrike.

Sqarojmë se rreth 23345 njësi ekonomike familjare, që përdorin dru për ngrohje, janë në zonat rurale.

Furnizimi me ujë

Rrethi Lezhë është më afër normales së furnizimit me ujë, veçanërisht bashkia Lezhë ka 24 orë ujë (ndërpritet vetëm kur nuk ka energji elektrike ose për defekte në rrjet). Kështu, rreth 38.5 % e njësive ekonomike familjare të qarkut janë me ujë brenda në banesë, ndërsa 27.4 % janë me ujë jashtë banese dhe 14.2 % furnizohen me puse ose çisternë. Në rreth 20 % (7342) njësi ekonomike familjare mungon furnizimi me ujë, nga këto 90 % (6574) njësi ekonomike familjare janë në fshat.

Në zonat urbane, numri i banesave me ujë brenda është 2 herë më i lartë se në zonat rurale, por kjo nuk do të thotë që ato furnizohen me ujë të rrjedhshëm. Numri i banesave me ujë jashtë në zonat rurale është 7 herë më i madh se në zonat urbane.

Infrastruktura

Element mjaft i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik është edhe infrastruktura rrugore, hekurudhore, energjitike, detare (porti Shëngjin) madje edhe ajrore, nëse aeroporti i Gjadrit do të bëhej funksional, sistemi i ujit të rrjedhshëm si dhe shërbimi i rregullt urban.

Qarku i Lezhës përshkohet nga rrjeti hekurudhor që lidhet me atë ndërkombëtar (Lezhë-Shkodër –Mali i Zi), Superstrada (Tiranë – Lezhë –Shkodër), autostrada (Durrës-Milot-Mirditë-Morinë), që sapo ka filluar punimet në Rrubik dhe që do të sjellë mjaft zhvillim në rajonin tonë e sidomos në pjesën verilindore të qarkut, si dhe porti i Shëngjinit me mundësitë e zgjerimit dhe zhvillimit të tij, janë një faktor i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik të rajonit.

Telekomunikacioni

Siç vihet re, numri më i madh i abonentëve është në Lezhë me 2739, me një kapacitet të centralit prej 4000 numrash dhe me densitet të abonentit prej 12%. Në Kurbin, kapaciteti i centralit është 4 800 dhe numri i abonentëve 2594, me densitet të abonentit 14 %. Me pas, vjen Mirdita me 1386 abonent, me kapacitet centrali 2500 dhe me densitet të abonentit 12 %. Duhet veçuar që rreth 90% e këtij rrjeti është e shtrirë në zonat urbane dhe se kapaciteti i centraleve në qarkun Lezhë është 41 % më i madh se numri i abonentëve.

Në qarkun e Lezhës operojnë dy kompani celulare, AMC (Albanian Mobile Communication), që ka hyrë në treg në vitin 2000 dhe mbulon 85 % të territorit dhe kompania celulare Vodafon, që ka hyrë në treg në vitin 2001 dhe mbulon rreth 60 % të territorit. Megjithëse e kushtueshme krahasuar me telefoninë me linjë tokësore, telefonia celulare është e shtrirë mjaft edhe në zonat rurale për arsye të praktikitetit të abonentit dhe mundësisë së shtrirjes me anë të valëve.

Internet

Me interes të madh është pritur edhe hyrja e komunikimit me internet në qarkun Lezhë. Kjo sidomos nga institucionet shtetërore, por edhe nga një pjesë e konsiderueshme e të rinjve. Në qarkun Lezhë ofrojnë shërbimin e tyre, shoqëria private "i @ i" sh.p.k. me qendër në Lezhë, me përdorues 2 institucione: Këshilli i Qarkut Lezhë dhe Caritas, si dhe rreth 200 përdorues të tjerë, lidhja është me sistem satelit T1 asimetrik dhe shoqëria

No.	Region	Accommodation capacity of the switchboard	Switchboard system	Capacity of urban network	No. of Subscribers	Density of subscribers	Card operated public telephones	Manner of connection	Connection of the switchboard to the areas
	Lezha Region	11.300	Digital Siemens Hitachi	10.080	6.719	13 %	54	R/Rele 4 channel	
1	Lezha	4.000	Digital Siemens	4.700	2.739	12 %	22	R/Rele 4 channel	Automatic
2	Kurbin	4.800	Hitachi Analogue	2.930	2.594	14 %	13	R/Rele 4 channel	None
3	Mirdita	2.500	Digital	2.450	1.386	12 %	19	R/Rele	Automatic

Tab.5 - Infrastruktura e telekomunikimit në Qarkun Lezhë (Burimi: Telekom Dhejtor 2003)

private "Mach 6" me qendër në Laç, me numër përdoruesish rreth 200, lidhja është me sistem satelit direkt me Holandën. Po kështu, ekzistojnë edhe faqe interneti për qytetet e qarkut, si www.Mirditaonline.net, ose www.lezha.net, mjaft të frekuentueshme. Shërbimi kombëtar i internetit përmes Albtelecom-it ka rritur ndjeshëm numrin e përdoruesve të internetit në qarkun Lezhë. Gjithashtu, internet kafetë po tërheqin në mënyrë të ndjeshme të rinjtë, që përfitojnë nga mundësia për të përdorur internetin. Këshilli i Qarkut Lezhë ka hyrë në këtë sistem në fillim të vitit 2004 dhe po shikohet mundësia e përdorimit falas të internetit apo postës elektronike për informacione të ndryshme në ndihmë të komunitetit. Për t'u vlerësuar është dhe ngritja e Qendrës së Aksesit për Publikun (PAC) nga PNUD, në kuadër të hartimit të strategjisë për qarkun e Lezhës, e cila do t'i shërbejë komunitetit të Lezhës, kohë pas kohe, si qendër informacioni dhe komunikimi.

Shërbimet Postare

Shërbimet që mbulohen nga posta Lezhë janë shërbimi postar, telefonik (që për zonat rurale është radio-rele) dhe shërbimet financiare, biznesi dhe shërbimin postar EMS.

Në qarkun e Lezhës, shërbimi postar nuk është i kënaqshëm. Kjo situatë është jo për mosangazhim të stafit të postës, por si rezultat i mungesës së sistemit të adresave (apo mosvendosja e kutive postare në çdo pallat), por edhe largësisë nga posta të zonave rurale (tërheqja e postës nga zonat rurale është e organizuar dy herë në javë) gjë që shkakton vonesa të konsiderueshme apo dëmtim të korespondencës. Shërbimi postar është i shtrirë në tre rrethet me 24 objekte shërbimi. Duhet theksuar se në nivel komunash, ky shërbim është i mbuluar, me përjashtim të komunës Kolsh, që mbulohet nga posta qendrore Lezhë.

Infrastruktura rrugore

Pas vitit 1990, është aplikuar politika e ndarjes së përgjegjësiave dhe kategorizimi i rrugëve, por që nuk ka sjellë ende rezultate të kënaqshme, sepse në një pjesë të rrugëve u investua pjesërisht, por pjesa tjetër është drejt degradimit, kështu që gjendja aktuale e rrugëve rezultojnë të jetë nën normalen. Rrjeti rrugor i qarkut Lezhë ka një gjatësi prej 597.6 km rrugë, prej të cilave 345 km janë rrugë rurale nën administrimin e Këshillit të Qarkut Lezhë, ndërsa pjesa tjetër prej 252.6 km janë rrugë kombëtare dhe administrohen nga Ndërmarrja e Rrugëve Kombëtare.

Rrugët Rurale

Në 6-mujorin e parë të vitit 2001, Këshilli i Qarkut Lezhë, së bashku me qeverisjen vendore, në zbatim të ligjit, morën përgjegjësitë për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve rurale. Pas një studimi të kryer, janë përcaktuar qartë rrugët komunale, rurale dhe urbane. Infrastruktura e rrjetit rrugor rural paraqitet edhe më e dobët se ajo kombëtare për arsye se ka mungesë thuajse totale në investime nga ana e Ministrisë, pavarësisht se menaxhimi i mirë i fondeve dhe përkushtimi i Këshillit të Qarkut Lezhë nuk ka munguar. Shumica e rrugëve rurale nuk janë të shtruara dhe ka probleme me kanalet anësore kulluese, gjë që sjell nevojën e menjëhershme për investime të përgjithshme ose të pjesshme.

Rekomandime

Segmenti Lezhë-Shëngjin-Kunë. Kjo rrugë, me gjatësi 10 km, lidhet me portin e Shëngjinit dhe me plazhin. Është mjaft e dëmtuar për shkak të numrit dhe llojeve të automjeteve që kalojnë në të. Ky segment është plotësisht jashtë standardeve dhe

për nga gjerësia e saj. Pjesa e rrugës nga Shëngjini në Kunë është e pashtruar me asfalto-beton.

Përmirësimi i kësaj rruge dhe sjellja e saj në kushtet e një rruge moderne ndikon në mënyrë të ndjeshme në rritjen e biznesit dhe të fluksit të turistëve. Rikonstruksioni i këtij segmenti kërkon një fond prej 2.5 milion Euro.

Segmenti Lezhë-Vain. Kjo rrugë, me gjatësi 7.5 km, lidhet me lagunën turistike të Vainit. Kushtet teknike të saj janë nën normalen. Përmirësimi i kësaj rruge dhe sjellja e saj në kushtet e një rruge moderne do të ndikojë dukshëm në rritjen e të ardhurave të kësaj zone. Rikonstruksioni i këtij segmenti kërkon një fond prej 1.8 milion Euro.

Segmenti Autostradë-Tale (bregdet). Kjo rrugë është e gjatë 14 km dhe lidh komunitetin Zejmen - Shenkoll me autostradën dhe me bregdetin. Përmirësimi i kësaj rruge dhe sjellja e saj në kushtet e një rruge moderne do të ndikojë në zhvillimin e turizmit me mjaft perspective në këtë zonë dhe si rrjedhim edhe në ngritjen e mirëqënies. Për rikonstruksionin e saj nevojiten 2.5 milion Euro.

Segmenti Autostradë-Aeroport Gjadër. Aeroporti i Gjadrit, ndër më të njohurit në Shqipëri, nëse do të kthehet në aeroport civil, do të ndikojë ndjeshëm në fluksin e turistëve në qarkun Lezhë, prandaj është i nevojshëm edhe rikonstruksioni i kësaj rruge me gjatësi 1.5 km, që kërkon një fond prej 375 mijë euro. Segmenti Laç-Autostradë-Patok (bregdet). Gjatësia e kësaj rruge është 12 km. Përmirësimi i këtij segmenti që lidh me anë të transportit urban popullsinë e qyteteve të Laçit, Milotit dhe fshatrave me autostradën Tiranë – Shkodër dhe plazhin e Patokut, do të ndikojë pozitivisht në rritjen e të ardhurave, zhvillimin e turizmit, tregtisë, transportit, ruajtjen e përdorimit të mjeteve, zhvillimin e komunitetit dhe objekteve të shërbimit. Rikonstruksioni i saj kushton 1.5 milion Euro.

Segmenti Mamurras- Adriatik – Bregdet. Kjo rrugë është e gjatë 15 km dhe siguron lidhjen e komunitetit me autostradën dhe me bregdetin. Përmirësimi i kësaj rruge dhe sjellja e saj në kushtet e një rruge moderne është me mjaft interes për komunitetin e Mamurrasit dhe Fushë Kuqes, sepse ndikon në zhvillimin e turizmit, biznesit dhe rritjen e të ardhurave. Për rikonstruksionin e saj nevojiten rreth 1.5 milion Euro.

Segmenti Laç-Mamurras-Thumane. Ky segment lidh disa qendra të banuara me njëra tjetrën. Rehabilitimi i kësaj rruge do të ndikojë në zhvillimin e biznesit, në përmirësimin e transportit urban dhe shërbimet sociale, në rritjen e mirëqënies. Rikonstruksioni i saj kushton 500 mijë Euro.


Segmenti Rrëshen-Mërkurth - Kroj i Bardhë (Selitë), ujë kurativ. Kjo rrugë lidh disa qendra të banuara, ndikon në zhvillimin e turizmit malor dhe biznesit dhe si rezultat në rritjen e të ardhurave për këtë trevë. Gjithashtu, do të zvogëlonte lëvizjen e popullsisë për në zonat urbane.


Segmenti Mërkurth (Selitë) -Liqenet e Lurës. Gjatësia e rrugës është 16 km. Lidh komunitetin me një zonë me mundësi të mëdha të zhvillimit të turizmit malor, aktualisht pak i zhvilluar për mungesë infrastrukture. Krijon mundësinë e njohjes së kësaj mrekullie natyrore, jo vetëm nga shqiptaret, por edhe nga turistët e huaj. Rritet punësimi, rriten të ardhurat. Rikonstruksioni kushton 1.8 milion Euro.

Energjia Elektrike

Që nga viti 1992, sektori energjetik është riorganizuar disa herë dhe aktualisht Lezha është filial që mbulohet nga Divizioni Shkodër.

Harta e rrugëve në Qarkun e Lezhës



 Rrugë me rëndësi strategjike për zhvillim

 Rrugët kombëtare

 Qendër komune

 Kufi Rrethi

 Rrugë

 Fshatrat

Në territorin e qarkut Lezhë janë të instaluar 10 nënstacione të tensionit të lartë e të mesëm 6 kV dhë 10 kV. Gjëndja aktuale e nënstacioneve dhe e sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike është mjaft e amortizuar dhe ndërhyrja me investime është jo vetëm nevojë por edhe domosdoshmëri. Në gjendje të amortizuar janë edhe kabinat elektrike dhe sistemi i shpërndarjes në zonat rurale. Përveç amortizimit të sistemit, vitet e fundit është vërejtur edhe një mungesë me orare të stërzgjatura të energjisë (që varion nga 6 – 14 orë në ditë), gjë që ka sjellë paralizimin e biznesit, të shërbimeve të ndryshme sociale dhe mosplotësimin e nevojave të jetës së përditshme nga konsumatorët e, si rrjedhim, të ardhurat janë ulur, duke ndikuar në rritjen e varfërisë.

Biznesi dhe turizmi

Biznesi dhe turizmi janë faktorë që ndikojnë ndjeshëm në shkallën e zhvillimit dhe nivelin e jetesës së një rajoni. Deri në fund të vitit 2003, ndërmarrjet aktive të krijuara si persona fizikë janë 630 dhe si persona juridikë janë 345. Zhvillim të dukshëm, krijimi i ndërmarrjeve mori në vitin 2000, me 95 ndërmarrje si person fizik dhe 31 ndërmarrje si person juridik.


Volumi i ngarkim shkarkimit në portin e Shëngjinit, për vitin 2003 është më i lartë se në portin e Sarandës dhe pothuaj i njëjtë me portin e Vlorës. Grumbullimi dhe përpunimi i peshkut dhe produkteve të tjera ujore është një mundësi biznesi. Grumbullohet mbi 620 ton peshk në vit ku më shumë se gjysma është për eksport dhe pjesa tjetër tregtohet apo ruhet.

Porti i Shëngjinit i shërben të gjitha qendrave veriore dhe verilindore të Shqipërisë, njëkohësisht lidhet edhe me Malin e Zi dhe Kosovën nëpërmjet Korridorit tetë dhe rrugës Milot – Mirditë - Morinë. Tregtia me kryesore bëhet nëpërmjet Italisë e Greqisë.

	Bujqësi	Industri	Ndërtim	Transport	Tregti	Shërbime	Totali
Nr. Ndërmarrjeve	22	129	99	92	463	170	975

Tab.6 - Ndërmarrjet sipas aktivitetit ekonomik në Qarkun e Lezhës (Burimi: Instat 2003)

Ndërmarrjet tregëtare në Qark, sipas llojit të aktivitetit



Pra krijimi i ndërmarrjeve në tregti dhe shërbime është shumë i madh në krahasim me ndërtimin apo bujqësinë, gjë që tregon për nivelin e ulët të stimulimit të krijimit të ndërmarrjeve bujqësore dhe importimin i produkteve me një kosto të lartë nga jashtë vendit. Krijimi i mikrondërmarrjeve, rreth 90 %, nuk ndikon pothuaj fare në nivelin e jetesës në tërësi. Industria nxjerrëse dhe përpunuese e mineraleve, për vetë sasinë e mëdha të tyre në qarkun e Lezhës, zë një peshë të rëndësishme në zhvillimin e ekonomisë së Qarkut, por edhe të ekonomisë kombëtare. Në shërbim të kësaj

industrisë, deri në vitin 1996, kanë qenë 7 miniera bakri, 1 piriti si dhe 2 uzina të përpunimit të tyre. Pas këtij viti, ato janë mbyllur si rezultat i teknologjisë së vjetëruar dhe mungesës së investimeve në to. Janë të domosdoshme rivlerësimet e vendburimeve minerare në Gjajuj (Kalor) me përmbajtje ari, Sukaxhi (Ungrej) me 140 milion ton rezerva me përmbajtje titanomanjetit V2O5 – 2.08 %, TiO2-6% dhe Fe2O3 – 18%, Kaçinar mbi 150 ton V2O5-0.2%, TiO2-8% dhe Fe2O3-15-20%, Gurth – Spaç (Orosh) me përmbajtje pirit, zink, trupa armajtës, Perlat me përmbajtje piriti, Selitë me përmbajtje zinku, Rrënjolle me përmbajtje piriti, zinku, trupa armajtës, bakri (Cu) në Munellë Mirditë, ë si rrjedhim rihapja e fabrikave të pasurimit, përpunimit dhe shkrirjes së mineraleve me teknologji moderne do të ndikonte ndjeshëm në punësim, e si rezultat në rritjen e të ardhurave. Në industrinë ushqimore, funksionojnë disa linja të prodhimit të bukës, birrës, linja të përpunimit të qumështit dhe linja të përpunimit të peshkut. Në industrinë e prodhimit të materialeve inerte funksionojnë të licensuara rreth 20 linja në shtretërit e lumenjve Mat dhe Fan. Për t'u përmendur është edhe përpunimi i materialeve shkëmbore dhe dekorative, karakteristike është në Rrasfik (Rubik), Zejmen, Manati (Kolsh) etj..

Turizmi

Qarku i Lezhës ka një pozitë të favorshme gjeografike. Burimet natyrore turistike dhe klima e përshtatshme bëjnë që turizmi të jetë jo vetëm mundësi, por edhe ardhmja e qarkut tonë. Tërësia e këtyre faktorëve bëjnë të mundur zhvillimin e të gjitha llojeve të turizmit qoftë atij bregdetar, që mbetet edhe për të ardhmen me mundësi të mëdha zhvillimi, por edhe të turizmit malor, arkeologjik dhe historik.

Qarku i Lezhës ka një sipërfaqë turistike bregdetare prej 11000 ha, me vijë bregdetare 38 km dhe gjerësi të brezit bregdetar 3 km, që nga Velipoja në Veri deri në

Kepin e Rodonit në Jug. Gjatë vijës bregdetare ka vende mjaft të përshtatshme për fshatra turistike apo porte turistike .

Në këtë gjerësi shtrihet edhe kompleksi natyror i luginave Kune - Vain dhe Patok, që, për nga bukuritë që ka dhe shumëllojshmërinë e llojeve të flores e faunës që zotëron, është quajtur “Ornitologjia e Mesdheut“.

Masivet malore të shumta, me lartësi të mëdha mbi nivelin e detit, me pyjet dhe burimet që ndodhen në to, krijojnë bukuri të veçanta e mundësi të zhvillimit të turizmit malor e alpin. Për t'u përmendur janë bjeshkët e Kunorës me Kroin e Bardhë (uji kurativ që është mjaft i frekuentuar nga vizitorë sezonal apo pushues), apo kompleksi i liqeneve të Lurës rreth bjeshkës së Kunorës në Selitë, Mirditë, bjeshkët e Trodhnës Kurbin, të Velës në Lezhë, bjeshkët e Munellës, Oroshit, Kaçinarit, Xhuxhës në Mirditë.

Gjithashtu, objektet arkeologjike, historike, muzeale dhe ato të kultit i bëjnë një prezantim dinjitoz jo vetëm historisë, por edhe burimeve turistike të këtij Qarku.

Kështu në Lezhë, që daton në vitin 385 para e.s., ndodhen vendvarrimi i Heroit Kombëtar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu) Kalaja e Lezhës, Kuvendi i Arbërit.

Në Kurbin ndodhen kalaja e Sebastës, Kisha e Shna Ndout me shpellën e Shnavlashit, që është rast unikal në Shqipëri për nga vizitorët, Ipeshkvnia e Delbnishtit, Ura e Zogut, etj.

Në Mirditë ndodhen Kisha e Oroshit, Abacia e Mirditës, Sarajet e Gjon Marka Gjonit, Kisha e Shëlbueimit në Rubik etj. Mungesa e vëmendjes nga shteti apo pushteti vendor në përmirësimin e infrastrukturës turistike në këto treva ndikon dukshëm në zhvillimin e turizmit në qarkun e Lezhës.

Bujqësia

Së bashku me turizmin, bujqësia është një sektor mjaft i rëndësishëm dhe zhvillimi i saj ndikon në rritjen ekonomike të Qarkut. Territori bujqësor fillon nga 0-25 m mbi nivelin e detit dhe përfundon në lartësinë 1000-1200 m.

Qarku i Lezhës zotëron një fond toke prej 161 910 ha, nga e cila 35152 ha ose vetëm 21.7 % është tokë bujqësore. 30937 ha e tokës bujqësore është e ndarë, ndërsa pjesa tjetër e tokës bujqësore prej 1041 ha është e papërdorur.

Sipërfaqja mesatare e tokës së ndarë bujqësore për familje, në 2001, është 0.84 ha (sipas INSTAT). Nga të dhënat administrative ka rreth 40 % më shumë familje kështu që sipërfaqja e tokës së ndarë bujqësore për familje është akoma më e vogël, mesatarisht rreth 0.60 ha.

Emërtimi	Fondi i tokës	Tokë e ndarë bujqësore
Qarku Lezhë	161.910	30.938
Kurbini	27.343	10.123
Lezha	47.867	16.607
Mirditë	86.700	4.208

Tab. 7 - Ndarja e tokës për rreth (Gjendja Civile 2004)

Vihet re që rrethi Mirditë ka një fond tokë aq sa Lezha dhe Kurbini të marra së bashku por krahasuar me tokën e ndarë bujqësore ky fenomen është krejtësisht ndryshe. Kjo tregon se Mirdita është një vend me shtrirje gjeografike të madhe por më pak tokë bujqësore dhe të një kategorie të dobët.

Prodhimet Bujqësore

Treguesit kryesor të prodhimit bujqësor (sip. e punuar dhe prodhim) kanë ardhur nga viti në vit në rënie. Pas vitit 1990 është ndjekur një politike stimuluese e bujqësisë me kredi me interes të ulët. Fermerëve iu dhanë dhjetra traktorë e mjete të tjera bujqësore, u subvencionuan inputet e ndryshme bujqësore, por, pas trazirave të 1997-ës, u ndërpre plotësisht dhënia e kredive, zonat fushore me prodhues të Lezhës e Kurbinit përmythen nga reshjet 2-3 herë në vit, për mungesë të rihapjes së kanalizimeve apo mosvënies në punë të hidrovoreve (për mungesë energjie apo amortizime të pjesëve mekanike), gjë që pengon fermeret për

mbjellje për pasojë rritet sipërfaqja e tokës djerr. Njëkohësisht rritja e çmimeve të punimit dhe inputeve pengojnë zhvillimin e bujqësisë në tërësi.

Po kështu, cilësia e ulët e tokës, mungesa e infrastrukturës së ujitjës, ndarja e tokës në ngastra të vogla për shkak edhe të terrenit malor por edhe në fushë, largësia e madhe nga qendrat urbane dhe mundësia shumë e paktë e daljes në treg për arsye të infrastrukturës janë faktorë të tjerë që ndikojnë në krijimin e fermave apo tregtimin e prodhimeve dhe, si rezultat, edhe në zhvillimin e bujqësisë në qarkun e Lezhës. Në drithëra, misri zë vendin e parë për sipërfaqe të mbjellë, por vihet re që gruri në rrethin e Lezhës zë rreth 86 % të sipërfaqes së përgjithshme të mbjellë në qark. Misri është mjaft i përhapur në të tre rrethet për përdorim nga bagëtia, por shumë familje të varfëra e përdorin atë edhe për të bërë bukë për vete.

Perimet zënë një pjesë të konsiderueshme të sipërfaqes së mbjellë, sidomos në zonat rurale çdo njësi ekonomike familjare i kushton një sipërfaqe të caktuar perimeve, fasules, patateve. Por dhe bostani mbillet shumë në zonat fushore, madje në disa njësi shërben edhe si burim të ardhurash për jetesë. Të mbjellat në tagji janë gjithnjë në rritje, ato shërbejnë si burim kryesor për ushqimin dimëror të blegtorisë dhe për kullotë.

Klima dhe pozicioni gjeografik i qarkut Lezhë favorizojnë rritjen e shumë llojeve të bimëve mjekësore si: sherebela, boronica, çaji i veriut, lisna, trumza, etj. Prodhimi i këtyre bimëve shërben si burim fitimi sezonal për të papunët në zonat përreth.

Për sa i përket drurëve frutorë, Lezha ka veçori edhe rritjen e ullirit dhe agrumeve. Këtu ekziston edhe një linjë e konservimit të ullirit në Pllanë, Zejmen, por është e domosdoshme ngritja e dy linjave të konservimit të ullirit, një në Blinisht (ose Kallmet) dhe një në Mamurras. Ndërsa në Mirdite rriten molla, arra, qershia, etj., prandaj shihet si domosdoshmëri ngritja e një linje përpunimi të frutave. Po kështu, e domosdoshme është ngritja e linjave të përpunimit të prodhimit fruta – perimeve në Lezhë dhe Laç (Kurbini).

Gjithashtu, sipërfaqja e përdorur për vreshtari, pas një dëmtimi që pati në vitin 1990, vitet e fundit ka ardhur në rritje. Shkak për këtë është jo vetëm tradita e hershme ndaj vreshtave apo ullirit, por edhe leverdia ekonomike që kanë ato.

Për t'u përmendur janë vreshtaria në Bukmirë (e njohur në të gjithë Shqipërinë), Mirditë, me lloje rrushi: shesh i zi, shesh i bardhë, kallmet, 10 korriku, vërnac etj., dhe vreshtaria në Kallmet, Lezhë me lloje rrushi: Kallmet (ashtu siç ka edhe emrin

Rrethi	Sip. mesatare e tokës për familje (në ha)	Numri i Komunave me			Pjesa e tokës bujqësore e papërdorur (ha)
		Deri 1 ha/familje	1 – 2 ha/familje	2.01 – 3 ha/familje	
Kurbini	0,56	3	1	S'ka	2.565
Lezha	0,75	3	6	S'ka	8.672
Mirdita	0,36	6	1	S'ka	1.804
Qarku Lezhë	0,60	12	8	S'ka	13.041

Tab. 8 - Ndarja e tokës për familje (Gjendja Civile 2003)

fshati), shesh i zi dhe i bardhë. Si rezultat i moskreditimit në zonat përkatëse nuk ka mundësi përpunimi për verëra apo pije të tjera alkoolike. Prandaj është me mjaft interes ekonomik ngritja e një linje përpunimi për prodhim verë dhe pijesh alkoolike në Bukmirë (Mirditë) dhe një në Kallmet (Lezhë).

Megjithatë, prodhimi aktual i verërave dhe pijeve del shumë pak në treg, pasi përdoret për konsum familjar, duke bërë që të mos shfrytëzohet plotësisht një burim i mundshëm të ardhurash.

Blegtoria

Sektori i blegtorisë është mjaft i rëndësishëm për të ardhurat e banorëve. Pas vitit 1992 kemi një rritje të numrit të përgjithshëm të krrerëve në bagëti të imta, gjedhë, shpendë e bletë. Por shqetësues mbetet fakti i mbrojtjes profilaktike të tyre nga sëmundje të ndryshme. Rritja e tyre është natyrale dhe më pak komplekse.

Të imtat zënë vendin kryesor në blegtori, pasi rriten më shpejt dhe me kosto më të ulët. Është me shumë interes ekonomik për komunitetin ngritja e një linje përpunimi të mishit në Mirditë dhe një në Lezhë. Duhet theksuar së Zadrima e Lezhës është e famshme për rritjen e gjelit të detit.

Mishi dhe qumështi janë një burim i konsiderueshëm të ardhurash, por kjo vetëm për fshatrat në afërsi të qendrave urbane. Kështu, në Lezhë ka katër baxho të përpunimit të qumështit (Shënkoll, Zojz, Balldre, Dajç) dhe në Kurbin ka një baxho të përpunimit të qumështit.

Prodhimet e detit janë të shumëllojshme: peshqit janë 12 lloje (veçohen qefulli, levreku, krapë, ngjala, sardelja, blini, karkaleci, shpalci, toni, merluci), lundërat, rosat, delfinët, peshkaqenët, etj.

Disa nga dukuritë sociale në qarkun e Lezhës

Zyra e koordinimit të pushtetit vendor pranë Këshillit të Qarkut, në bashkëpunim me drejtuesit e njësive vendore dhe kryetarët e fshatrave, ndërmoi një studim për disa nga dukuritë sociale të rajonit.

Si në të gjithë vendin, edhe në rajonin tonë problematika sociale është e gjerë, por të dhënat e qëmtuara gjatë kësaj periudhe, relativisht të shkurtër, na mundësojnë për të rrokur e trajtuar, në këtë fazë të parë të studimit, vetëm disa nga aspektet më të rëndësishme të këtij spektri të gjerë social.

Objekt i këtij studimi u bënë: emigracioni, dukuria e gjakmarrjes, konfliktet dhe divorcet.

Emigracioni

Nga të dhënat e grumbulluara në njësitë vendore të Qarkut Lezhë rezultoi se 12.5 % e popullsisë së rajonit është në emigracion (26.342 shtetas).

Përqindja e të emigruarve jashtë vendit varion nga 5.4 % në Komunën e Fanit të Mirditës, që është më e ulta, në 22.9 % në Komunën e Shëngjinit, që përbën shifrën më të lartë.

Përqindjen më të ulët të të emigruarve e kanë komunat: Fan 5.4 % , Selitë 5.7 % , Kaçinar 5.8 % , Ungrej 62 % .

Vihet re se rrethi i Mirditës, krahasuar me zonat e tjera të rajonit, ka një përqindje më të ulët. Mendojmë se kjo lidhet me anën tradicionale në këtë trevë, e cila, si më konservatore, ka më shumë prirje për migrime, sesa për emigrime. Komunat: Shëngjin, Balldre, Fushë-Kuqe, Kallmet, Blinisht etj. kanë përqindjen më të lartë të emigrimit. Kjo lidhet me mundësitë më të favorshme të pozicionit gjeografik që kanë këto njësi në hartën administrative të qarkut, por edhe për një prirje e koncept më të evoluar për të përballuar sfidat social-ekonomike të kohës. Të dhënat tregojnë se 49.7 % kanë emigruar në Itali, 35.4 % në Greqi dhe 14.9 % në SHBA e vende të tjera.

Të palegalizuar janë 5606 emigrantë ose 21.3 % , kundrejt 20.738 emigrantë ose 78.7 % të legalizuar.

Legalizimet e emigrantëve janë bërë kryesisht me sipërmarrje individuale, pasi nga verifikimet tona del se tri zyrat e punësimit në qarkun e Lezhës nuk kanë asnjë të dhënë për emigracionin e legalizuar. Kjo, si pasojë e vëmendjes së pakët që ka qeveria shqiptare kundrejt kësaj dukurie.

Fakti që 5606 emigrantë, shifër kjo afërsisht e barabartë me popullsinë e komunës së Kolishit, janë të palegalizuar.

5102 familjet e emigruara jashtë vendit, afërsisht të barabarta me numrin e familjeve të bashkisë Mamurras, flasin për një gjendje të rënduar të situatës social-ekonomike të rajonit tonë.

21 045 familje ose 40.6 % e familjeve në shkallë qarku kanë të paktën një emigrant jashtë vendit, çka do të thotë se këto familje përballojnë jetën e tyre pa ndihmën e shtetit.

Konfliktet

Në të gjitha njësitë vendore janë vënë re 1209 konflikte, ku përfshihen 3022 familje në shkallë qarku ose 5.8 % e tyre. Numri më i madh i konflikteve rezultoi në Komunat: Fushë-Kuqe, Shëngjin dhe Bashkitë Laç e Rubik, kurse numri më i vogël i tyre është në komunat: Ungrej, Kaçinar, Selitë dhe Kthellë.

367 konflikte ose 30 % e tyre janë zgjidhur, ndërsa 755 ose 62.4 % janë në proces, 1076 ose 78.9 % janë konflikte për shkaqe pronësie. 16 konflikte ose 1.3% e tyre deklarohen për shkaqe institucionale (kjo duhet parë me rezervë).

Të gjitha njësitë vendore e vlerësojnë pozitivisht rolin e punonjësit

të policisë së zonës (P.P.Z.).

294 konflikte, ose 24.3 % e tyre, janë në zonat urbane, kurse 915, ose 75.7 % e tyre, në zonat rurale.

Fakti që 88.9 % e konflikteve ndodhin për shkaqe pronësie dhe 75.7 % e tyre ndodhin në zonat rurale lidhet, së pari, me punën pa përgjegjësi të komisioneve të tokave, por edhe me faktorë të tjerë, si: lëvizjet e pakontrolluara të popullsisë e, mbi të gjitha, zbatimi i një politike agrare jo efektive në këtë periudhë tranzicioni. Përvoja ka treguar se kjo kategori konfliktesh është shkallëzuar deri në vepra të rënda penale, duke stimuluar e ringjallur dukurinë e vjetër të gjakmarrjes.

Gjakmarrja

Kjo dukuri shtrihet në të gjitha njësitë vendore të qarkut Lezhë, me përjashtim të komunës Blinisht, ku nuk deklarohet asnjë rast i tillë. Numrin më të madh të rasteve të gjakmarrjes e gjejmë në njësitë vendore: Milot, Rrëshen, Kaçinar, Balldre, Zejmen, Rubik, Fushë-Kuqe, ku vatrave më të nxehta janë fshatrat: Torovicë me 9 raste, Kaçinar 8 raste, Mali i Bardhë 6, Gurëz 5, Milot (qytet) 4, por edhe në bashkitë Laç, Rrëshen e Lezhë, me përkatësisht 16, 10 dhe 8 raste.

Shqetësues është fakti se në të gjitha qendrat urbane (qytetet) kjo dukuri shfaqet, duke zënë 23 % të rasteve në shkallë qarku.

Sipas rrethëve: Lezha 72 raste ose 35.4 %, Mirdita 68 ose 33.4 %, Kurbini 63 ose 31.2 %. Në raport me popullsinë Mirdita ka numrin më të madh të rasteve.

- Në 65 fshatra të rajonit nuk është shfaqur kjo dukuri.

- Në shkallë qarku rezultojnë të ngujuara 74 familje, me 427 frymë, prej të cilëve 111 fëmijë të moshës deri në 16 vjeç, që janë të privuar të ndjekin shkollën.

- Fakti që 125 raste janë pajtuar ose janë në proces pajtimi përbën një tregues pozitiv, por fakti tjetër që 78 raste ose 38 % e tyre nuk janë futur ende në procesin e pajtimit përbën një shqetësim të madh.

- Krimi brenda familjes, edhe pse tradicionalisht nuk është i njohur, shfaqet si dukuri e re në shifra mjaft të ulta, por që duhet vënë në vëmendjen e opinionit shoqëror.

Misionet e pajtimit janë të organizuara dhe veprojnë në tri rrethet e qarkut Lezhë, duke bërë një punë të lavdërueshme në pajtimin e 50 rasteve, ku veçojmë bashkitë: Laç, Rubik e Milot, por më i rëndësishëm është parandalimi i kësaj dukurie. Mendojmë se faktorët kryesorë që favorizojnë dukurinë e gjakmarrjes janë:

- Mendësia e vjetër primitive për të marrë gjak sipas kanunit të maleve.
- Puna e pamjaftueshme e organeve të rendit dhe atyre gjyqësore për parandalimin e krimit, duke mos ndërhyrë në kohën e duhur e duke përdorur metoda korruptive në procese gjyqësore.
- Motoja e kufizimit të gjakmarrjes duhet të jetë: Parandalimi i krimit, duke zbatuar ligjet dhe pajto rastet në emër të jetës e jo të traditës.
- Puna e vazhdueshme për edukimin e brezave të rinj me normat e reja të marrëdhënieve qytetare dhe vlerësimi i së drejtës zakonore si pjesë e vyer të traditës dhe jo si mënyrë e rregullimit të marrëdhënieve nëpërmjet vetëgjyqësisë.

Ku më shumë e ku më pak, kjo dukuri është shtrirë në të gjithë territorin. Numrin më të madh të rasteve e ka bashkia Lezhë: 69 ose 20.2 % e rasteve në shkallë qarku, komuna Shëngjin: 44 ose 12.9 %, bashkia Laç: 35 ose 10.2 %, bashkia Rrëshen: 30 ose 8.7 % të tyre.

E krahasuar me numrin e familjeve, kjo dukuri është më e përhapur në: Shëngjin, Lezhë e Rrëshen.

Nga të dhënat del se 80 % e familjeve të divorcuara lidhen me shkaqe të ndryshme, kryesisht ekonomike; vetëm 20% e tyre lidhen me emigracionin.

Numri i ulët i divorceve për shkaqe emigracioni, krahasuar me rajone të tjera të Shqipërisë, tregon se familja në qarkun tonë është shumë më e konsoliduar dhe respekton e vijon traditën e këtyre trevave.

Edhe pse përqindja e familjeve të divorcuara në qarkun tonë është e ulët (6 për mijë), pasojat e kësaj dukurie janë ndjerë, krahas të tjerave, edhe te fëmijët e këtyre familjeve. 118 nxënës ose 25 % e familjeve të divorcuara kanë braktisur shkollën, ndërsa 61 ose 13 % e tyre kanë marrë rrugën e emigracionit.

Ky studim shënon përpjekjen e parë institucionale në qarkun e Lezhës për njohjen dhe evidencimin e dukurive sociale të rajonit dhe, për rrjedhojë, përbën një përvojë të re në këtë drejtim, e cila duhet thelluar e pasuruar më tej në të ardhmen.

Divorcet

Kapitulli II Shtrirja e arsimit baze për të gjithë

Ndryshimet e mëdha socialekonomike dhe politike që ndodhën në Europë, gjatë viteve '80, u pasuan edhe në vendin tonë në fund të viteve '80 dhe në fillim të viteve '90 e në vazhdim.

Këto ndryshime, si në të gjitha sferat e shoqërisë shqiptare, përfshinë edhe arsimin si një ndër elementët më të rëndësishëm të zhvillimit të shoqërisë. Këto ndryshime nuk mund të ishin rezultative, në qoftë se nuk do të përfshinin në plan të parë edhe transformimin e plotë të sistemit arsimor, që, për hir të së vertetës, duhet thënë se është humbur shumë kohë në realizimin e tij.

Zhvillimi ekonomik i qarkut Lezhë është i lidhur ngushtësisht e në mënyrë të drejtpërdrejtë me nivelin e sistemit arsimor.

Parë në këtë këndvështrim, sistemi arsimor aktual është tejet i prapambetur dhe shumë pak i aftë për të përgatitur gjenerata të reja të denjë për t'iu përshtatur kushteve të reja që kërkojnë rregullat e ekonomisë së tregut dhe Europa e Bashkuar.

Natyrshëm me evoluimin në kohë dhe parë në tranzicionin e stërgjatur në vendin tonë, doemos lindin disa pyetje që duan përgjigje në kohën e tyre nga autoritetet përgjegjëse që menaxhojnë zhvillimin e arsimit në vendin tonë. Dhe konkretisht:

- Çfarë trashëgojmë nga e kaluara e arsimit në këtë rajon?
- Cila është gjendja aktuale e tij?

Ky material, që po paraqesim në këtë strategji rajonale, synon të orientojë zhvillimin e arsimit në rajon, në përputhje me kushtet e reja që kërkon zhvillimi i shoqërisë shqiptare në tërësi dhe i rajonit të Lezhës në veçanti.

Zhvillimi i arsimit në trevat e Lezhës

Arsimi në këtë rajon ka një histori të hershme me vlera kombëtare, ku spikat veçanërisht kontributi i klerikëve katolikë, të cilët me punën e tyre kultivuan tek banorët idenë se pa zhvillimin e arsimit, nuk mund të kishte një shoqëri të zhvilluar.

Shkollat e para shqipe në këtë rajon e kanë zanafillën që nga gjysma e shekullit 17-të. Në vitin 1632, hapet në Ipeshkvninë e Shnapremtës, në Kurbin shkolla e parë fillore, 6 vjet më vonë 1638, në Velë të Vendit dhe në Pllanë të Lezhës, u hapën të tjera shkolla.

Në vitin 1639 hapet në Blinisht të Zadrimës, Gjimnazi i parë i Zadrimës, drejtor i parë i të cilit ka qenë Karl Mirandulani.

Përpyekjet e vazhdueshme të klerit katolik të kohës për zhvillimin e arsimit kombëtar, kulmuan me organizimin e Kuvendit të Arbnit në Mërqi të Lezhës, në janar të vitit 1703, nga Papa Klementi XI me origjinë kurbinase.

Thelbi i këtij Kuvendi ishte mbrojtja e identitetit të gjuhës dhe identitetit tonë kombëtar, duke qenë kështu dëshmia me autentike e hershmërisë së arsimit në këtë rajon.

Shekulli XIX u karakterizua me hapjen e shkollave të reja në rajon si në Troshan, Orosh, Kallmet etj.

Qeveritë e krijuara pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, pavarësisht eksperiencës së tyre, kushteve në të cilat ndodhej vendi, i kushtuan një kujdes të veçantë zhvillimit të arsimit në përgjithësi, për rrjedhojë edhe në territoret e rajonit tonë. Në këtë pikë veçojmë kontributin e dhënë nga Mbreti Zog dhe administrata e tij, të cilët hodhën themelet e zhvillimit të një arsimit modern, duke synuar zhdukjen e

analfabetizmit.

Pas vitit 1944 e në vazhdim, shënohet një masivizim i shkollave dhe shpërndarja e tyre në të gjithë vendin e natyrisht dhe në rajonin tonë.

Arsimi parashkollor

Arsimi parashkollor është hallka e parë e arsimit parauniversitar. Edhe pse jo i detyrueshëm, kjo hallkë e arsimit përfaqësohet nga një sistem i unifikuar kopshtesh publike e jopublike, në të cilat tërhiqen fëmijë të moshës 3 – 6 vjeçare. Në territorin e qarkut ka dy lloje kopshtesh publike, me ushqim dhe pa ushqim. Së fundi, kanë filluar të funksionojnë edhe kopshtet jopublike (private).

Në qarkun e Lezhës, gjatë periudhës së tranzicionit dhe në mënyrë të veçantë gjatë vitit 1997, rrjeti i kopshteve u dëmtua rëndë dhe u shoqërua me shkatërrime të objekteve, pushtime të tyre dhe shkurtime të kuadrit mësimdhënës.

Këto veçori përfshinë më tepër ato kopshte të cilat ishin të shpëputura si objekte nga shkollat.

Për të provuar sa thamë më sipër, po sjellim disa shembuj: Në komunën Shënkoll, krahasuar me para viteve '90-të, janë 4 kopshte më pak, në komunën Kolsh 3, në komunën Shëngjin 2, ndërsa në komunën Ungrej ky shërbim nuk funksionon fare. E

Rrethi	Publike		Jopublike	
	Gjithsej	Me ushqim	Gjithsej	Me ushqim
Lezhë	42	3	7	4
Kurbin	21	0	2	0
Mirditë	23	1	0	0
Tot.Qarku	86	4	9	4

Tab.9 - Numri i kopshteve sipas kategorisë (Burimi: Drejtoria e Arsimit 2004)

Rrethi	Publike		Jopublike	
	Gjithsej	Me ushqim	Gjithsej	Me ushqim
Lezhë	1.844	263	214	136
Kurbin	1.343	0	93	0
Mirditë	740	95	0	0
Tot.Qarku	3.927	358	307	136

Tab.10 - Numri i fëmijëve në kopshtet (Burimi: Drejtoria e Arsimit 2004)

Rrethi	Regjist. klasë e parë	Ardhur nga kopshti	Raporti në %
Lezhë	1.425	723	51
Kurbin	1.118	684	61
Mirditë	722	371	51
Tot.Qarku	3.265	1.778	54,5

Tab.11 - Numri i fëmijëve të regjistruar në klasë të parë në qarkun Lezhë dhe raporti me numrin e fëmijëve të regjistruar në këtë klasë të ardhur nga kopshtet (Burimi: Drejtoria e Arsimit 2004)

njëta panoramë paraqitet dhe në rrethet Kurbin dhe Mirditë, ku në zonat e thella rurale, shërbimi i arsimit parashkollor thuhet nuk funksionon fare, ndërsa në zonat urbane dhe suburbane, përmasat e këtij shërbimi kanë rënie të pjesëshme.

Për të bërë më të qartë funksionimin e sistemit të arsimit në qarkun e Lezhës po japim, më poshtë të detajuara, numrin e shkollave, numrin e nxënësve, numrin e mësuesve dhe shkallën e kualifikimit të tyre.

Përgjithësisht, gjendja e objekteve shkollore në 75% të tyre është e mirë, por kërkohen fonde të konsiderueshme dhe të vazhdueshme për mirëmbajtjen e tyre në gjendje të përshtatshme për zhvillimin e mësimi.

Rrethi	Numri i shkollave 8-vjeçare	Numri i shkollave të mesme të përgjithshme	Nr. i shkollave të mesme profesionale
Lezhë	34	10	2
Kurbin	27	4	-
Mirditë	45	4	1
Tot. i Qarkut	106	18	3

Tab.12 - Numri i shkollave sipas rretheve
(Burimi: Drejtoria e Arsimit 2004)

Shpërndarja e objekteve shkollore në mënyrë të detajuar sipas bashkive, komunave dhe fshatrave paraqitet si më poshtë (Tab.13,14 dhe15):

Rrethet	Mësues gjithsej	Me arsim përkatës	Pa arsim përkatës	% pa arsim
Lezha	253	235	18	7.1
Kurbini	175	160	15	8.6
Mirdita	153	143	10	6.5
Qarku Lezhë	581	535	43	7.4

Tab.13 - Numri i Mësuesve që japin mësim në klasat 1-4 (Cikli i Ulët)
(Burimi: Drejtoria e Arsimit 2004)

Rrethet	Mësues gjithsej	Me arsim përkatës	Pa arsim përkatës	% pa arsim
Lezha	353	313	40	11.3
Kurbini	265	245	20	7.5
Mirdita	216	189	27	12.5
Qarku Lezhë	834	747	87	10.4

Tab.14 - Numri i Mësuesve që japin mësim në klasat 5-8 (Cikli i Lartë)
(Burimi: Drejtoria e Arsimit 2004)

Rrethet	Mësues gjithsej	Me arsim përkatës	Pa arsim përkatës	% pa arsim
Lezha	138	131	7	5
Kurbini	77	77	0	0
Mirdita	88	84	4	4,5
Qarku Lezhë	303	292	11	3,6

Tab.15 - Numri i Mësuesve që japin mësim në shkollat e mesme
(Burimi: Drejtoria e Arsimit 2004)

Përçindja e analfabetizmit

Burimi: Ministria e Arsimit dhe Shkencës (Raporti vjetor 2003), bazuar në të dhënat e Instat 2001



Shalla e analfabetizmit për personat mbi 10 vjeç (në %)



Harta tregon shkallën e analfabetizmit në Shqipëri për periudhën 1989 - 2001.

Në vitin 1989 rajonet me shkallë të ulët të analfabetëve, gjenden në pjesën juglindore të vendit: Devoll, Kolonjë dhe Korçë dhe ato në pjesën jugore si Delvina, Gjirokastra dhe Saranda.

Shkalla me e lartë e analfabetizmit gjendej në Mirditë, Mat, Pukë, Librazhd, Lezhë dhe Kukës. Shkalla e analfabetizmit në Tiranë ishte vetëm 6,1 %, një nga më të ultat në vend.

Në të dhënat e gjendjes civile për vitin 2001, shfaqet një pamje krejt tjetër përsa i përket këtij problemi.

Parabariztë në shkallën e analfabetizmit ndërmjet pjesës veriore dhe juglindore, nuk ekzistojnë më. Nga këto të dhëna, rajonet me shkallë më të lartë analfabetizmi janë Berati, Delvina, Dibra, Kukësi dhe Kurbini. Delvina klasifikohet si një nga rrethet me shkallën më të lartë të analfabetizmit, krahasuar me të dhënat e vitit 1989 (5,4 % kundrejt mesatares së vendit prej 1,6 %). Kjo për shkak të emigrimit të lartë. Shkalla më e ulët e analfabetizmit haset në Fier, Gjirokastrë, Kolonjë dhe Korçë.

Në shkollat e qarkut të Lezhës, për vitin shkollor 2003-2004, kanë frekuentuar gjithsej 33244 nxënës. Shpërndarja sipas cikleve dhe rretheve është si më Tab.16.

Rrethet	Nxënës Gjithsej	Klasa 1-4	Klasa 5-8	Shkolla e Mesme
Lezha	14.664	5.718	6.266	2.680
Kurbini	11.449	4.894	4.829	1.726
Mirdita	7.131	2.792	2.865	1.474
Qarku Lezhë	33.244	13.404	13.960	5.880

Tab.16 - Shpërndarja e nxënësve sipas cikleve dhe rretheve
(Burimi: Drejtoria e Arsimit 2004)

Braktisja e Shkollës

Një ndër problemet shqetësuese të arsimit në qarkun e Lezhës, ndonëse me përmasa jo të mëdha, por me pasoja për shfaqjen e analfabetizmit, është fakti së në vitin shkollor 2003-2004, kanë braktisur shkollën rreth 211 nxënës ose 0.8% e numrit total të nxënësve të shkollave 8 vjeçare. Nga këta nxënës që kanë braktisur shkollën 78% e tyre kanë arsye ekonomike, 22% lidhet me mosvlerësimin sa e si duhet nga ana e prindërve të nevojës së arsimimit të fëmijëve të tyre.

Rrethet	Nr.i nxënësve gjithsej	Nga këto femra	% femra
Lezha	11.984	5.869	48,97
Kurbini	9.723	4.812	49,49
Mirdita	5.657	2.844	50,27
Qarku Lezhë	27.364	13.525	49,42

Tab.17 - Përbërja gjinore e nxënësve të shkollës
(Burimi: Drejtoria e Arsimit 2004)

Rrethet	Mbaruan klasën e tetë viti 2002-2003	Regjistruhen në shkollë të mesme 2003-2004	%
Lezha	1.312	913	69,58
Kurbini	976	591	60,55
Mirdita	699	407	58,22
Qarku Lezhë	2.987	1.911	63,97

Tab.18 - Numri i nxënësve që mbarojnë klasën e tetë dhe shkojnë në shkollë të mesme
(Burimi: Drejtoria e Arsimit 2004)

Rrethet	Nr.i nxënësve gjithsej	Nga këto femra	% Femra
Lezha	2,680	1,431	53,39
Kurbini	1,726	941	54,51
Mirdita	1,474	653	44,30
Qarku Lezhë	5,880	3,025	51,44

Tab.19 - Numri i nxënësve në arsimin e mesëm
(Burimi: Drejtoria e Arsimit 2004)

Arsimi Profesional

Arsimi i formimit profesional (AFP) synon pajisjen e nxënësve me kualifikime profesionale, që u japin atyre shanse për punësim në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, i përgatit ata si qytetarë të aftë për t'iu përshtatur zhvillimeve ekonomike-sociale, bazuar në parimet e demokracisë dhe ekonomisë së tregut, si dhe për të kontribuar aktivisht në këto zhvillime.

Në qarkun e Lezhës funksionojnë shkolla të AFP-së publike dhe jopublike.

Shkollat publike të AFP-së në territorin e qarkut tonë kanë filluar të ringjallen vitet e fundit, pas zhvlerësimit total të viteve të para të demokracisë si të paafta për t'iu përshtatur kushteve të reja të ekonomisë të tregut. Megjithatë, ky arsim sot vazhdon të njohë vetëm zhvillime modeste. Po t'u referohemi shifrave, rezultoni se në rrethin e Kurbinit nuk ka asnjë shkollë të aftësimit profesional, ndërsa në Lezhë ky arsim ka filluar të lindë si rezultat i hapjes së tre degëve profesionale; turizëm, ekonomik dhe pedagogjike. Në Ishull Lezhë funksionon një degë e arsimit profesional për fermerë, por kjo degë është drejt mbylljes si rezultat i mosfrekuentimit nga nxënësit. Në rrethin e Mirditës (Rubik) funksionon pa ndërprerje shkolla publike e aftësimit profesional, e cila duhet të konsolidohet më tej.

Shkollat jopublike kanë filluar të lindin në qarkun e Lezhës si një mundësi e mirë për zhvillimin e këtij arsimit. Përmendim; a) në rrethin e Lezhës, shkolla e aftësimit profesional "Gjon Fausti"; b) në Krajën të Komunës Blinisht, me një degë 5-vjeçare (për fermerë, pak e frekuentuar) dhe dy degë 2-vjeçare (mekanike dhe elektrike).

Këto shkolla jopublike janë hapur nën kujdesin dhe financimin e klerit katolik në këto treva. Deri më sot nuk ka një nismë të mirëfilltë të biznesit privat vendas për hapjen e shkollave jopublike të AFP-së.

Me gjithë ndërhyrjet reformuese të ndërmarra dhe mbështetjen e donatorëve të ndryshëm, AFP-ja në qarkun tonë, pavarësisht nga shenjat pozitive për një gjallërim të tij, vazhdon të jetë me një reputacion të ulët dhe të mos luajë rolin e duhur në zhvillimet aktuale dhe të pritshme. Ai vazhdon të jetë i ngarkuar me probleme të shumta, si:

- Lidhja e AFP-së me tregun e punës vazhdon të jetë mjaft e dobët;
- Ka mungesë, thuajse të plotë të teksteve dhe të materialeve të tjera në mbështetje të mësimdhënies;
- Ka mungesa në financimin e AFP-së në një kohë kur çdo ndryshim reformues, kërkon një kosto të lartë, si nga pikëpamja e burimeve njerëzore, ashtu edhe nga burimet materiale dhe financiare;
- Niveli i hyrjes së nxënësve në AFP është më i ulët se në shkollat e mesme të përgjithshme dhe, në një masë të dukshme ndikon në cilësinë e përvetësimit të programit mësimor;
- Rezultatet që arrijnë nxënësit në arsimin profesional janë përgjithësisht të ulëta, si në rezultatet teorike, ashtu edhe në eksperiencat praktike.

Faktorët që ndikojnë zhvillimin e arsimit në qarkun e Lezhës, janë: i) Migracionet e mëdha të popullsisë; ii) Mungesa e infrastrukturës rrugore; iii) Amortizimi i objekteve shkollore; iv) Mungesa e pajisjeve laboratorike; v) Problemet e vazhdueshme të mungesës së energjisë elektrike; vi) Pagat e ulëta për personelin

mësimdhënës; vii) Mungesa e teksteve; viii) Mungesa e personelit të arsimuar me arsim përkatës kryesisht në shkencat ekzakte (matematikë, biologji-kimi, fizikë, etj.), si dhe ato të gjuhëve të huaja (anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht etj.).

Faktorët e mësipërm ndikojnë në zhvillimin e arsimit, përballë kërkesave e ekonomisë së tregut.

Kapitulli III

Nxitja e barazise gjinore dhe fuqizimi i rolit të gruas

“Nxitja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i rolit të gruas është objektivi i tretë i mijëvjeçarit për zhvillim. Eliminim, mundësisht deri në vitin 2005, i dallimeve gjinore në arsimin fillor e të mesëm dhe, deri në vitin 2015, në të gjithë nivelet e arsimit është synimi kryesorë i këtij objekti.

Ky synim lidhet me raportin e vajza - djem në arsimin fillor, 8 vjeçar e të mesëm, si dhe me punësimin dhe rolin e gruas në vendimmarrje.

Sipas analizave në nivel kombëtar del se Shqipëria mundet ta përmbushë këtë objektivi dhe se shkalla e mbështetjes së politikave, kuadrit ligjor, burimeve të financimit, ndërgjegjësimit të publikut etj., për ta përmbushur atë deri në vitin 2015, është normale.

Treguesit gjinore

Në popullsinë e qarkut Lezhë femrat zënë 49,8% të popullsisë. Në zonat urbane femrat zënë 39,5% dhe në zonat rurale 44%.

Në fshat jetojnë 60,5% e popullsisë së qarkut, ose 2,7% më shumë se mesatarja e vendit që është 57,8%. Këto tregues janë të ndryshueshëm për shkak të migrimit dhe emigrimit.

	Qarku	Mosha 0-14 vjeç	15-65 vjeç	65 vjeç lart
Gjithsej	159.182	49.501	98.579	11.102
Femra %	51	49	51	54

Tab.20 - Popullsia / femra sipas grupmoshave
(Burimi: INSTAT 2001)

Jetëgjatësia mesatare e popullsisë është 67 vjeç dhe për femrat është 69,7 vjeç. Sipas të dhënave të INSTAT, në qarkun e Lezhës jetojnë 23 femra mbi 100 vjeç, tregues ky shumë domethënës, që lidhet me kushtet e jetesës dhe aftësitë natyrore të rajonit.

Në popullsinë banuese, të grupuar sipas grupmoshave, vihet re se grupmosha 0 - 65 vjeç, ku futet mosha e riprodhimit dhe e punës ze 93% popullsisë, nga e cila 51% janë femra, ndërsa grupmosha 65 vjeç e lart ze 7%.

Dukuritë gjinore në qarkun Lezhë duhen parë kryesisht në këto aspekte:

1. në arsim
2. në punësim
3. në vendimmarrje
4. në dhunën e ushtruar ndaj femrave

Arsimimi i femrave

Lezha ka tradita të hershme në fushën e arsimit e të kulturës, që në vitin 1632, me hapjen e shkollës së parë nga misionarët françeskanë, e në vazhdim deri në ditët e sotme duke përfshirë këtu edhe arsimimin e femrave, që ka ardhur gjithnjë e në rritje. Një tregues i kulturës arsimdashëse është numri i lartë i femrave

	Qarku	fillore	8 vjeçare	Mesme
Gjithsej	33 244	13 404	13 960	5 880
Femra %	49,42	51	49,8	51,44

Tab.21 - Numri i nxënësve vitin 2003
(Burimi: Drejtoria Arsimore)

me arsim të mesëm, nga 20% e gjithë popullsisë 48,5% e tyre janë femra dhe 38% e atyre me arsim të lartë janë femra. (Shih Tab. 22)

Në arsimin 8 vjeçar, sipas të dhënave të vitit 2003, mësojnë 27364 nxënës, ku 50% e tyre janë femra, në arsimin e mesëm 51,44% janë femra, nga ku shihet se nuk ka dallime gjinore përsa i përket frekuentimit, ndërsa kalimi nga 8 vjeçarja në të mesme ka tregues më të ulët: nga 2978 nxënës që mbarojnë klasën e tetë, 1911 janë regjistruar në shkollën e mesme, ose 63,97%. Kjo dukuri është e lidhur me shumë shkaqe social-ekonomike në tërësi, ndërsa në disa zona rurale edhe për arsye të mentalitetit kufizues të arsimimit të femrave. (Shih Tab. 21)

Në këtë periudhë tranzicioni, me rritjen e varfërisë dhe të pasigurisë, arsimit po përjeton vështirësitë të shumta si braktisja e shkollës, analfabetizmi, prapambetja në mësim, etj.

Në popullsinë e qarkut Lezhë janë 2.365 analfabetë ose 1,2% në raport me gjithë popullsinë, ku femrat zënë 61,8% të tyre. Veçanërisht në moshat e reja 6-19 vjeç janë 852 analfabetë, që bëjnë 36% të analfabetëve, nga të cilët 47,8% janë femra, me % më të lartë në zonat rurale.

Fenomeni i braktisjes së shkollës shfaqet në shifrat 0,8%, ose 211 nxënës të shkollës 8 vjeçare, nga ku 45% janë femra, ndërkohë që prapambetja në mësim vihet re më shumë tek djemtë së tek vajzat. Rënia e frekuentimit në kalimin nga shkolla 8 vjeçare në të mesme, vjen si rezultat i:

- nivelit të ulët ekonomik
- mungesës së zbatimit të ligjit për arsimin e detyrueshëm
- pasigurisë për jetën e fëmijëve dhe veçanërisht të vajzave.
- mangësive në infrastrukturë (largësia e shkollës nga vendbanimi dhe kushtet jo të mira të shkollave në disa zona të thella, mungesa e bazës materiale, mësues të pakualifikuar, mësimi me dy turne) etj.
- emigrimi i të rinjve
- demoralizimi i të rinjve për arsimim
- martesat e hershme të vajzave
- shfaqja e mentalitetit kufizues ndaj shkollimit të vajzave etj. (Shih tab 22)

	Analfabetë	Dinë shkrim e këndim	Me arsim fillor	Me arsim 8 vjeçar	Me arsim të mesëm	Me arsim të lartë
Gjithsej %	1,2	16,5	18,5	40,3	20	3
Femra %	61,8	55	52	51	48,5	38

Tab.22 - Arsimimi i popullsisë banuese
(Burimi: INSTAT 2001)

	Analfabetë	Analfabetë në fshat	Analfabetë në qytet	Analfabetë 6-19 vjeç	Analfabetë 20-54 vjeç	Analfabetë mbi 55 vjeç
Gjithsej	2.365	1.849	516	852	294	1.219
% analfabetë	1,2	78,2	21,8	36	12,5	51,5
Femra gjithsej	1.462	1.159	303	408	144	910
% femra	61,8	62,6	58	47,8	48,9	74,7

Tab.23 - Përqindjet e Analfabetëve fshat/qytet dhe sipas grupmohave
(Burimi: INSTAT 2001)

Kontributi i femrave në arsim është shumë i dukshëm, ato përfaqësojnë 65% të numrit të gjithë mësuesve në qarkun e Lezhës. Në ciklin e ulët, 75% e mësuesve janë femra, si edukatore në kopshte janë 100% femra, në shkollat 8 vjeçare 58 %, në shkollat e mesme 51%. Ndonëse kemi një sektor të mbizotëruar nga femrat, që mbajnë peshën më të madhe të mësimdhënies, pozitat më të mirëpajuar dhe më me prestigj mbahen nga meshkujt.

Në shërbimin shëndetësor, femrat zenë një vend të rëndësishëm, veçanërisht në shërbimin infermiere – mami, ku nga 470 gjithsej, 90% e tyre janë femra, ndërsa 30% e numrit të mjekëve janë femra dhe më pak janë mjekë të specializuara. (Shih tab. 24)

	Qarku	Kurbini	Lezhë	Mirditë
Mjekë gjithsej	134	42	71	21
Femra	40	7	17	5
Infermiere gjithsej	470	123	256	91
Femra	434	113	228	83

Tab.24 - Shërbimi Shëndetësor
(Burimi: Drejtorisë së Shëndetit Publik 2004)

Punësimi i Femrave

Në tregun e punës, femrat përfaqësojnë 41,6% të forcës aktive të punës. Shkalla e papunësisë së qarkut është 28%. Ky tregues është më i lartë së mesatarja e vendit që është 15% dhe shkallën më të lartë të papunësisë e ka rrethi Kurbinit me 44%. Ndërsa femra të papuna ka më shumë rrethi i Lezhës, më pas Kurbini e Mirdita. Të papunë afatgjatë janë 14846, nga të cilët 45% janë femra. Treguesi i lartë i papunësisë së femrave, prej 46%, lidhet më

	15-24 vjeç	25-35 vjeç	mbi 35 vjeç
Gjithsej	4.209	4.224	7.152
Femra %	27	51	54

Tab.25 - Të papunë sipas grupmohave
(Burimi: Zyra e Punës 2004)

shumë me mundësitë e pakta për vende pune nga politikat që nuk kanë nxitur mundësinë e punësimit të femrave.

Në popullsinë banuese sipas grupmohave vemë re se femrat e moshës së re zenë % më të madhe të të papunëve. (Shih tab. 25) Si pasojë e reformave në ekonomi, ushtri etj. është rritur edhe numri i të papunëve me arsim të lartë, që shkon në 326, nga të cilët 30% janë femra dhe kryesisht në zonat rurale në profesionet agronomi, zooveterinari, ushtarake etj.

	Me arsim 8-vjeçar	Me arsim të mesëm	Me arsim profesional	Me arsim të lartë
Gjithsej	7.476	5.264	2.619	326
Femra %	49	53	28	30

Tab.26 - Të papunë sipas arsimit
(Burimi: INSTAT 2001)

	Qarku	15-19 vjeç	20-24 vjeç	25-34 vjeç	35 vjeç e lart
Gjithsej	9.844	539	1.272	2.966	5.067
Femra %	49,8	39,5	51,6	47	50,9

Tab.27 - Të papunë që përfitojnë ndihmë ekonomike sipas grupmohave
(Burimi: INSTAT 2001)

Të tjerë të regjistruar që përfitojnë pagesë papunësie janë 8721.


Pjesa dërrmuese e femrave janë punësuar në sektorët tradicionalë: bujqësi, shëndetësi, arsim, por, vitet e fundit, ato po bëjnë përpjekje për t'u integruar në kushtet e reja të ekonomisë së tregut, duke punuar edhe në transport, ndërtim, peshkim etj.

Vetpunësimi i femrave


Tradita e hershme e grave të Zadrimes për prodhimin e pëlhurave dhe veshjeve kombëtare me tezgjah dore (veke) filloi të aktivizohet përsëri pas viteve 1992 me ndihmën fillestare të Kishës katolike të Blinishtit

Numri i femrave në administratë

Burimi: Këshilli i Qarkut Lezhë, 2004



Femra në administratë 

 Numi i punonjësve në administratë

Aktualisht, në Blinisht të Zadrimës punojnë 10 gra e vajza më në nevojë, që janë ato të ngujuara e të veja. Ato drejtohen nga një stiliste dhe prodhojnë mbulesa tavolinë e peceta, perde, mbulesa krevati, çarçafë, çanta, veshje kombëtare, veshje për të reja etj. Prodhimet e tyre shumë cilësore kanë kompletuar 10 restorante të vendit tonë dhe janë ekspozuar në disa vende të Europës me ndihmën e shoqatave të ndryshme.

Vështirësitë e këtij aktiviteti janë: mungesa e vlerave financiare për blerjen e lëndës së parë (pambuku, lini, mëndafshi etj.) dhe vështirësitë për gjetjen e tregut të shitjes për mbajtjen dhe zgjerimin e aktivitetit, pasi këtu ekzistojnë mundësitë të punësohen të gjitha gratë e Zadrimës.

Femra në drejtim

Nga të dhënat e njësive vendore dhe qendrore, për vitin 2004, vihet re se femrat nuk përfaqësohen fare në pushtetin qendror dhe zenë një vend shumë të kufizuar (4.3%) në pushtetin vendor, kryesisht për arsye të mentalitetit patriarkal të shoqërisë, veçanërisht i meshkujve, dhe mungesës së një ligji për të caktuar kritere të zbatueshme për punësimin e femrave në drejtim.

Dhuna gjinore

Efektet fizike dhe psikologjike të dhunës përfshijnë çdo fushë të jetës dhe, ndër të tjera, transmetojnë modelin e dhunës tek fëmijët. Pavarësisht nga pasojat fizike dhe psikologjike që shoqërojnë dhunën e ushtruar në familje e në shoqëri, gratë dhe vajzat e kanë të vështirë ta denocojnë dhunën dhe të kërkojnë kujdes shëndetsor sepse qëndrimet sociale ndaj viktimave të dhunës i bëjnë ato përsëri fajtoresh, një pjesë e madhe e tyre ndjejnë rrezik të madh prandaj pranojnë dhunën si pjesë normale të jetës.

Gratë shpesh riviktimizohen nga punonjësit e shëndetësisë dhe të drejtësisë, dhe, për shkak të eksperiencave negative, humbin besueshmërinë tek ta, në vend që t'i ndihmojnë ato.

Mungesa e të dhënave të plota dhe analizave për dhunimin e femrave tregojnë mungesën e vëmendjes ndaj këtyre problemeve dhe nevojën për të grumbulluar informacion.

Fenomeni i dhunimit të femrave është ende shqetësues në qarkun e Lezhës. Nga disa të dhëna të Drejtorisë Rajonale të Policisë, për vitin 2001-2004, janë trafikuar nga meshkujt për arsye përfitimi dhe mashtrimi 148 femra, kryesisht nga zonat rurale.

Dhuna me agresivitetin maksimal të saj është shfaqur në vitin 2003-2004, ku janë vrarë, nga meshkujt në familje, 6 femra për arsye banale.

Shkaqet kryesore të këtyre fenomeneve janë:

- niveli i ulët social – ekonomik
- mungesa e ligjit për mbrojtjen e të drejtave të shtetasve dhe veçanërisht të femrave.
- mungesa e qendrave të rehabilitimit të femrave

Kapitulli IV Përmirësimi i shëndetit të nënës dhe fëmijës

Të dhëna të përgjithshme

Kujdesi për shëndetin publik është përgjegjësi e përbashkët e pushtetit qendror dhe e organeve të pushtetit vendor. Masat dhe mënyra e shpërndarjes së funksioneve është e përcaktuar me ligj. Shërbimi shëndetësor përbëhet nga shërbimi shëndetësor parësor, shërbimi spitalor, shërbimi farmaceutik dhe shërbimi stomatologjik. Shërbimi shëndetësor parësor përbën dhe pjesën më të rëndësishme të këtij sistemi. Misioni kryesor i tij është të sigurojë përmirësimin e vazhdueshëm të shëndetit dhe kushte më të mira shëndetësore për popullatën. Ai siguron kontaktin e parë me personat që kanë nevojë për shërbime shëndetësore. Prandaj dhe lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me përmbushjen e objektivave të përcaktuara në fushën e përkujdesjes për shëndetin e nënës dhe fëmijës, sidomos në zonat rurale, ku shërbimi spitalor është dhe më pak i pranishëm dhe madje në disa zona mungon fare.

Në qarkun e Lezhës, shërbimi shëndetësor parësor është organizuar në nivel drejtorie të kujdesit shëndetësor parësor në qendër qarku dhe drejtorie të shëndetit publik të rretheve. Ai sigurohet nëpërmjet qendrave shëndetësore dhe ambulancave. Sipas standardeve të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë, në zonën rurale, si rregull, duhet të ketë një qendër shëndetësore për çdo komunë dhe nga një ambulancë për çdo fshat, ndërsa në zonën urbane, numri i ambulancave përcaktohet në varësi të numrit të popullsisë. Sigurimi i aktivitetit dhe mirëmbajtja e tyre janë përgjegjësi e pushtetit vendor, si një funksion i deleguar nga pushteti qendror. Kualifikimi profesional, veprimtaritë parandaluese dhe edukuese, mbikqyrja e cilësisë së shërbimeve, shpërndarja dhe venddodhja e institucioneve etj., janë përgjegjësi e Ministrisë së Shëndetësisë, që ushtrohet nëpërmjet Drejtorive të Shëndetit Publik të rretheve. Gjatë viteve të fundit, pavarësisht nga vështirësitë ekonomike, Ministria e Shëndetësisë ka ndërmarrë një sërë nismash për përmirësimin e shërbimit shëndetësor dhe farmaceutik. Shumë prej projekteve të Ministrisë së Shëndetësisë janë realizuar me ndihmën dhe mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë si OBSH, UNICEF etj. Gjithashtu, dhe OJF të ndryshme kanë kontribuar në përmirësimin e shërbimit farmaceutik dhe rehabilitimin e qendrave shëndetësore në qarkun Lezhës, si në të gjithë Shqipërinë.

Për Qarkun e Lezhës përmendim rehabilitimin e plotë të Spitalit Rajonal në qytetin e Lezhës, me financimin e CARITAS-it zviceran. Nga ana tjetër, shërbimi farmaceutik privat ka njohur një zhvillim të rëndësishëm duke funksionuar më së miri.

Sistemi shëndetësor në qarkun e Lezhës administrohet në shkallë rrethi dhe menaxhohet nga Drejtoritë e Shëndetit publik në rrethe, por në rrethin e Lezhës, si qendër administrative e qarkut, ka një organizim me specifik, pasi Drejtoria e Kujdesit Shëndetësor Parësor dhe Shërbimi Spitalor kanë drejtori më vete, veprimtaria e të cilave koordinohet nga DSHP në rrethit.

Në qarkun e Lezhës, në fushën e shëndetit të nënës dhe fëmijës, përgjithësisht hasen të njëjtat mangësi e vështirësi që vihen re në shkallë vendi. Megjithatë, disa çështje të veçanta si mundësia për të pasur një shërbim shëndetësor parësor, sidomos në zonat rurale, përkujdesja për fëmijët e porsalindur dhe edukimi i nënave

Rrethi	1999	2000	2001	2002	2003	2004
Lezhë	3	3	1	3	1	2
Mirditë	5	3	4	2	3	2
Kurbin	10	4	5	3	5	1
Qarku Lezhë	18	10	10	8	9	5

Tab.28 - Vdekshmëria e fëmijëve nën 5 vjeç në Qarkun e Lezhës (Burimi: Drejtoria e Shëndetit Publik, Nëntor 2004)

kërkojnë një trajtim më të vëmendshëm, nëpërmjet ndërhyrjeve me përparësi në shkallë qarku, rrethi ose komune.

Shkalla e vdekshmërisë nën 5 vjeç

Në shkallën e vdekshmërisë nën 5 vjeç, ndikojnë një sërë faktorësh, siç janë niveli ekonomik social dhe kulturor i familjes në përgjithësi dhe i nënës në veçanti, infrastruktura shëndetësore, mungesa e pesonelit të kualifikuar mjekësor, që, në rrethet Mirditë dhe Kurbin, është një faktor problematik, etj. Mungesa e evidentimit të sëmundjes nga familja si fillim dhe më pas nga mjeku është fatale për fëmijën e sëmurë.

Vdekshmëria e fëmijëve nga 1-5 vjeç është relativisht e lartë, por që ka ardhur duke u ulur nga viti në vit; shifrën më të lartë e kemi në vitin 1999, me maksimumin në rrethin e Kurbin.

Vdekshmëria foshnjore

Vdekshmëria foshnjore në qarkun e Lezhës ka pësuar ulje – ngritje, por shkalla e saj pothuaj nuk ka ndryshuar nga viti në vit. Ndryshimet e vogla, që kanë ndodhur, mund të jenë pasojë e rastësisë ose mosraportimit të rasteve të vdekjeve, sidomos në

Rrethi	Lindjet					Vdekje e fëmijëve 0-1vjeç					Abortet				
	2000	2001	2002	2003	2004	2000	2001	2002	2003	2004	2000	2001	2002	2003	2004
Lezhë	955	1.181	890	953	673	22	20	14	14	11	339	477	359	211	174
Mirditë	787	684	452	503	461	6	8	7	9	5	146	159	113	64	67
Kurbin	1.194	1.176	1.036	996	572	17	10	14	6	3	347	481	412	242	169
Qarku	2.936	3.041	2.375	2.452	1.974	45	38	35	29	19	832	1.117	884	517	410

Tab.29 - Vdekshmëria e foshnjore në Qarkun e Lezhës (Burimi: Drejtoria e Shëndetit Publik, Nëntor 2004)

zonat rurale më të thella, ku më të spikatura janë në Mirditë dhe Kurbin. Në vlerat e këtyre shifrave ndikon dhe migrimi sidomos i çiftëve të reja nga zonat rurale.

Nga të dhënat, del që rreth 50 % e vdekjeve të periudhës 1999-2004 kanë ndodhur në banesë. Në vitin 2004 këto e kanë kaluar 55% të rasteve.

Numri i vdekjeve foshnjore, të ndodhura në muajin e parë të jetës për vitin 2004, është 35% dhe pothuaj të gjitha vdekjet në muajin e parë të jetës ndodhin në klinikë, ndërsa vdekjet në banesë janë kryesisht ato që ndodhin pas muajit të parë të jetës. Në shumë prej këtyre rasteve, vlerësohet se ndihma e mjekut kërkohet ose jepet me shumë vonesë, duke mos dhënë mundësi që ndihma nga ana e tij të jetë efikase. Sëmundjet perinatale, ato të frymëmarrjes dhe anomalitë kongenitale konsiderohen si shkaqet kryesore të vdekjeve. Të gjitha këto tendenca, që vihen re në qarkun e Lezhës, del se janë përgjithësisht të njëjta me ato në shkallë vendi.

Vdekshmëria e fëmijëve nga 0-1 vjeç në rrethet Kurbin dhe Mirditë është më e madhe në raport me vdekshmërinë foshnjore në rrethin e Lezhës. Kjo vjen nga mungesa e modernizimit të pajisjeve spitalore dhe e kualifikimit të personelit.

Rrethi	Infermiere dhe mami
Lezhë	140
Mirditë	82
Kurbin	96
Qarku Lezhë	318

Tab.30 - Numri i infermiereve/mamive në Qarkun e Lezhës (Burimi: Drejtorja e Shëndetit Publik, Nëntor 2004)

Analiza e shkaqeve të vdekshmërisë foshnjore në qarkun e Lezhës tregon se ato përfshijnë një spektër të gjerë arsyes, veçanërisht për zonën rurale, ku vdekshmëria foshnjore është më e madhe: që nga mundësia e kufizuar e popullsisë për të përfituar shërbim shëndetësor dhe deri tek niveli ekonomik, kushtet e jetesës e niveli kulturor i familjes në përgjithësi dhe i nënës në veçanti.

Duhet theksuar se megjithëse niveli i personelit të specializuar nuk është i njëjtë me standardet e BE-së, ai duhet vlerësuar sepse është shumë i vlefshëm për gratë shtatzëna.

Gjithashtu, duhet përmendur se shërbimet për shëndetin riprodhues për vajzat e pamartuara janë veçanërisht të pakta.

Përsa i përket abortit, mund të ketë dhe raste që nuk janë raportuar, raste të cilat kanë ndodhur jashtë qendrave shëndetësore dhe kjo ndikon si në nivelin dhe në regjistrimin e rasteve të vdekjeve të foshnjave dhe nënave.

Mungesa ose vështirësia e përdorimit të qendrave shëndetësore apo faktorë të tjerë socialë mund të çojnë në shtimin e rasteve të abortit në "fshehtësi" jashtë qendrave shëndetësore dhe nga

një personel i pakualifikuar. Kjo çon dhe në mosregjistrimin e rasteve të vdekjes së foshnjave, madje dhe në vdekjen e nënës gjatë abortit. Statistikat për përdorimin e kontraktivëve janë të padisponueshme. Ekziston mundësia që, në shumicën e rasteve, në zonat rurale të qarkut të Lezhës, të mos kenë informacion dhe mundësi të përdorin kontraktivë.

Vdekshmëria amëtare

Komplikimet, që kanë të bëjnë me shtatzaninë dhe lindjen e fëmijës, janë disa nga arsyet kryesore të vdekshmërisë për gratë e moshës riprodhuese, jo vetëm në qarkun e Lezhës apo në gjithë Shqipërinë, por në gjithë vendet në zhvillim. Në fakt, në qarkun e Lezhës vihet re vetëm një vdekje amnore në këto 5 vitet e fundit dhe kjo e ndodhur në vitin 2001 (shih tabelën 3). Në rrethin e Mirditës, kjo mesatare, relativisht e ulët në raport me lindjet, është një tregues i funksionimit të konsultoreve të nënës dhe fëmijës. Në qarkun e Lezhës ky lloj funksioni kryhet nga infermieret/mamitë. Megjithatë, mund të mos kemi një tregues të saktë përsa i përket vdekshmërisë amëtare, sepse mund të ketë dhe raste të paraportuara. Gjithsesi, për të arritur rezultate perfekte, pra për të arritur mesataren e vdekshmërisë së nënave 0% duhet që:

- të promovohet shëndeti i grave dhe mëmësia e sigurtë;
- të shmangen vdekjet dhe të ulet numri i sëmundshmërisë nga abortet e pasigurta;
- rekomandohen veprime që përmirësojnë shëndetin dhe gjendjen ushqimore të grave, veçanërisht të atyre shtatzëna ose me fëmijë në gji;
- të zgjerohen shërbimet shëndetësore për nënat në kontekstin e kujdesit shëndetësor parësor;
- të merren masa për të parandaluar, zbuluar dhe menaxhuar shtatzaninë dhe lindjet me rrezik të lartë, veçanërisht të adoleshenteve dhe grave që mbeten shtatzëna në moshë të madhe;
- të hartohen programe për të patur mbështetjen e burrave për shëndetin amëtar dhe mëmësinë e sigurtë;
- gratë, që kanë mbetur shtatzëna padashur, duhet të kenë akses të plotë në informacion dhe këshillim, këshillimi pas abortit, shërbimet e edukimit dhe planifikimi familjar duhet të ofrohen menjëherë gjë që sjell dhe parandalimin e përsëritjes së abortit;

Këto mund të arrihen duke trajnuar personelin shëndetësor të mesëm si dhe informimin e nënave nëpërmjet seminareve të hapura dhe fletëpalosjeve.

Imunizimi

Vaksinimi i detyrueshëm realizohet në moshat 0-15 vjeç dhe në gratë shtatzëna nga këshillimoret, mjeku i familjes, nga ambulancat dhe qendrat shëndetësore. Institucionet e mësipërme janë të

Rrethet	Lindje					Vdekshmëria amtare					Raporti/1000 lindje				
	2000	2001	2002	2003	2004	2000	2001	2002	2003	2004	2000	2001	2002	2003	2004
Lezhë	955	181	887	953	673	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Mirditë	787	684	452	503	461	0	1	0	0	0	0	1,5	0	0	0
Kurbin	1.194	1.176	1.036	996	572	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Qarku	2.936	3.041	2.375	2.452	1.974	0	1	0	0	0	0	0,4	0	0	0

Tab.31 - Raporti i vdekshmërisë së nënave në Qarkun e Lezhës (Burimi: Drejtorja e Shëndetit Publik, Nëntor 2004)

detyruara të sigurojnë evidentimin e saktë të kontigjentëve që i nështrohen vaksinimit, planin e vaksinimit dhe sasitë e nevojshme të vaksinave të ruajtura në kushtet e “zinxhirit të ftohtë”. Pas vaksinimit, bëhet pajisja me librezën e vaksinimit po nga këto institucione dhe plotësohet sa herë që aplikohen vaksinat.

Masat parandaluese për sëmundjet, sidomos vaksinimi në qarkun e Lezhës me gjithë përqindjen e lartë të mbulimit, ka ndryshim në varësi të zonës dhe vaksinës. Në zonat e thella rurale sidomos të rretheve Mirditë dhe Kurbin mungon vaksinimi i plotë.

Rrethet	DDP	Fruthi dhe Rubeola
Lezhë	99%	99%
Mirditë	>95%	>90%
Kurbin	95%	90%

Tab.32 - Imunizimi në Qarkun e Lezhës (Burimi: Drejtorja e Shëndetit Publik, Nëntor 2004)

Përqindja e lindjeve të asistuar nga personeli i kualifikuar

Rrethi i Lezhës dhe i Mirditës, në vazhdimësi nga 1999-2004, kanë përqindjen më të lartë të lindjeve në institucion dhe kjo përqindje ka ardhur duke rritur nga viti në vit, ndërsa në Kurbin vemë re një rritje pothuaj të menjëhershme të këtij numri nga 2003-2004 (9 mujorin e parë të vitit 2004), ndërkohë që në 1999 ishte vetëm 84,3%.

Duhet theksuar se edhe lindjet jashtë institucionit, pothuaj në të gjatha rastet, janë asistuar nga infermiere dhe mami.

Rastet e lindjeve jashtë institucionit janë më të shumta në zonat e thella sidomos të rrethit të Mirditës dhe të Kurbin, por edhe të Lezhës, të cilët për efekt të largësisë së madhe dhe kohës së kufizuar nuk arrijnë dot në maternitet, këtu ndikon dhe gjendja ekonomike dhe sociale e kulturore e familjes në përgjithësi dhe e gruas në veçanti.

Përqindja e lindjeve në institucion në rrethin e Lezhës është e kënaqshme, tek kjo ka ndikuar ndjeshëm funksionimi i konsultoreve të grave. Nëse dhe infrastruktura rrugore të ishte më e mirë, sigurisht që kjo përqindje do të ishte dhe më e madhe. Qendrat shëndetësore duhet të kenë dhe një shtëpi lindje dhe një mjek roje, në mënyrë që ato të funksionojnë në çdo kohë.

Në gjithë qarkun e Lezhës, kemi gjithsej 3 maternitete dhe këto kanë një kapacitet prej 100 shtretërisht gjithsej, pra një numër mjaft i vogël për të përballuar ngarkesën, duke patur parasysh numrin e lindjeve dhe intensitetin e tyre. Gjendja më e vështirë paraqitet në Kurbin, ku kemi një numër të madh lindjesh dhe kapaciteti i maternitetit është vetëm 25 shtretër, pajisjet spitalore janë të amortizuara, cilësia e shërbimit jo në standartet e duhura, prandaj kemi dhe një numër të madh të rasteve të nënave që shkojnë për të lindur në maternitetin e rrethit të Lezhës, i cili ka

dhe një personel më të kualifikuar dhe pajisje më moderne.

Shërbimi dentar

Në institucionet shëndetësore stomatologjike përfshihen: Institucionet stomatologjike publike dhe institucione stomatologjike private. Ky shërbim kontrollohet nga Inspektoriat Sanitar specialistët e Drejtorisë së Shëndetit Publik dhe përfaqësuesit e Shoqatës së Stomatologëve.

Në qarkun e Lezhës ekzistojnë një sërë klinikash dentare, private dhe shtetërore, gjithsesi numri i dentistëve në raport me popullsinë është shumë i vogël kemi 0.2 dentistë/ 1000 banorë, ndërkohë që standartet e BE-së janë 0.61 dentistë / 1000 banorë. Duhet theksuar se në disa zona rurale, sidomos në rrethet Mirditë dhe Kurbin, nuk plotësohen dhe nevojat më minimale të këtij shërbimi.

Rrethet	Popullsia	Dentist	Dentist/1000 banorë
Lezhë	93.172	18	0,2
Mirditë	44.701	6	0,13
Kurbin	72.543	6	0,08
Qarku Lezhë	210.416	30	0,2

Tab.34 - Raporti dentist /1000 banorë (Burimi: Drejtorja e Shëndetit Publik, Nëntor 2004)

Në Mirditë kemi gjithsej 6 dentistë (nga këto vetëm 2 janë me arsim të lartë) në gjithë rrethin; 5 nga këto kanë klinikat e tyre në qytetin e Rrëshenit dhe 1 dentist në qytetin e Rubikut, ndërsa zonat rurale janë komplet pa këtë shërbim. Banorëve të zonave rurale u duhet të bëjnë me kilometra rrugë për të vajtur tek dentisti.

Të njëjtin problem ka dhe në rrethin e Kurbin dhe të Lezhës megjithëse tek kjo e fundit është pak më i zbutur si fenomen pasi numri i dentistëve për banorë është më i lartë, por përsëri edhe këtu, zonat e largëta rurale janë të pambuluara nga ky shërbim shëndetësor.

Lindshmëria

















Sikurse tregohet në tabelën nr.35, shkalla për frymë e lindshmërisë në qarkun e Lezhës është në vendin e 5 më e larta në të gjithë vendin, por kjo mund të mos jetë krejt saktë sepse këtu ndikon dhe lëvizja demografike e popullsisë, emigrimi, sidomos i çifteve të reja, dhe mosregjistrimi në kohë i lindjeve. Këto të dhëna, që janë paraqitur në tabelë, janë marrë nga INSTAT 2001.

Megjithatë me kalimin e viteve kanë ndryshuar dhe të dhënat për popullsinë dhe lindshmërinë në qarkun e Lezhës. Nga të dhënat e marra nga zyrat e gjendjes civile për popullsinë (dhjetor 2003)

	Lindje gjithsej						Të lindur në institucion					
	1999	2000	2001	2002	2003	2004	1999	2000	2001	2002	2003	2004
Lezhë	1.183	955	1.181	890	953	673	99,23	98,3	96,7	94,1	99,5	99,6
Mirditë	782	787	684	452	503	461	95,14	98,8	99,5	98,8	99,4	99,5
Kurbin	1.179	1.194	1.176	1.036	996	572	84,3	89,6	84,4	89,1	99,8	100

Tab.33 - Përqindja e fëmijëve të lindur në institucion (Burimi: Drejtorja e Shëndetit Publik, Nëntor 2004)

Pasqyra e lindjeve, aborteve dhe vdekjeve në Qarkun Lezhë
Burimi: Drejtoria e Shëndetit Publik, Nëntor 2004



dhe nga zyrat e Statistikës në Drejtorinë e Shëndetit Publik për lindshmërinë (nëntor 2004) kemi këtë raport lindshmërie:

Popullsia - 210.416; Lindshmëria - 2,452; Lindshmëria/1000 banorë - 11,65.

Pra, rezulton që kemi një ulje të ndjeshme të lindshmërisë për qarkun e Lezhës nga viti 2001 në 2004. Popullsia është rritur nga 159,182 në 210,416 banorë, ndërsa numri i lindjeve është ulur nga 3,159 në 2,452 lindje. Kështu që, për vitin 2004, kemi 11.65 lindje/1000 banorë.

Qarqet	Popullsia	Lindshmëria	Lindshmëria/1000 banorë
Gjirokastrë	112.831	2.185	19,36
Lezhë	159.182	3.159	19,84
Kukës	111.393	3.501	31,43
Berat	193.020	3.520	18,23
Vlorë	192.982	3.537	18,33
Korcë	265.182	4.328	16,32
Durrës	245.179	4.441	18,11
Dibër	189.854	4.509	53,75
Shkodër	256.473	5.621	21,92
Fier	382.544	6.175	16,14
Elbasan	362.736	7.939	21,89
Tiranë	597.899	10.392	17,38
Shqipëria	3.120.509	58.600	18,77

Tab.35 - Lindshmëria sipas qarqeve në Republikën e Shqipërisë (Burimi: INSTAT 2001)

Objekte shëndetësore

Totali i përgjithshëm i popullatës për DRSKSH Lezhë është 210416, ndërsa numri i mjekëve të përgjithshëm është 68 pra, ngarkesa mesatare për mjek është rreth 3094.3 banorë, nga ku del që raporti mjek pacient në qark është 0.32 mjekë/1000 banorë. Kjo shifër është më e ulët se standardet europiane prej 1.3 mjekë/1000 banorë.

Në disa fshatra të qarkut të Lezhës mungojnë ambulancat, kryesisht në rrethet Mirditë dhe Kurbin, dhe në këto raste shërbimi shëndetësor kryhet në shtëpi. Në këto fshatra mungon prania e mjekëve me arsim të lartë, aty shërbejnë infermierë me kurse 9 mujore të organizuara në qark (këto shërbejnë dhe si konsultore)

Në vitet e fundit ka patur lëvizje masive të popullatës në drejtim të Lezhës, që ka shkaktuar probleme për mbulimin me shërbim shëndetësor të banorëve, sidomos në zonat rurale. Për pasojë, mbulimi me ambulanca nuk është në standartet e duhura sepse në disa zona të rrethit të Lezhës është shtuar shumë numri i popullatës (nga migrimet) dhe numri i ambulancave apo i qendrave shëndetësore nuk është në normën e duhur.

Është interesante të vëresh që një pjesë e komunave me tregues të ulët të Indeksit të Zhvillimit Njerëzor (HDI) duhet të bëjnë një rrugë shumë të gjatë për të arritur në qendra shëndetësore.

Lëvizja e mjekëve për në rajone me një numër më të madh pacientësh dhe me një infrastrukturë më të mirë ka shkaktuar probleme sidomos për rrethet e Mirditës dhe Kurbin. Shumë specialitete nuk mbulohen sepse ka mungesa në mjekët specialistë. Në këto raste, vizitat kryhen vetëm 1 ose 2 ditë në javë me mjekë të ardhur nga rrethe të tjera si Tirana, Kruja etj.

Për të shmangur lëvizjen e mjekëve për në zona shumë të


populluara, siç është Lezha në këtë rast, duhet të bëhet stimulimi i tyre si nga ana financiare ashtu dhe nga ana e kualifikimit profesional.

Rrethi	Spitale	Nr. i shtretëve	Ambulanca	Maternitete	Nr. i shtretëve	Konsultore fem/nëna	Qendra shëndetësore	Nr. Farnacive
Lezhë	1	162	47	1	50	61	21	5
Mirditë	1	100	21	1	25	53	29	8
Kurbin	1	65	19	1	25	25	11	10
Qarku	3	327	87	3	100	139	61	23

Tab.36 - Shpërndarja e objekteve shëndetësore sipas rretheve të Qarkut Lezhë (Burimi: Drejtoria e Shëndetit Publik 2004)

Kapitulli V
Garantimi i qëndrueshmërisë së mjedisit

Qarku i Lezhës shtrihet në një teritor prej 1619.1 km² (161 910 ha). Pjesën më të madhe të sipërfaqes e zënë pyjet në 58% ose 93134 ha, ndërsa toka bujqësore zë 22% ose 35152 ha.



Pyjet

Pyjet përbëjnë një element mjedisor me vlera. Mirdita paraqitet më e pasur 74 % të sipërfaqes, ndërsa rrethi Lezhë ka më pak se 39%. Toka bujqësore zë një sipërfaqe dy herë më të vogël se ajo pyjore dhe si rreth Lezha zotëron sipërfaqen më të madhe me tokë bujqësore (39 %) ndërsa rrethi Mirditë rreth 5 herë më pak (7%).

Fondi pyjor qeveriset mbi bazën e planeve të mbarështimit e inventarizimit, por që janë jashtë afateve kohore të përdorimit. Kjo situatë vështirëson zotërimin dhe vlerësimin e burimeve pyjore, kullimore, të faunës, bimëve mjekësore dhe eterovajore, të prodhimeve të dyta pyjore e jopyjore etj. Në kuadrin e Projektit të Pyjeve, financuar nga Banka Botërore, ka përfunduar mbarështimi i disa ekonomive pyjore, gjë që pasqyrohet edhe në të dhënat e kadastrës pyjore, por që janë shumë pak krahasuar me nevojat mjaft të mëdha. Gjithashtu, është në proces inventarizimi i fondit pyjor, me fondet e Projektit të Pyjeve, gjë që do të ndihmonte maksimalisht për të patur një fond real, për planifikimin e masave që duhen marrë në drejtim të një administrimi e menaxhimi të qëndrueshëm, afatgjatë dhe shumëfunksional të pyjeve.

Rrethet	Sipërfaqe pyjore		Sipërfaqe tokë bujqësore	
	Ha	%	Ha	%
Lezhë	18.234	38	18.467	39
Kurbin	10.710	39	10.367	38
Mirditë	86.700	74	6.318	7
Qarku	93.134	58	35.152	22

Tab.37 - Sipërfaqet pyjore e të tokës bujqësore të Qarkut Lezhë (Burimi: ARM Lezhë, 2004)

Rrethet	Sipërfaqja pyjore ha/për banor
Lezha	0,19
Kurbini	0,14
Mirdita	1,45
Qarku	0,44

Tab.38 - Sipërfaqja pyjore për banorë (Burimi: ARM Lezhë, 2004)

Janë kaluar në pronësi të komunave në shkallë qarku, me ndihmën e Projektit të Bankës Botërore, 20990 ha pyje dhe 2284 ha kullota e livadhe. Ky kalim ka përmirësuar, në një farë mënyre, menaxhimin e tyre në disa komuna, por përsëri vërehet mungesa e angazhimit dhe e kapaciteteve të organeve të pushtetit vendor në këtë drejtim.

Nga problematika, që ka të bëjë me administrimin e fondit pyjor, vëmë në dukje: i) Dëmtime e prerje të pyjeve kryesisht për materiale drusore. Tregtimi i paligjshëm i materialit drusor dhe i prodhimeve të tjera jodruse. Shkalla e dëmtimeve në fondin pyjor në qarkun e Lezhës mbetet shqetësuese; ii) Zënia me dhe pa leje e këtij fondi nga hapja e gurëve pa një strategji apo planifikim të përshtatshëm; iii) Zvogëlimi i sipërfaqes pyjore, sidomos pas viteve '90. Kjo vërehet nga krahasimi me inventarin e pyjeve të kryer në vitet 84-85. Kjo ka ardhur, në radhë të parë, nga prerja pa kriter e tyre për dru zjarri apo lëndë ndërtimi. Së dyti, nga mosmbjellja e pyjeve të reja. Kjo e fundit ka ardhur nga mungesa e fidanishteve pyjore. Edhe në ato pak raste ku janë krijuar, ato janë private dhe prodhojnë më tepër fidana me bimë dekorative dhe jo për pyllëzime masive. Janë krijuar tre fidanishte të tilla me një sipërfaqe gjithsej 1.5 ha, që është mjaft minimale për të plotësuar nevojat për fidanë pyjore; iv) Erozioni mbetet aktiv në një sipërfaqe të konsiderueshme pyjore (vetëm në shtator të vitit 2002 janë vënë nën procesin e erozionit rreth 5600 ha pyje); v) Varfërimi i biodiversitetit është i konsiderueshëm, veçanërisht në zonat e mbrojtura dhe ato të zonës bregdetare në përgjithësi. Masat e marra, për ruajtjen e llojeve të rralla dhe të kërcënuara të faunës e florës, nuk kanë qenë rezultative, pasi ky problem ende mbetet jo i vlerësuar dhe lidhet shumë me nivelin e ndërgjegjësimit të publikut. Vërehen mungesa të kapaciteteve në zbatimin e ligjit nga administruesit, ndërkohë që dhe shqetësimi i organeve shtetërore dhe i pushtetit vendor ka qenë i pakët ose janë mjaftuar me evidentime problemesh dhe jo me masa konkrete. OJF-të nuk kanë rol aktiv në këto çështje.

Sipërfaqet e gjelbra në zonat urbane

Veçanërisht pas vitit 1990, vërehet zvogëlimi i sipërfaqes së gjelbër në zonat urbane, si rezultat i ndërtimeve pa kriter dhe merkatizimit të rrugëve.

Në territorin e bashkive banojnë 98868 banorë, me një sipërfaqe të gjelbër prej 17.1 ha ose 0.17 m²/frëmë.

Bashkitë	Sipërfaqja e gjelbër m ² /banorë
Lezha	4,23
Laçi	1,65
Mamurrasi	0,32
Rrësheni	0,94
Gjithsej Qarku	0,17

Tab.39 - Sipërfaqja e gjelbërt m²/banore sipas bashkive (Burimi: ARM Lezhë, 2004)

Toka bujqësore

Qarku i Lezhës është një rajon, ekonomia e të cilit dominohet nga prodhimi bujqësor. Duket se kjo do të vazhdojë kështu edhe për një kohë mjaft të gjatë.

Ky drejtim i ekonomisë kërkon një adresim të kujdesshëm dhe me planifikime të qëndrueshme e afatgjata të problemeve që lidhen me tokën. Njohja, nxjerrja në pah dhe synimi i zgjidhjes së problemeve që lidhen me tokën përbëjnë një rëndësi të dorës së parë.

Bashkitë	Sipërfaqja e tokës bujqësore ha/ për banorë
Lezha	0,23
Kurbini	0,13
Mirdita	0,09
Gjithsej Qarku	0,17

Tab.40 - Sipërfaqja e tokës bujqësore për banorë (Burimi: ARM Lezhë, 2004)

Erozioni dhe vlerësimi i humbjeve të tokës për shkak të tij

Degradimi i tokës bujqësore nga gërryerjet dhe përmbytjet mbetet problemi më serioz. Vetëm në shtator 2002 janë vënë nën procesin e erozionit nga përmbytjet, duke dëmtuar shtresën aktive, mbi 10500 ha tokë bujqësore.

Nga llogaritjet e bëra në tokat e larta rezultojnë se 3 ton/ha/vit në 0.2 mm thellësi është lëvizja e dherave në tokat e menaxhuara mirë dhe 300 ton/ha/vit me 2 cm thellësi është lëvizja e dherave në tokat e menaxhuara keq.

Ritmi mesatar i erodimit në shkallë vendi është 30 ton/ha/vit për tokat e menaxhuara keq.

Nga një vështrim krahasues i të dhënave për vitin 2002, për humbjet vjetore të tokës si rezultat i erozionit ujor, sasia e tokës së gërryer përllëgaritet rreth 20.2 ton/ha/vit.

Duke vlerësuar mbulesën bimësi si faktor zbutës të erozionit, rezultojnë se ai mbetet faktori kryesor i cili mund të "drejtohet" më lehtë dhe, siç shihet, tokat e mbjella me bar shumëvjeçar janë "më të mbrojtura" e japin më pak humbje nga gërryerjet se sa tokat e tjera të mbjella. Siç vërehet mbulesa vegetative dhe lloji i saj janë të rëndësishëm në procesin e erodimit dhe duhet të njihen nga fermerët.

Reshjet janë gjithashtu një faktor i rëndësishëm, që me sasinë e tyre të variueshme gjatë vitit dhe në zona të ndryshme, çojnë në vlera të ndryshme të gërryerjes dhe erozionit të tokës si dhe përmbytjen e zonës fushore sidomos asaj të Lezhës e Kurbinit duke u kthyer në një problem serioz dhe me pasoja për mjedisin dhe për komunitetin e këtij rajoni. Në këto zona, gjatë këtyre 3 viteve (2001-2004), ka patur përmbytje të mbi 3000 ha tokë bujqësore si dhe dëmtimin e mjaft pritave malore, ura e akse të rrugëve kombëtare dhe rurale, që kanë ndikuar ndjeshëm në dëmtimin e kulturave bujqësore e jobujqësore.

Shqetësues është krijimi i konceptit tek fermerët se është e kotë të mbillet me kultura bujqësore e drufutrore, pasi çdo gjë përmbytet dhe për pasojë shkatërrohet.

Për përmirësimin e situatës,

- Është e nevojshme të zbatohen projekte konkrete për mbrojtjen e brigjeve të lumenjve Drin e Mat si dhe thellimin e tyre;
- Zvogëlimin e rrjedhjeve sipërfaqësore nëpërmjet reduktimit të pjerrësisë së tokave me ndërtimin e veprave antierozive, prita malore, pyllëzime, mbjellje të kulturave bujqësore e livadheve të kultivuara, kanale të pritjes së ujërave të larta etj.

- Përmirësimi i sistemit kullues duke riaftësuar atë ekzistues si dhe ndërtimin e rrjeteve të reja ku është e nevojshme.

Probleme me përdorimin e tokës

Nga të dhënat statistikore shumëvjeçare të Zyrës së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, shihet se, për një periudhë mbi 10 vjeçare, fondi i tokës bujqësore është i stabilizuar dhe thuhet se i pandryshuar. Ka pasur një rritje graduale të fondit të tokës bujqësore për një periudhë prej rreth katër dekada - deri në fund të viteve '80, pas kësaj periudhe e deri më sot, mbi këtë sipërfaqe të konsoliduar si tokë bujqësore u shfaqën e vijojnë të japin ndikime një sërë dukurish të karakterit social dhe ekonomik.

Mbipopullimi i zonës fushore dhe ndikimet mbi tokën

Nga fillimi i viteve '90 e në vazhdim, proceset demokratike sollën dhe lëvizjen e lirë të individëve duke populluar shumë shpejt zonat fushore e sidomos ato të Lezhës. Rritja e numrit të popullatës në këtë zonë, në fund të vitit 2004, ishte rreth 1.5 herë, krahasuar me vitet 90. Ndodhi, në këtë mënyrë, zënia masive e tokave bujqësore, duke i denaturuar e kthyer në zona ndërtimore, kryesisht për banim. Në këtë mënyrë u zunë rreth 555 ha tokë bujqësore, shifër kjo me tendencë në rritje. Ndikimet mjedisore janë komplekse për pasojë të një urbanizimi konfuz në dëm të tokës bujqësore e pa asnjë studim, cka do të ketë një kosto të madhe për investitorët në të ardhmen.

Braktisja e tokave bujqësore

1300 ha po braktisen e nuk po kultivohet, në to, bimësi si pasojë e një sërë faktorëve gjeo-klimatikë, si pjerrësia e pafavorshme për kultivim, pjelloria e kufizuar, karakteristikat gjeomorfologjike të tokës, e kushtëzuar kjo nga lëvizja e lirë e njerëzve.

Lënia djerrë e tokës në zonën fushore dhe braktisja e tokës kodrinore-malore po bëhet një dukuri konstante, që ka përfshirë një sipërfaqe prej 11741 ha. Për pasojë kapacitetet prodhuese në nivel qarku po reduktohen.

111346 banorët, përfitues të 30938 ha tokë (ose 0.28 ha /frymë), shfrytëzojnë vetëm 17897 ha ose 58% të saj. Efektiviteti i ulët i menaxhimit dhe përdorimit të tokave mbetet një problem serioz.

Pjelloria e kufizuar

Rreth 15% e fondit të tokës bujqësore rezultojnë me tregues pjellorie të ulët për një kompleks faktorësh si për shkak të elementeve përbërës të trashëguar të këtyre tokave. Ndërhyrjet përmirësuese në këto toka janë të nevojshme dhe të domosdoshme për të siguruar rendimente të kënaqshme nga kultivimi i kulturave bujqësore.

Humbjet e tokës bujqësore nga keqadministrimi i shtretërve të lumenjve

Shfrytëzimi i karierave lumore, u kthye, për një periudhë 10 vjeçare pas viteve '90, në një faktor me ndikim në degradimin, deri humbjen fizike në disa zona, të dhjetra hektareve tokë bujqësore. Ky shfrytëzim i vazhdueshëm është gjithashtu, një ndër arsyet që zona të ndryshme, sidomos zona e Bregut Matit, Fushëkuqes e Zadrimes, janë sot objekt i daljeve masive të ujërave nga shtretërit e lumenjve dhe përmbytjeve të tokave bujqësore.

Ujërat nëntokësore

Furnizimi i popullsisë me ujë të pijshëm në qarkun e Lezhës, bëhet kryesisht nga ujërat nëntokësore si dhe gurra e burime.

Ujërat nëntokësore shtrihen në pellgje në thellësi të ndryshme nga sipërfaqja dhe shfrytëzohen me shpime hidrogeologjike. Shfrytëzimi i pandërprerë e në rritje i ujërave nëntokësore, shpesh, krijon cekuilibra hidrodinamike e hidrokimike, si dhe stimulon ndotjen e ujit nga faktorë sipërfaqësorë të veprimtarisë njerëzore. Ujërat nëntokësore janë të bollshme në qarkun tonë dhe të shpërndara në pellgun e Lezhës dhe të Fushë Kuqes. Ato janë të një cilësie të mirë, por në disa rajone ato njihen pak. Problemet kryesore që kanë dalë vitet e fundit janë ato të rrezikut të depërtimit të ujërave të kripur sidomos si rezultat i mbishfrytëzimit. Rreth 20 % e ujërave nëntokësore përdoren për vaditje në bujqësi. Monitorimi i ndotjes së ujërave nëntokësore ka siguruar vijueshmërinë nga viti 2000, 2001 dhe 2002 në pellgjet më kryesore dhe zgjerimin e tij në pellgje të reja.

Në qarkun Lezhë, ujërat nëntokësorë shfrytëzohen kryesisht për furnizimin e popullatës dhe shumë pak për industrinë ushqimore. Karakteristike për ujërat tona nëntokësore është se:

- Rezervat kryesore të ujit të pijshëm janë të përqendruara në depozitimet e shkrifta kuaternare, lehtësisht të ndotëshme;
- Ato shfrytëzohen me një shpeshësi të madhe, ç'ka favorizon ndryshimet e shpejta të përbërjes kimike të ujit;
- Ushqimi bazë i tyre janë lumenjtë, ku shkarkohen shpesh mbetjet e veprimtarisë njerëzore.

Ruajtja dhe monitorimi i cilësisë së ujërave nëntokësorë përbën një domosdoshmëri për të siguruar furnizimin e popullatës me ujë që t'iu përgjigjet kërkesave si nga pikëpamja sasiore ashtu dhe cilësore.

Pellgu i Lezhës

Ky pellg përfshin zonën Shëngjin-Zadrimë-Bregu i Matit dhe furnizon me ujë të pijshëm qytetin e Lezhës dhe Shëngjinit, si edhe të gjithë fshatrat e fushës. Sasia e ujit të shfrytëzuar prej tij, përfshi edhe ujin teknologjik është 400 l/sek. Ujësjellësit kryesorë janë ai i Barbullojës dhe i Rrillës. Zona e ushqimit është kryesisht bregu i lumit Mat në jug. Rezervat ujore të llogaritura janë rreth 2000 l/sek. Pellgu përfshihet në depozitimet ujëmbledhëse zhavorrore me trashësi që rritet në drejtim të lumit Mat deri në 180-200 m. Ato janë të mbuluara me një mbulesë argjilore dhe subargjilore me trashësi 45-50 m. Zona e ushqimit është kryesisht bregu i lumit Mat në jug.

Rreziku i ndotjes sipërfaqësore është i ulët falë mbulesës së trashë ekranizuese, largësisë së zonës së ushqimit dhe karakterit artesian të shtresave ujëmbajtëse. Vetëm shpeshimi i shfrytëzimit mund të nxisë depërtimin e ujërave me mineralizim të lartë nga krahu verior e perëndimor i pellgut ujëmbajtës.

Nga rezultatet e monitorimit duket se ujërat nëntokësore të këtij pellgu janë dy llojesh: ujëra me fortësi të vogël e mineralizim të ulët dhe ujëra me mineralizim të lartë. Lloji i parë takohet në Barbullojë. Vihet re një niveoicakuar i NO₂ në Barbullojë dhe Hotelin e Gjetisë. Nga analizat, vërehet se ka rritje graduale të mineralizimit të përgjithshëm të Na (Natriumit) dhe Cl (Klorit). Analizat e kryera për mikroelemente rezultojnë pa përmbajtje të tyre. Më poshtë po japim rezultatet e monitorimit të ujërave nëntokësore për vitin 2001.

Si përfundim të këtyre analizave rezulton:

Ujërat nëntokësore të pellgut të Lezhës kanë veti fiziko-kimike të mira. Shfaqja e përmbajtjes së NO₂ lidhet me kushtet higjeno-

sanitare rreth stacioneve të pompimit.

Rritja e shfrytëzimit mund të nxisë depërtimin e ujërave me mineralizim të lartë nga krahu verior e perëndimor i pellgut ujëmbajtës drejt ujërave të freskëta.

Pellgu i Fushë-Kuqes (Laçit)

Kufiri verior i këtij pellgu është lumi Mat ndërsa ai jugor është lumi i Drojës. Në perëndim kufizohet me vijën bregdetare të Adriatikut, deri në derdhjen e lumit Mat, ndërsa në lindje me vargun e kodrave të Mamurrasit deri në Milot. Pellgu i Fushë-Kuqes përfaqësohet nga kompleksi ujëmbajtës, depozitimet aluviale të ndërtuar nga disa shtresa horizontale ujëmbajtëse me trashësi 30-40m. Mbulesa subargjilore dhe vende-vende subranore dhe ranore, fillon nga niveli 0m në lindje, në fushën e Milotit dhe arrin deri në 30m në drejtim të perëndimit, ndërkohë që në zonën e derdhjes së lumit Mat, dyshemeja e zhavorreve mendohet të zhytet deri në thellësinë 200m. Në pellg janë ndërtuar disa ujësjellësa për furnizimin me ujë të qyteteve të Durrësit, Kavajës, Milotit, Laçit dhe disa fshatrat të zonës Prezë-Durrës. Sasia e ujit që shfrytëzohet është 1250 l/sek për furnizimin e qyteteve të Durrësit, Lacist, Milotit, Mamurrasit dhe rreth 15 fshatrat të zonës deri në Durrës. Ky pellg është pellgu ujëmbajtës me shfrytëzim më të lartë në Shqipëri.

Nga krahasimi i rezultateve të analizave të mostrave të ujit të marra në vitet 1999 – 2000 dhe 2001-2002, shihet se nuk ka ndryshime të dukshme në përbërjen kimike të ujërave nëntokësore. Nga ana tjetër, krahasimi me të dhënat e analizave më të hershme për pellgun e Fushë-Kuqes tregon se shfrytëzimi i vazhdueshëm i tij, në zonën Laç-Fushë Kuqe, ka sjellë një rritje të vogël të përmbajtjes së klorureve.

Rreziku i ndotjes nga sipërfaqja është mesatar.

Ajo mund të vijë nga zona e ushqimit në veri të pellgut ujëmbajtës (shtrati i lumit Mat), i cili deri tani nuk është i ndotur, por që mund të priten futje të metaleve të rënda me prejardhje minerare. Ky rrezik shtohet më tepër për shkak të shfrytëzimit të vazhdueshëm të shtresës së këtij lumi për marrje zhavorri.

Burim serioz ndotjeje sipërfaqësore mbeten mbetjet e ish Uzinës së Plehërave Kimike në Lac. Rreziku më i madh, për shkak të shfrytëzimit të vazhdueshëm, mbetet ai i rritjes së mineralizimit të përgjithshëm (kryesisht për rritje të Na e Cl), që vjen nga zhvillimi i hinkës së depresionit në drejtimin JugPerëndimor, ku mbizotëron ky tip uji me mineralizim të lartë.

Në këtë pellg, takojmë dy lloj tipe të ujërave nëntokësore. Vihet re që kemi ndotje përkatësisht në Gurëz dhe Adriatik kryesisht me NO₂, NH₄, që lidhet me mosrespektimin e zonave të rreptësisë. Rekomandohet që monitorimi të vazhdojë pasi ky është dhe pellgu me rezerva më të mëdha ujërash nëntokësore dhe shkallë shfrytëzimi të vazhdueshme.


Furnizimi i një pjesë të konsiderueshme të popullatës së Qarkut me ujë të pijshëm bëhet nga gurra dhe burime. Kjo kryesisht në rrethin e Mirditës, përveç qytetit Rrëshen, dhe në zonën verilindore të Lezhës e Kurbinit.

Në rrethin e Lezhës furnizohen me burime dy komuna, përkatësisht Kallmet e Kolsh, në rrethin e Mirditës komuna Selitë dhe rrethin e Kurbinit, me gurra, zona e Gjormit dhe Vilez.

Furnizimi me ujë nuk bëhet për gjithë periudhën 24 orëshe, kjo varion nga 4-10 orë në 24 orë. Një tregues të mirë (por të plotë për nevojat) të furnizimit me ujë të pijshëm ka qyteti i Lezhës ku koha e furnizimit me ujë varion nga 12-24 orë në 24 orë.

Cilësia e ujit të pijshëm

Burimi: Ministria e Shëndetësisë 2003



Biodiversiteti

Biodiversiteti dhe politika për mbrojtjen e tij.

Biodiversiteti është një nga trashëgimitë më të çmuara të qarkut të Lezhës. Sfidat me të cilat ndeshet qarku i Lezhës kanë të bëjnë me: humbje dhe copëtim habitatit, dëmtim, varfërim dhe degradim të ekosistemeve e habitateve, shqetësim të kafshëve të egra në natyrë, zhdukje llojesh apo kërcënim për zhdukje dhe prishje apo erozion gjenetik.

Flora e Bregdetit

Në vijën bregdetare prej 38 km të qarkut të Lezhës – ku gjenden zonat e mbrojtuar Kune – Vain e Patok – mbetet ndër më inetersantet e vendit tonë. Habitatet karakteristike të këtij bregdeti janë: dunat ranore, ligatina bregdetare, lagunat, pyjet halore mesdhetare, pyjet aluvionale bregdetare. Instituti i Kërkimeve Biologjike ka monitoruar këto habitate, llojet e rrezikuara dhe të futura të kësaj flore.

Dunat ranore

Sistemi i dunave ranore, në bregdetin e qarkut Lezhë, është i zhvilluar në mënyrë të konsiderueshme veçnisht në të dy anët e grykëderdhjes së lumit Drin. Në përgjithësi, ky sistem është i ruajtur mirë në kushtet natyrore. Por nga ana tjetër, aktiviteti njerëzor nëpërmjet zhvillimit të infrastrukturës, urbanizimit dhe turizmit përfaqëson një kërcënim të përhershëm dhe në rritje për ekosistemet e plazheve dhe dunave ranore. Mbi të gjitha, vija bregdetare e rajonit tonë është e kërcënuar në mënyrë serioze nga erozioni, i cili llogaritet në disa raste deri 2.5 m marrje e tokës nga deti, si pasojë e pakësimit të inerteve lumore të sjella nga lumenjtë Drin e Mat.

Ligatinat bregdetare.

Kanë një shtrirje të konsiderueshme dhe janë të mirëprezantuara në deltën e lumit Drin e Mat. Vegjetacioni i këtyre mjedisëve, për vetë kushtet e ashpra të rritjes (kripshmëri shumë e lartë dhe përmbytje të herëpashërme), paraqitet shumë i mirë, i ruajtur në krahasim me tipet e tjera të bimësisë të rajonit bregdetar. Dëme të konsiderueshme këtij vegjetacioni i janë shkaktuar në të kaluarën me anë të bonifikimeve.

Masat që propozohen: i) Zgjerimi i sipërfaqeve të mbrojtura ku të përfshihet dhe një pjesë e deltës së lumit Mat (zona Gurëz); ii) Përgatitja e planeve të menaxhimit; iii) Ndërmarrja e pyllëzimeve të reja me lloje të gjinisë Tamarix për vetë rëndësinë e madhe që kanë këto formacione për folelizimin e shpendëve.

Lagunat

Lagunat, në zonat e ndryshme të bregdetit të Adriatikut, kanë nivele të ndryshme të trofisë, të vlerësuara nga sasia e klorofilit A në fitoplankton. Në pikat e analizuar gjatë 2002 të lagunës së Kunes, rezultojnë nivele të ulëta të trofisë (me shpesh oligotrofike me tendencë më të rrallë të mezotrofisë) që janë karakteristike për ujëra të pastra.

Pyjet aluvionale bregdetarë

Pyjet natyrorë aluvionalë të bregdetit shqiptar përfaqësojnë pyje tipikë higrofilë, të përhapur kryesisht në grykëderdhjet e lumenjve Mat dhe Drin, mbi toka aluvionale kryesisht bazike, me nivel të lartë të ujërave nëntokësore dhe të përmbytura shpesh nga vërshimet apo shirat e rrëmbyeshëm. Deri para 10-15 vjetësh,

këto pyje përfaqësonin disa nga ekosistemet më të bukura të detit Adriatik.

Dëmtimet në këto pyje 10-vjetët e fundit janë të dukshme në grykëderdhjen e lumit Mat dhe të konsiderueshme në brezin Shëngjin-Kune dhe në Fushë-Kuqë. Pyjet e dikurshëm, në këto zona, kanë pamjen e shkurretave, kthimi i të cilave në gjendjen e mëparshme mund të kërkojë një periudhë 10-15 vjeçare. Kushtet e vecanta të përhapjes së këtyre pyjeve (toka aluvionale me nivel të lartë të ujërave nëntokësore dhe që përmbyten kohë pas kohe), në përgjithësi nuk lejojnë vendosjen e llojeve të tjera apo konkurrencën e tyre ndaj llojeve autoktone.

Masat që propozohen: i) Ruajtja dhe mbrojtja e këtyre formacioneve nga dëmtimet e mëtejshme; ii) Ndërhyrja me ripyllëzime në zonat më të dëmtuara me lloje autoktone të tilla si verri i zi (*Alnus glutinosa*), frashërin e ujit (*Fraxinus angustifolia*) dhe veçanërisht me *Quercus robur* (rrenja), një specie kjo e rrezikuar për bregdetin shqiptar; iii) Në zonat e dëmtuara, ku pylli ka marrë pamjen e një shkurrete të dendur, ndërhyrja me rrallime përbën domosdoshmëri për t'i dhënë hapësirë llojeve drunore; iv) Ndërprerja e prerjeve të paligjshme dhe ndërtimeve në këtë brez pyjor për qëllime turizmi.

Fauna e lagunave bregdetare

Muzeu i Shkencave Natyrore ka monitoruar faunën e lagunave kryesore bregdetare, e cila paraqitet më poshtë (Tab.41) sipas grupeve kryesore.

Situata paraqitet më negative në zonat e Kunës-Vainit dhe Patokut krahasuar me zonat e Nartës e Karavastasë, ku llojet e rrezikuar zënë respektivisht 63.6% dhe 61.5% të llojeve të vrojtuar në këto zona.

Shpendët

Janë monitoruar shpendë të ujit dimërues dhe folezues në lagunat bregdetare shqiptare dhe riprodhim i suksesshëm i shpendëve të ujit në lagunat e qarkut. Statistikat e regjistruara jepen në tabelën dhe grafikët e mëposhtëm (Tab.41) krahasuar kjo me lagunat e tjera të vendit.

Lloji	Kune-Vaini	Patoku
Gjitarë bioindikatorë të rrezikuar	7	8
Gjitarë bioindikatorë të vrojtuar	11	13
Raporti lloje të rrezikuar/ lloje të vrojtuar (në %)	63.6	61.5

Tab.41 - Llojet e rrezikuar të gjitarëve të zonave ligatinore bregdetare të përfshira në monitorimin për 2002 (Burimi: ARM Lezhë, 2004)

Shpendët dimërues

Në kompleksin e Kune Vainit, në 2002, u vrojtuan 32 lloje të shpendëve të ujit, me një numër të përgjithshëm prej 2318 individësh dimërues. Është shifra më e ulët e regjistruar gjatë periudhës 1995-2002. Që prej vitit 1995, vit i cili shënonte dhe maksimumin e shpendëve të regjistruar me afro 17250 shpendë, duket qartë që kompleksi sa vjen e humbet rëndësinë e tij për shpendët e ujit dimërues. Shumica e shpendëve, afro 47%, janë të përqëndruar në sipërfaqet ujore të Vainit, të ndjekura nga ato të Merxhanit. Në ndryshim nga vitet e mëparshme, numri i shpendëve në det është mjaft i ulët.

Laguna	Nr. i shpendëve ujore dimërues	Nr. Individëve të shpendëve ujore dimërues	Nr. i shpendëve ujore folezues
Velipojë	35	3.788	12
Kune- Vain	32	2.318	12
Patok	24	3.178	5
Karavasta	52	35.670	22
Butrint	40	14.103	9

Tab.42 - Numri i shpendëve dimërues dhe folezues të lagunave për 2002 (Burimi: ARM Lezhë, 2004)

Në kompleksin e Patokut shpendët e vrojtuar në lagunë dhe në det kapin shifrën e 3178 individëve, shifër kjo shumë e afërt me mesataren shumëvjeçare (1995-2002). Ndryshimi i vërejtur në këtë zonë nuk është vetëm numri i lartë i shpendëve, më tepër se numri ka ndryshuar sjellja e shpendëve.

Shpendët folezues

Në të gjithë kompleksin e Kune-Vainit u vrojtuan, gjatë ekspeditave verore, mbi 45 lloje shpendësh (184 individë), ku vetëm një pakicë i takon grupimit të shpendëve të ujit. Folezuesit e rregullt kapin shifrën e 11 llojeve, ndërsa llojet e tjerë mund të jenë fare mirë individë të cilët kalojnë sezonin e verës në një territor të caktuar. Në tërësi, numri i shpendëve të vrojtuar është shumë më i ulët se vetë kapaciteti mbajtës i zonës, ndonëse flitet për dy Zona të Mbrojtura me Statusin e Rezervatit Natyror të Manaxhuar.

Në kompleksin e Patokut komuniteti i folezuesve të ujit përfaqësohej me vetëm 5 lloje folezuesish.

Vitet	1995	1996	1997	2001	2002
Nr individëve	17.250	9.723	10.795	3.370	2.318

Tab.43 - Numri i individëve dimerues në vite në kompleksin e Kune- Vainit për disa vite në periudhën 1995-2002 (Burimi: ARM Lezhë, 2004)

Kompleksi vazhdon të mbetet zona më e rëndësishme e folezimit të shpendëve të ujit në Shqipëri. Numri i llojeve folezues si dhe numri i cifteve folezues mbetet më i lartë se në ligatinat e tjera shqiptare. Në krahasim me vitin e kaluar, ka ngritje të numrit të folezuesve. Prania e ndërmarrjes së peshkimit, gjatë periudhës 2001-2002, ka sjellë një përmirësim të menjëhershëm të gjendjes. Shpendët folezues janë më të qetë dhe shqetësimi me origjinë njerëzore është ulur ndjeshëm.

Shumica e kolonive duket së rrezikohen nga tri faktorë: i) përmytja nga ujërat detare; ii) dëmtimi i vezëve dhe i të vegjëlve nga gjiarët grabitqarë dhe; iii) shqetësimi me natyrë njerëzore.

Vitet	1995	1996	2001	2002
Nr. individëve	43-87	39-93	15-46	15-45

Tab.44 - Numri i cifteve të shpendëve ujorë folezues në zonën e Patokut me 1995 (Bino vrojt. pers.), 1996 (Zekhuis & Tempelman 1998) dhe 2001-2002 (Bino vrojt. pers.) (Burimi: ARM Lezhë, 2004)

Numri i përgjithshëm i llojeve, statusi i të cilave në këto zona është i rrezikuar, kap vlerën e 37 llojeve. Zona e Kune-Vainit duket më e rrezikuara, sepse ajo kap vlerën më të lartë të llojeve të rrezikuara. Dallohen këtu sidomos familja e Ardeideve (Cafkat), të cilat dikur folezonin me shumicë në këtë kompleks.

Shkaqet e gjendjes së vështirë të shpendeve janë: i) Gjuetia e paligjshme, përndjekja e kafshëve, kapja me qëllime tregtimi.

Është tani për tani faktori që shkakton dëmet më të mëdha te shpendët. Qëllohet mbi gjithcka dhe mbi cdo gjë, me sezon dhe pa sezon gjuetie.

Përdoren të gjitha mjetet e paligjshme si pushkët automatike, imituesit e zërave të shpendëve, dritat etj. Kafshët e mëdha po vuajnë më shumë; ii) Peshkimi i paligjshëm. Janë tejpërhapur format ilegale të peshkimit, si ato me drita apo dinamit. Rrjetat e peshkatarëve qëndrojnë tërë kohë në ujë duke bërë të pashfrytëzueshme pjesën më të madhë të sipërfaqes ujore. Anijet e peshkimit krehin bregun e detit në zona të ndaluara duke shkatërruar gjithcka në fundin e tij. Ky aktivitet ul rezervat ushqimore të shpendëve si dhe sjell shqetësimin e vazhdueshëm të tyre.

Amfibët dhe reptilët

Në zonat lagunore janë gjetur 10 lloje amfibësh e 29 lloje reptilësh. Zona e Kunes ka numrin më të madh të llojeve të rrezikuara të amfibëve e reptilëve (14 lloje). Në Kune vazhdon situata jo pozitive. Kështu numri i breshkave të tokës (*Testudo hermanni*) ka rënë rreth 2 herë në krahasim me 10 vite më parë; numri i shigjetës së gjatë (*Coluber caspius*), shigjetës së shkurtër (*Coluber gemonensis*), bollës së shtëpisë (*Elaphe longissima*), ka rënë rreth 4 here. Rënië e popullatave për shumë lloje reptilësh vihen re me shumë në pyllin e Kunes sesa në atë të Vainit.

Velipoje	Kune-Vain	Patok	Karavasta	Butrint
18	25	16	20	3

Tab.45 - Llojet e rrezikuara në shkallë lokale për secilën prej zonave për 2002 (Burimi: ARM Lezhë, 2004)

Shqetësuese është rënia e breshkave të detit *Caretta caretta* në rrjetat e peshkimit. Këto kafshë globalisht të rrezikuara, fatkeqësisht, vriten nga peshkatarët, pasi u shkatërrojnë rrjetat. Në lagunën e Patokut janë monitoruar dy popullata të breshkës detit globalisht e rrezikuar (*Caretta caretta*). Popullatat e studiuara prej 104 individësh i përkasin llojit *Caretta caretta* dhe vetëm një ekzemplar i llojit *Dermochelus coriacea* është kapur në gusht të 2002, në afërsi të brigjeve të Kunes, në thellësi 3m. Popullata më e madhe e *Caretta caretta* është ajo e Patokut e përbërë nga 88 individë, të rënë në rrjetat e peshkatarëve të kësaj zone. Rreth 80% e individëve janë kapur në Godull (grykëderdhja e lumit të Ishmit e Drojës). Grumbullimi i popullatave të *Caretta caretta* në Patok është i lidhur me bazën ushqimore të mirë që përbën popullata e gafores *Carcinus sp.* në këtë zonë.

Insektet

Nga vrojtimit dhe krahasimet e bëra vihet re një përqendrim gradual i gjendjes të insekteve. Duke analizuar përbërjen e

entomofaunës, vihet re së ajo dominohet nga llojet bregdetarë, të ndërthuar pak a shumë dhe me ato të pyjeve që rrethojnë këto zona dhe me entomofaunën e mjediseve ujorë me ujë të ëmbël apo me kripësi të papërfillshme. Aktiviteti i llojeve dëmtonjës nuk paraqet rrezikshmëri të lartë, me përjashtim të *Thaumetopoea pityocampa* (proçesionaria e pishës) apo të *Hypantria cunea*, që duhet të mbahen në evidencim për shpërthimet masive periodike që japin.

Molusqet

E vlerësuar në kompleks, situata e malakofaunës ligatinore paraqet ndryshime të vogla me atë të dy viteve të fundit. Ngjashmëria e situatës negative të saj lidhet me ndikimin e vazhdueshëm mbi ekosistemet ligatinore, i cili ka rolin e tij edhe mbi malakofaunën. Është për t'u theksuar përsëri varfëria e saj si në lloje edhe në biomasë, duke patur parasysh larinë biogeografike të këtyre mjediseve, si dhe duke krahasuar malakofaunën (molusqet) e lagunave me kushte të afërta të vendeve fqinje të Adriatikut dhe Mesdheut.

Analizat kimike të sedimentit kanë treguar gjithashtu nivele të ulta ndotjeje nga metalet e rëndë si dhe përmbajtje të vogël të fosfateve. Këto rezultate janë tregues për mundësinë e pakët të eutrofikimit të lagunës.

Përqindja më e lartë e llojeve të kërcënuar të molusqeve vërehet në lagunën e Patokut me 72%. Nga numri i llojeve, vlerat e dendësisë dhe frekuencës, situata e malakofaunës në lagunën e Patokut duhet të konsiderohet kritike.

Grumbullimi i drejtpërdrejtë i molusqeve në laguna kohët e fundit është zbehur, por ka një rritje interesi për tregtimin e molusqeve bregdetarë dhe detarë. Peshkimi i vazhdueshëm me lëndë plasëse është një tjetër dëmtim i drejtpërdrejtë për malakofaunën, sidomos

Laguna	Insekte total	Insekte të kërcënuara	Insekte ujore
Kune-Vain	117	11	13
Patok	141	13	17
Divjake	124	18	17
Butrint	127	22	7

Tab.46 - Shpërndarja llojore e insekteve në lagunat për 2002 (Burimi: ARM Lezhë, 2004)

gjatë periudhës së riprodhimit të molusqeve. Rrjetat fundore të peshkimit shkaktojnë dëmtim mekanik dhe ato i zhvendosin

Laguna	Molusk total në lagunë	Gastropode në lagunë	Bivalvora Në lagunë	Molusk total në Bregdet
Vilun	24	13	11	24
Kune	40	16	24	23
Vain	30	13	17	
Patok	18	7	11	18
Karavasta	28	17	11	24
Butrint (brigjet e kanaleve)	17	-	-	25

Tab.47 - Shpërndarja llojore e molusqeve në lagunat bregdetare (Burimi: ARM Lezhë, 2004)

moluskët nga kushtet e veçanta të habitatit të tyre. Ndotja e ujërave për shkak të derdhjeve të ujërave të zeza të fshatrave përreth, ujërave me përmbajtje detergjentësh, helmesh kimike bujqësore dhe karburantesh, përbën një tjetër faktor dëmtues për malakofaunën bregdetare.

Rekomandime

(i) Pezullimi në mënyrë të diferencuar i gjuetisë në zonat ligatinore bregdetare për një afat kohor prej 3-5 vjetësh, me qëllim që t'i jepet mundësi faunës së egër që të rimarrë veten dhe më pas të kalohet në një gjueti të kontrolluar dhe racionale brenda mundësive reale të vjeljes së gjahut; (ii) Hartimi i planeve të menaxhimit

Laguna	Total Lagunë	Gastropode Lagunë	Bivalvora Lagune
Vilun	16	11	5
Kune- Vain	21	9	12
Patok	13	7	6
Karavasta	16	11	5

Tab.48 - Shpërndarja e llojeve të molusqeve të kërcënuar në lagunat bregdetare për 2002 (Burimi: ARM Lezhë, 2004)

për zonat e mbrojtura; (iii) Rritja e kontrollit nga Inspektoriati e ndryshme mbi aktivitetet që ushtrohen brenda këtyre zonave, me qëllim rregullimin e tyre dhe minimizimin e ndikimit të tyre në faunë. Si të tilla përmendim kullotjen, gjuetinë, peshkimin, rigjenerimin; (iv) Në zonat e njohura si zona të riprodhimit ose shtimit nuk duhet lejuar asnjë lloj shqetësimi nga prania dhe veprimtaria e njeriut. Cdo shqetësim gjatë riprodhimit do të sillte dështimin ose rritje të vdekshmërisë, e për pasojë ulje të efektivave të popullatave të llojeve; (v) Të vendosen tabela për mbrojtjen e shpendëve dhe parandalimin e shqetësimit; (vi) Të rritet shkalla e edukimit mjedisor për rëndësinë ekoturistike të llojeve të shpendëve; (vii) Duhet marrë masa për ndalimin e peshkimit në ujërat e cekëta bregdetare, peshkim i cili paraqitet me pasojë të rënda edhe mbi gjitarët e ujit si delfinët. Janë jo të pakta rastet e delfinëve të rënë në rrjetat e peshkimit në këto ujëra, e që më pas kanë ngordhur e dalë në breg; (viii) Duhet të ndërmerren masa dhe fushata ndërgjegjësuese për peshkatarët për rolin dhe rëndësinë e gjitarëve detarë për vetë ekonominë dhe jetën detare. Të punohet për ndërgjegjësimin e popullatës për rëndësinë e breshkave të ujit si kafshë globalisht të rrezikuara nëpërmjet emisioneve televizive, botime etj., si dhe puna me peshkatarët për t'i lëshuar përsëri në det breshkat e rëna në rrjetat e tyre. Gjitarët dhe breshkat detare duhet të jenë simbole të pasurisë dhe bukurisë detare; (ix) Ndalimin e peshkimit me lëndë plasëse; (x) Ndalimin e grumbullimit masiv të pakontrolluar të molusqeve në të gjitha mjediset, sidomos në periudhën e riprodhimit.

Ajri

Shkarkimet në ajër nga automjetet

Pas viteve 1990 me rritjen e numrit të automjeteve u rritën dhe shkarkimet në ajër të produkteve të djegies së karburanteve, të cilat ndikuan e ndikojnë në përkeqësimin e cilësisë së ajrit, dukuri kjo më e theksuar në zonat urbane. Mungesa e sigurisë në standardizimin e karburanteve, si dhe hyrja e makinave të përdorura deri në masën 90 % janë faktorë që rrisin nivelin e ndotjes.

Rrethet	Numri i automjeteve	Nga këto me nafte
Lezha	3.794	2.845
Kurbini	3.480	2.784
Mirdita	1.143	937
Gjithsej Qarku	8.417	6.566

Tab.49 - Numri i automjeteve sipas karburantit të përdorur (Burimi: ARM Lezhë, 2002)

Krahas faktorëve, që kanë ndikuar dhe ndikojnë në ndotjen e mjedisit, ka pasur dhe faktorë të cilët kanë pësuar rënie vitet e fundit si rezultat i mosfunksionimit të minierave të pasurimit dhe rafinimit të bakrit në Rubik e Laç dhe zonën përreth si dhe nga mosfunksionimi i uzinës së superfosfatit në Laç, të cilat para viteve 90 kanë ndikuar ndjeshëm në ndotjen e tij.

Gjatë viteve 2001-2002 është monitoruar uzina e bakrit në Laç si zonë e nxehtë mjedisore.

Nga monitorimi i ajrit, ujërave sipërfaqësore dhe ndotjes së tokës në territorin e ish-Uzinës së Shkirjes dhe Rafinimit të Bakrit në Lac, gjatë vitit 2002 nga ISPTK (sot Instituti i Mjedisit), janë vërejtur probleme mjedisore të cilat kanë ardhur nga përdorimi i teknologjive të vjetëruara që janë vendosur. Sot për sot kjo uzinë është e shkatërruar dhe ndodhet në fazën e konservim – likuidimit, ndërkohë ndikimi negativ do të vazhdojë për sa kohë do të mbeten burimet ndotëse në territorin e saj.

Për sa i përket ndotjes së ajrit, nuk vërehen probleme sepse sot për sot uzina nuk punon, por në ditë të caktuara uzina e Superfosfatit, që është afër kësaj uzine, shkarkon në ajër HF, SO₂, SO₃ (aktualisht ka ndëprerë aktivitetin). Vihet re një ndotje e ujërave sipërfaqësore me hekur, lëndë organike, lëndë pezull dhe mbetje në 180 °C, por treguesit flasin për nivele jo të larta të ndotjes.

Mbetjet dhe administrimi i tyre

Ndotje e theksuar e tokës është prezente në territorin e uzinës nga bakri, zinku, arseniku etj., e cila mund të jetë një burim i mundshëm për ndotjen e ujërave.

Nga elementet e analizuar rezulton se për uzinën e metalurgjisë së bakrit kemi situatën mjedisore e cila pasqyrohet në grafikët e nxjerra nga monitorimet dhe krahasimi i tyre me standardet.

Ndotja e tokës nga bakri, si rrjedhojë e aplikimit të një teknologjie të prapambetur, është shumë e lartë dhe përbën një burim potencial dhe për ndotjen e ujërave.

Ndotja e tokës nga zinku është disa herë më e lartë së standardet ndërkombëtare dhe përbën problem serioz për mjedisin.

Përmbajtja e plumbit në tokë është e ulët dhe nuk përbën problem për mjedisin.

Terreni i uzinës është i ndotur në mënyrë të konsiderueshme me arsenik, gjë që përbën problem shqetësues për këtë zonë dhe më gjerë.

Në uzinë ndodhen të depozituara, në kushte jo të përshtatshme, rreth 1200 m³ katalizator i përdorur vanadi, i cili përmban deri 3.3 % V₂O₅; 2.05 % As dhe është i ndotur me asbest. Rreth 850 m³ katalizator ndodhen në objektin e filtrave me mëngë dhe rreth 335 m³ katalizator, i përzier me materiale termoizoluese dhe asbest, ndodhen tek objekti i ish depos së uzinës.

Përmbajtja e nikelit në tokë është e ulët dhe e krahasueshme me standardet ndërkombëtare, ndërsa përmbajtja e hekurit nuk përbën problem shqetësues për mjedisin, krahasuar me elementet e tjerë ndotës.

Ndërprerja e aktivitetit të uzinës ka ndikuar për përmirësimin rrënjësor të mjedisit pranë saj dhe më gjerë, por shkatërrimi i vazhdueshëm i uzinës do ta keqësojë gjendjen për depozitim dhe ruajtjen e sigurt të katalizatorit.

Si masa afat-shkurtëra rekomandohen: i) Për përmirësimin e cilësisë së ujërave rekomandohet gëlqerizimi i territorit të uzinës. Heqja dhe depozitimi i mbetjeve në një vend të sigurt, në mënyrë që të eliminohet rreziku i mundshëm; ii) Ndërkohë është i nevojshëm hartimi i një projekti kompleks për asgjësimin e mbetjeve dhe rehabilitimin e objekteve dhe pajisjeve industriale.

Turizmi

Qarku i Lezhës ka një pozitë të favorshme gjeografike. Burimet natyrore dhe klima e përshtatshme bëjnë që turizmi të jetë, jo vetëm mundësi, por edhe një e ardhme e sigurt. Tërësia e këtyre faktorëve bëjnë të mundur zhvillimin e të gjitha llojeve të turizmit, qoftë atij bregdetar, që mbetet edhe për të ardhmen me mundësi të mëdha zhvillimi, por edhe turizmit malor dhe arkeologjik e historik.

Qarku i Lezhës ka një sipërfaqe turistike bregdetare prej 11 000 ha, me vijë prej bregdetare 38 km dhe 3 km gjerësi të brezit bregdetar që nga Velipoja në Veri deri në Kepin e Rodonit në Jug. Gjatë vijës bregdetare ka vende mjaft të përshtatshme për fshatra turistike apo porte turistike.

Në këtë gjerësi shtrihet edhe kompleksi natyror i luginave Kune-Vain dhe Patok që, për nga bukuritë që ka dhe për shumëllojshmërinë e llojeve të florës e faunës që zotëron, është quajtur “Ornitologjia e Mesdheut”.

Masivet malore të shumta me lartësi të mëdha mbi nivelin e detit, me pyjet dhe burimet që ndodhen në to, krijojnë bukuritë të veçanta dhe mundësi për zhvillimin e turizmit malor e alpin. Për t'u përmendur janë bjeshkët e Kunorës me Kroin e Bardhë (uji kurativ që është mjaft i frekuentuar nga vizitorët sezonalë apo pushues), apo kompleksi i liqeneve të Lurës rreth bjeshkës së Kunorës në Selitë, Mirditë, bjeshkët e Trodhnes në Kurbin, të Velës në Lezhë, bjeshkët e Munellës, Oroshit, Kaçinarit, Xhuxhës në Mirditë.

Gjithashtu, objektet arkeologjike, historike, muzeale dhe ato të kultit i bëjnë një prezantim dinjitoz, jo vetëm historisë, por edhe burimeve turistike të këtij qarku.

Kështu, në Lezhën e datuar në vitin 385 p.e.s. janë vendvarrimi i Heroit Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu, Kalaja e Lezhës, Kuvendi i Arbërit.

Në Kurbin gjenden Kalaja e Sebastës, Kisha e Shna Ndout, me shpellën e Shna Vlashit, që është rast unikal në Shqipëri për nga

vizitorët, Ipeshkvnia e Delbnishtit, Ura e Zogut etj.
 Në Mirditë janë Kisha e Oroshit, Abacia e Mirditës, Sarajet e Gjon Marka Gjonit. Kisha e të Shëlbuemit në Rubik etj.
 Mungesa e vëmendjes nga shteti apo pushteti vendor për përmirësimin e infrastrukturës turistike në këto treva ndikon dukshëm në zhvillimin e turizmit në qarkun e Lezhës.

Pasuritë natyrore

Rrjeti i zonave të mbrojtura.

Qarku i Lezhës ka në sipërfaqe prej 5.380 ha, e cila përfshihet në zonë të mbrojtur, që është e kategorisë IV .Sipas rrethëve paraqitet:

Kategoria	Nr.	Miratimi	Zona e mbrojtur	Rrethi	Sip. ha
IV	1	1940	Kune	Lezhë	800
IV	2	1940	Vain	Lezhë	1.500
IV	3	1962	Patok – F. Kuqe	Kurbin	2.200
IV	4	1977	Berzane	Lezhë	880
IV	5	1996	Bjeshka e Oroshit	Mirditë	4.700
				Totali	5.380

Tab.49 - Zonat e mbrojtura dhe kategoritë e tyre
 (Burimi: ARM Lezhë, 2004)

Programi i Zhvillimit

OBJEKTIVI 1: Zhdukja e Varfërisë Ekstreme dhe Urisë

Qarku Lezhë përballet me problemet më të rënda që sjellin varfërinë, pavarësisht nga ekzistenca e potencialeve të mëdha të burimeve. Një shqetësim të veçantë përveç varfërisë të gratë përbën edhe papunësia tek të rinjtë.

Përveç mundësisë për reduktimin e varfërisë në qarkun Lezhë puna do të përqendrohet edhe në eliminimin e saj.

Prishja e ndërmarrjeve shtetërore, sidomos në Kurbin dhe Mirditë çoi në një rritje të lartë të papunësisë.

Gjithashtu, aktiviteti bujqësor në qarkun Lezhë kryhet, zakonisht, vetëm për qëllime mbijetese, ndërsa parcelizimi i tokës ul fitimet nga ushtrimi i biznesit të vogël bujqësor.

Përveç kësaj mungesa e teknologjisë së përpunimit të prodhimeve në sektorin bujqësor ul fitimin dhe rrit papunësinë.

Po kështu, infrastruktura (rrugët, energjia elektrike, uji) është në një gjendje mjaft të rënduar, gjë që nuk favorizon zhvillimin e këtij biznesi apo eksportimin e mallrave për në tregjet jashtë qarkut Lezhë.

Mosinvestimi në mjediset edukative dhe rënia e nivelit të përvetësimit të dijeve ka sjellë analfabetizëm informal.

Shërbimi shëndetësor ka nevojë urgjente për investime dhe për stimulim të personelit mjekësor për të punuar edhe në zonat rurale, gjë që do të ndikojë dukshëm dhe luftën kundër varfërisë.

Gjithashtu, shqetësim përbën edhe tradita e superioritetit të burrit ndaj gruas, duke bërë që kontributi i gruas të jetë “i padukshëm”. Si rezultat i këtyre problemeve, migrimi drejt qendrave urbane brenda Shqipërisë dhe jashtë saj është në një shkallë të lartë (kështu, rreth 20% e popullsisë në Mirditë ka migruar). Dërgimi i fitimeve nga jashtë Shqipërisë shërben si një zgjidhje e përkohshme për varfërinë e skajshme.

Mungesa e investimeve kombëtare dhe e atyre ndërkombëtare në zonat me HDI të ulët, shfrytëzimi jo në mënyrë të qëndrueshme e burimeve natyrore, mungesa e kreditimit, mungesa e një programi strategjik për reduktimin e varfërisë bëjnë që papunësia të rritet, fitimet të ulen dhe varfëria të rritet.

Në qarkun e Lezhës, 60 % e popullsisë është rurale dhe, njëkohësisht, prania e 38 km vijë bregdetare na sugjeron që për uljen e varfërisë, përveç përqendrimit të vëmendjes te sektori bujqësor, duhet t'i kushtojmë një vëmendje të veçantë turizmit bregdetar dhe malor.

Parcelizimi i tokës dhe largësitë e mëdha mes tyre, mungesa e mekanikës bujqësore, mungesa e kreditimit, infrastruktura e dobët kulluese dhe rrugore që sjell pamundësinë e shfrytëzimit të tregjeve të jashtme, janë probleme që shoqërojnë sektorin bujqësor në qarkun Lezhë.

Një program i integruar i zhvillimit rural që ofron politika zhvillimi specifike për bujqësinë dhe blegtorinë, duke ndërmarrë një studim GIS fizibiliteti mbi përdorimin e tokës e lidhur edhe me politikat kombëtare, do të realizonte monitorimin e treguesve dhe do të ndikonte në zbutjen e varfërisë.

Me mjaft rëndësi është edhe përgatitja e një studimi dhe plani të plotë të zhvillimit rural, e politikave specifike zhvillimi për prodhimin bujqësor dhe blegtoral, agroindustrisë, agroturizmit, turizmit bregdetar dhe peshkimit, që do të mundësonin përdorimin efektiv të burimeve ekzistuese.

Për rritjen e prodhimit blegtoral vëmendja duhet përqendruar

në këto drejtime: përmirësimi racor, ngritja e shërbimeve për kujdesin shëndetësor të bagëtive dhe te studim mbi përmirësimin e cilësisë së ushqimit të kafshëve.

Prodhimi bujqësor duhet të synojë në certifikimin e farërave të drithërave apo perimeve, duke u bazuar në llojin e tokës, në çmimin e farës, ujitjen, kërkesën e tregut, pasi deri tani bazohet në traditë dhe në gjetjen e farërave jo sipas kërkesave të tregut. Aktiviteti i peshkimit është me mundësi të mëdha zhvillimi për gjithë rajonin, por edhe për eksport, por që kërkon kreditim me interesa të ulta.

Drejtim tjetër i rëndësishëm për zhvillim është edhe kultivimi i frutave, vreshtave dhe i ullirit, një studim fizibiliteti sipas kërkesave të tregut, tërheqje informacioni për projekte marketingu dhe për përmirësimin e vreshtarisë dhe të ullirit, ngritja e plantacioneve të reja nëpërmjet stimulimit me kredi me interes të ulët, projekte pilot rehabilitimi.

Produkte të tilla si bimët mjekësore të qarkut Lezhë janë të njohura në të gjithë vendin dhe përbëjnë një burim të madh ekonomik.

Industria e përpunimit të prodhimeve bujqësore, blegtorale, peshkimi, përbën një fushë parësore, pasi përveç rritjes së cilësisë së shërbimit, këtu sigurohet edhe hapja e vendeve të reja të punës, rritja e të ardhurave e, si rrjedhim, zbutja e varfërisë. Për këtë është e domosdoshme të realizohen trajnime profesionale, të krijuhen lehtësi për investimet e huaja apo kredi me interes të ulët për bizneset e reja.

Për të realizuar me sukses këto politika, nevojiten burime njerëzore intelektuale, të zgjedhur të përgjegjshëm sipas kërkesave të lidershipit, të funksionojë ligji mbi decentralizimin vendor, decentralizimi fiskal, të luftohet korrupsioni që ndikon në rritjen e bizneseve private, të luftohet ekonomia informale etj.

Proceset e mësipërme duhet të shoqërohen me programe mbi infrastrukturën, që kanë të bëjnë me ndërtimin dhe rehabilitimin e rrugëve kombëtare dhe rurale, me rrjetin elektrik, menaxhimin e burimeve ujore dhe mbetjeve urbane, eliminimin e përmytjeve, me infrastrukturën turistike etj. Kështu, duke pasur një infrastrukturë të fortë dhe të qëndrueshme, do të ndikonim dukshëm në reduktimin e varfërisë.

Një nga objektivat më të rëndësishme që synohet nëpërmjet kësaj strategjie është jo vetëm zhvillimi i turizmit brenda vendit, por edhe tërheqja e turistëve të huaj. Natyra e ka krijuar këtë mundësi, duke i dhuruar qarkut Lezhë bukuri të rralla natyrore, liqene dhe lumenj të mrekullueshëm dhe natyra kurative e tyre është me mjaft interes për fshatra të vegjël turistike malorë, ashtu si janë bregdeti dhe lagunat me një plazh akoma të pashfrytëzuar si duhet për porte turistike apo fshatra turistike të vegjël të turizmit bregdetar.

Prioritetet Strategjike

SKZHES dhe Kornizat Kombëtare	OZHM	BE	Qarku i Lezhës
<p>1. 50% ulje e nivelit aktual të varfërisë dhe eliminimi i varfërisë ekstreme</p> <p>2. Dyfishimi i GDP –së për frymë deri në vitin 2015</p> <p>3. Plotësimi i nevojave të grave që vuajnë nga varfëria</p> <p>4. Krijimi i mundësive që gratë të përfitojnë nga institucionet kredituese</p> <p>5. Shtimi i mundësive për punësimin e grave</p>	<p>1. 50% ulje e përqindjes së njerëzve që jetojnë me më pak se një dollar në ditë dhe atyre që vuajnë nga uria</p> <p>2. Investim në zhvillimin njerëzor – në shëndetësi (ku përfshihen shëndeti riprodhues), arsim, ujë dhe kushte sanitare – për të krijuar një forcë punëtore produktive, e cila mund të marrë pjesë efektivisht në ekonominë botërore</p>	<p>1. Zhvillimi i sektorit privat nëpërmjet sektorit të ndërmarrjeve të integruara konkurruese dhe ndërkombëtare në Shqipëri, për të qenë në gjendje të tërheqin investime të huaja direkte</p> <p>2. Krijimi i një mjedisi të sigurt për biznesin dhe të përmirësohen korniza ligjore dhe regjimet fiskale në linjë me kërkesat e KE dhe OBSH</p> <p>3. Adoptimi dhe zbatimi i SME dhe i strategjive për nxitjen e tregtisë</p> <p>4. Formulimi i një strategjie për nxitjen e eksportit të produkteve bujqësore</p> <p>5. Forcimi i institucioneve rregullatore në fushën e sigurisë së ushqimit</p>	<p>1. Ulja 50 % e nivelit të varfërisë dhe eliminimi i varfërisë ekstreme</p> <p>2. Rritja dhe zhvillimi i agrobiznesit, industrisë tregtare dhe turizmit</p> <p>3. Rritja e mundësive të punësimit të ekuilibruar dhe e mundësive të kreditimit</p>

Synimet e Qarkut:

- 1.1 Përgjysmimi nga viti 2005 deri në vitin 2015 i përqindjes së njerëzve me të ardhura me pak se një dollar në ditë (OZHM), duke krijuar vende të reja pune dhe duke mbështetur zhvillimin e biznesit, veçanërisht nëpërmjet zhvillimit intensiv të prodhimit bujqësor e blegtoral me synim tregun, si dhe veprimtarive të përpunimit të produkteve.
- 1.2 Zhvillimi i infrastrukturës, duke përmirësuar rrugët, sistemimin e rrjetit të ujit të pijshëm, sistemimin e rrjetit kullues të kanalizimeve (në veçanti sistemimi i lumit Drin), vënia në punë e hidrovoreve, furnizimi me energji elektrike, me vëmendjen kryesore që deri në 2015 të përgjysmohet përqindja e njerëzve që nuk kanë mundësi të përdorin ujin e pijshëm sipas standarteve të sigurisë, si dhe eliminimi i përmbytjeve.
- 1.3 Nxitja e zhvillimit të ndërmarrjeve industriale, të vogla dhe të mesme, së bashku me prodhimin vendas, duke krijuar kushte të favorshme për investime vendase dhe të huaja, si dhe mbështetja dhe krijimi i programeve të zhvillimit për NVM / mikro-ndërmarrjet, ku të punësohen sidomos të rinjtë.

Treguesit

1. Treguesit e forcës punëtore:

Shkalla e papunësisë: Mesatarja e papunësisë sipas BE-së për vitin 2003 në masën 8 %, krahasuar kjo me mesataren kombëtare prej 14.6 %, tregon se standardet kanë nevojë të menjëhershme të përmirësohen. Duhet të sqarohet se për gjetjen e papunësisë reale ka mjaft vështirësi, pasi ndikojnë të paktën dy faktorë: ekonomia informale, mosregjistrimi pranë zyrave të punësimit i forcave aktive të papunë. Megjithatë, papunësia e llogaritur në qarkun Lezhë, sipas INSTAT-it 2003 është 28 %.

2. Treguesit Socialë:

- % e familjeve që përfitojnë nga asistencë sociale: Asistencë sociale trajtohet në mënyra të ndryshme në shtete të ndryshme. Mesatarja e BE-së (në vitin 1992) është 5.97 % krahasuar me 17.4 % (D.R.Nd.Ek.Lezhë 2003) që është në qarkun Lezhë. Duhet të sqarohet se ky tregues vështirë se do të arrijë % e BE-së për vetë gjeografinë që ka ky qark.

- Furnizimi me ujë dhe uji i rrjedhshëm mesatarisht në një ditë: Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit kanë për synim të përgjysojnë numrin e ekonomive familjare që nuk përdorin ujë të pastër të pijshëm deri në vitin 2015. Baza e qarkut sipas INSTAT-it 2001 është 38.5 % nga 97.14 % në vitin 1984 mesatarja e BE-së. Për këtë tregues një ndërhyrje më e madhe kërkohet në zonat rurale.

Përsa i përket ujit të rrjedhshëm mesatarisht për 24 orë, dëshirojmë që ai të jetë 100 % në dispozicion të konsumatorëve ashtu siç është edhe mesatarja e BE-së prej 98 % (në vitin 2000). Qarku i Lezhës ka një furnizim prej 34.8 % në 24 orë. Është e domosdoshme dhe jetike që të realizohet ky tregues, që është i lidhur ngushtë edhe me energjinë elektrike.

3. Të ardhurat nga sektori i bujqësisë (fermat):

Të ardhurat nga sektori i bujqësisë në raport me të ardhurat e tjera kombëtare për vitin 2002 sipas SKZHES ishte 33.3 %. Duke pasur në qendër të vëmendjes këtë sektor me kreditime dhe mbështetje nxitëse, ky tregues është plotësisht i realizueshëm.

4. Indeksi i Zhvillimit Njerëzor (HDI):

Siç sqaruam edhe më sipër, HDI është llogaritur duke u mbështetur në: jetëgjatësinë, nivelin e edukimit, largimin nga shkolla dhe GDP për frymë. Kemi treguar që në kapitullin e parë të Strategjisë që qarku i Lezhës është me HDI të ulët, 0.752 në vitin 2002, por është e pritshme që HDI e qarkut të rritet në mënyrë të ndjeshme deri në vitin 2015.

Treguesit aktualë dhe të parashikuar

Synimi	Treguesit	Mesatarja Kombëtare e Shqipërisë (në %)	Baza e qarkut të Lezhës (në %)	2006 (në %)	2009 (në %)	2012 (në %)	2015 (në %)	Mesatarja e BE (në %)
1.1 1.3	1. Niveli i papunësisë	14,6 (INSTAT, 2002)	28 (INSTAT, 2003)	25	20	17	14	8 (BE 2003)
1.1 1.3	2. % e familjeve që marrin asistencë sociale	22,6 (INSTAT, 2002)	17 (D.R.Nd. Ekonomike 2003) (INSTAT 2001,25%)	16	14	13	10	5,97 (1992, BE)
1.1	3. të ardhurat nga sek. i bujqësisë	33,3 (SKZHES 2002)	20 (RC,2003)	25	30	35	45	n/a
1.2	4. Furnizimi me ujë në banesë	46,9 (2002, NHDR)	38,5 (INSTAT,2001)	44	55	70	80	97,14 (1984)
1.2	5. Uji i rrjedhshëm mesatarisht për 24 orë	s'ka	34.8 (Sipas RC,2003)	38	50	85	95	98 (2000)
1.1 1.2 1.3	6. Indeksi i Zhvillimit Njerëzor	0,733 (Raporti Kombëtar i Zhvillimit Njerëzor 2002)	0,752 (Raporti i Zhvillimit Njerëzor Shqipëria, 2002)	0.760	0.768	0.775	0.800	0,921 (Raporti Global i Zhvillimit Njerëzor 2002)

Programi i Zhvillimit

Synimi 1.1: Përgjysmimi nga viti 2005 deri në vitin 2015 i përqindjes së njerëzve me të ardhura më pak se një dollar në ditë (OZHM), duke krijuar vende të reja pune dhe duke mbështetur zhvillimin e biznesit, veçanërisht nëpërmjet zhvillimit intensiv të prodhimit bujqësor e blegtoral me synim tregun, si dhe të veprimtarive të përpunimit të produkteve.

Problemi	Projekti	Përshkrimi	Periudha kohore	Partnerët potenciale	Shpenz (Euro)	Efkti
Mungesa e njohurive për përdorimin e tokës dhe përshtashmërinë për aktivitete bujqësore me orientim nga tregu.	Studim GIS për cilësinë e tokës dhe ç'farë prodhon sipas zonave.	Shënimi në hartë i burimeve bujqësore dhe natyrore (përfshi edhe burimet njerëzore)	2005 - 2006	KQ, OJF, Donatorët, Institucione kërkimore, QSH, Firma të huaja konsulente.	550.000	Duke pasur një burim të përhershëm të dhënash realizohet dhe monitorimi i treguesve dhe zbatimi efektiv i programit.
Mungesa e një strategjie të qartë (veprimi) për përmirësimin dhe rritjen e vazhdueshme të sektorëve të bujqësisë, blegtorisë dhe turizmit	Plan i plotë i zhvillimit rural dhe i turizmit bregdetar	Përgatitja e një studimi dhe plani të plotë të zhvillimit rural: politika specifike zhvillimi për prodhimin bujqësor dhe blegtoral, agroindustrinë, agroturizmin, turizmin bregdetar dhe peshkimin.	2005 - 2006	KQ, Drejtoria e Bujqësisë, Kërkuesit, OJF, etj.	450.000	Kjo strategji do të mundësojë përdorimin efektiv të burimeve ekzistuese në funksion të zhvillimit të sektorëve dhe rezultatet e saj do të ndikojnë pozitivisht në të gjithë treguesit.
Hortikulturë e varfër si pasojë e degradimit të plantacionit të frutave	Projekte të rehabilitimit të frutave, vreshtarisë dhe ullirit.	Studim fizibiliteti bazuar në kërkesën e tregut.	2005	KQ, OJF, Donatorët, Institucione kërkimore, QSH Firma të huaja konsulente.	100.000	Orientimi dhe përmirësimi i sektorëve sipas kërkesave të tregut do të rrisë të ardhurat e këtyre njerëzve të përfshirë në këto aktivitete, duke ndikuar dhe në treguesit 1, 2, 3.
		Tërheqje informacioni për projekte marketingu dhe përmirësimi të vreshtarisë dhe ullirit	2005	KQ, OJF, Donatorët, Institucione kërkimore, QSH Firma të huaja konsulente.	80.000	
		Projekte pilot rehabilitimi	2005 - 2008	KQ, OJF, Donatorët	2.000.000	
		Ngritja e plantacioneve të reja nëpërmjet nxitjes me kredi me interes të ulët	2008 - 2015	KQ, OJF, Donatorët	9.000.000	

Problemi	Projekti	Përshkrimi	Periudha kohore	Partnerët potenciale	Shpenz (Euro)	Efekt
Pamundësia e shtresave të rrezikuara për t'u integruar në shoqëri	Projekte rehabilitimi	Sigurimi i trajnimeve profesionale sipas këkesave të tregut	2005 - 2008	KQ, OJF, MPÇS	400.000	Përmirësimi i qeverisjes vendore në adresë të këtyre problemeve, përmirësimi i jetesës për këtë shtresë të shoqërisë, zvogëlimi i shtresës së ekspozuar ndaj rreziqeve, duke ndikuar edhe në treguesit 1, 2, dhe 6.
		Programe të veçanta për integrimin e tyre: me aktivitete sociale, programe punë përmes asistencës, nxitjes së biznesit për punësimin e kësaj shtrese të shoqërisë	2005 - 2015	KQ, OJF, MPÇS	500.000	
Prodhimi i ulët bujqësor si rezultat i cilësisë së dobët të farërave të drithërave dhe perimeve	Certifikimi i farërave	Studim fizibiliteti për certifikimin e farërave	2005	KQ, Institucione kërkimore Donatorët, Konsulent të huaj.	70.000	Rritja e rendimentit nga farërat e certifikuar do të rrisë prodhimin dhe për pasojë do të përmirësojë nivelin e jetesës së fermerëve duke ndikuar edhe në treguesit 1, 2, 3, dhe 6
		Projekt pilot për të vlerësuar nevojat për farëra të certifikuar	2005 - 2006	KQ, OJF, Donatorët	500.000	
		Magazine farërash të certifikuar në çdo rreth, nëse projekti pilot arrin sukses. Magazinat do të mbahen si biznese private.	2005 - 2009	KQ, OJF, Donatorët	750.000	
Rrjet i dobët për kujdesin shëndetësor të bagëtive	Ngritja e shërbimeve për kujdesin shëndetësor të bagëtive	Ngritja e shërbimeve të reja veterinarë për bagëtitë në të gjitha komunat e bashkitë nëpërmjet kredive me interes të ulët për zhvillimin e bizneseve dhe trajnimin e stafit dhe fermerëve.	2005 - 2006	KQ, OJF, Donatorët, Institucione kërkimore, QSH Firma të huaja konsulente.	1.200.000	Nëpërmjet përmirësimit të shëndetit të bagëtive ofrojmë një jetesë më të sigurt për familjet që janë të përfshira në këto veprimtari, duke ndikuar edhe në treguesit 1, 2, 3 dhe 6
Cilësi e dobët e ushqimit për bagëtinë	Studime për përmirësimin e ushqimit të kafshëve	Analizimi i llojeve me efektive të ushqimit dhe zonave për rritjen e prodhimit blegtoral dhe përdorimin efektiv të tokës	2005 - 2006	KQ, OJF, Donatorët Institucione kërkimore, QSH Firma të huaja konsulente.	90.000	Sjell rritjen e prodhimit dhe të ardhurave, nxit fermerët për rritjen e cilësisë dhe ndikon në treguesit 1, 3 dhe 6

Problemi	Projekti	Përshkrimi	Periudha kohore	Partnerët potenciale	Shpenz (Euro)	Efekt
Cilësi e dobët e ushqimit për bagëtinë	Studime për përmirësimin e ushqimit të kafshëve	Analizimi i llojeve me efektive të ushqimit dhe zonave për rritjen e prodhimit blegtoral dhe përdorimin efektiv të tokës	2005 - 2006	KQ, OJF, Donatorët Institucione kërkimore, QSH Firma të huaja konsulente.	90.000	Sjell rritjen e prodhimit dhe të ardhurave, nxit fermerët për rritjen e cilësisë dhe ndikon në treguesit 1, 3 dhe 6
Mungesa e sektorit të peshkimit në brendësi, për shkak të teknologjisë së varfër, mungesa e investimeve dhe mungesa e kredive për zhvillimin e aktiviteteve	Projekte për prodhimin e peshkut në ferma dhe studime për peshkimin në det.	Rritja e teknologjisë për peshkimin në det nëpërmjet nxitjes nga shteti dhe mbështetjes me kredi me interes të ulët	2005 - 2008	KQ, OJF, Donatorët, Istitucione kërkimore, Ministria e Bujqësisë Firma të huaja konsulente	2.500.000	Ka mundësi zgjerimi si në zënien direkt nga deti edhe nëpërmjet fermave për prodhim e tregtim. Është një aktivitet që sjell rritjen e punësimit dhe të ardhurave e, si rezultat, ndikon në treguesit 1, 2, 3 dhe 6.
		Projekte pilot në një fermë për prodhim dhe tregtim	2005 - 2006	KQ, OJF, Donatorët, Min. e Bujqësisë	600.000	
		Rritje e interesit për peshkimin	2005 - 2006	KQ, OJF, Donatorët, Min. e Bujqësisë	100,000	

Synimi 1.2. Zhvillimi i infrastrukturës duke përmirësuar rrugët, sistemimin e rrjetit të ujit të pijshëm, sistemimin e rrjetit kullues të kanalizimeve (në veçanti sistemimi i lumit Drin), vënia në punë e hidrovoreve, furnizimi me energji elektrike, me vëmendjen kryesore që deri në 2015 të përgjysmohet përqindja e njerëzve që nuk kanë mundësi të përdorin ujin e pijshëm sipas standardeve të sigurisë, si dhe eliminimi i përmbetjeve.

Problemi	Projekti	Përshkrimi	Periudha kohore	Partnerët potenciale	Shpenz (Euro)	Efekti
Menaxhimi i dobët i furnizimit me ujë	Asistencë teknike për kompanitë e ujit dhe autoritetet vendore	Trajnime për menaxhimin e ujit me autoritetet e qarkut dhe me organet përkatëse	2004 - 2006	KQ, OJF, Donatorët	9.000	Nëpërmjet përmirësimit të menaxhimit të furnizimit me ujë në mënyrë efçente dhe të sigurt ndikohet pozitivisht në treguesit 3,4,5 dhe 6
Menaxhimi i infrastrukturës ujësjellëse	Studim mbi rehabilitimin e rrjetit ekzistues dhe ngritja e rrjetit të ri	Rikonstruksion i rrjetit ekzistues dhe ngritja e rrjetit të ri aty ku mungon	2005 - 2009	KQ, OJF, Autoritetet vendore Donatorët, Autoritete të interesuara drejtpërdrejt, MRr.TT	3.000.000	Rritet nr. i familjeve me ujë të pijshëm, ulet në minimum mundësia e ndotjes, si rezultat ndikohet në treguesit 1, 4, 5 dhe 6
Infrastruktura e keqe rrugore	Studime për rehabilitimin e rrugëve rurale	Mbështetje për projektim dhe ndërtimin e rrugëve të reja dhe rikonstruksionin e rrugëve të vjetra nën përgjegjësinë e qarkut	2005 - 2009	KQ, OJF, Donatorët QSH, FSHZH	4.000.000	Mirëmbajtja e rrugëve dhe ndërtimi i rrugëve të reja do të rrisin të ardhurat nëpërmjet rritjes së tregtisë, shpenzimeve me të ulëta të import-eksportit, duke ndikuar pozitivisht tek treguesit 1,2,3 dhe 6
Sisteme ujitëse të dobëta	Projekt me bazë Organizatat me Bazë Komunitare për përmirësimin e sistemit të ujitjes	Përfshirja e qarkut të Lezhës në programet kombëtare të IRP, IFAD-3	2005 - 2008	KQ, OJF, Donatorët, Institucione kërkimore, QSH, Firma të huaja konsulente.	600.000	Përmirësimi në sistemin e ujitjes dhe përdorimi i teknologjive të reja do të rrisë efektivitetin dhe si rezultat do të çojë në rritjen e prodhimit bujqësor e blegtoral, do të ndikojë pozitivisht në treguesit 1, 2, 3 dhe 6
		Projekt për rehabilitimin e shpejtë të infrastrukturës	2005-2008	KQ, OJF, Donatorët QSH.	3.000.000	
		Eksperimentimi i teknologjive të reja në sistemin e ujitjes	2005-2008	KQ, OJF, Donatorët Institucione kërkimore, QSH, Firma të huaja konsulente.	1.000.000	

Problemi	Projekti	Përshkrimi	Periudha kohore	Partnerët potenciale	Shpenz (Euro)	Efekti
Sistem i dobët i kanalizimeve të ujërave të bardha dhe të zeza	Ngritja e rrjeteve të reja dhe rehabilitimi i rrjetit ekzistues	Reduktimi i rrjedhjeve nëpërmjet rehabilitimit të kanalizimeve dhe i ndërprerjes së ndërhyrjeve pa leje	2005 - 2006	Autoritetet vendore OJF, Donatorët	600.000	Ulje e shpenzimeve, zvoglimi i rrjedhjeve në rrjet, shkëputja e lidhjeve të paligjshme, eliminim i përmbytjeve e si rezultat rritje e të ardhurave, duke ndikuar pozitivisht në treguesit 1, 2, 3 dhe 6
		Instalimi i matësve të ujit dhe përfshirja e shoqërisë civile për të monitoruar përdorimin dhe për të siguruar shpenzimet për mirëmbajtjen e rrjetit	2005-2008	KQ, Autoritetet vendore donatorë, Autoritete të interesuara drejtpërdrejt, Min.Rr.T. dhe Turizmit	2.400.000	
		Rehabilitimi i rrjetit të ujërave të bardha: me prita malore, sistemimi i lumenjve Mat dhe Drin, rikonstruk- sion i kanaleve kulluese ekzistuese dhe hapja e atyre të reja aty ku është e domosdoshme, funksionimi i hidrovoreve	2005-2015	KQ, Autoritetet vendore donatore, Autoritete të interesuara drejtpërdrejt, QSH,		
Gjendje e rënduar energjetike dhe tension i ulët	Rehabilitimi dhe menaxhimi me projekte konkrete i rrjetit elektrik	Rehabilitimi i rrjeteve të energjisë	2005 - 2009	KESH KQ, OJF, Donatorët	5.000.000	Përmirësimi i furnizimit me energji elektrike do të ndikojë pozitivisht në të gjithë treguesit nëpërmjet ofrimit të energjisë ndërmarrjeve (treguesit 1, 2, 3) qendrave të pompimit të ujit dhe pastrimit të tij, si dhe të sistemit të kullimit (treguesit 3, 4, 5 dhe 6).
		Mbledhja e faturave të energjisë elektrike dhe instalimi i matësve	2005 - 2009	KESH KQ, OJF, Donatorët	2.200.000	

Synimi 1.3. Nxitja e zhvillimit të ndërmarrjeve industriale, të vogla dhe të mesme, së bashku me prodhimin vendas, duke krijuar kushte të favorshme për investime vendase dhe të huaja, si dhe mbështetja dhe krijimi i programeve të zhvillimit për NVM / mikro-ndërmarrjet, ku të punësohen sidomos të rinjtë.

Problemi	Projekti	Përshkrimi	Periudha kohore	Partnerët potenciale	Shpenz (Euro)	Efekti
Teknologji e dobët dhe e vjetëruar në përpunimin e agrobiznesit	Studime për mbështetjen me investime për përmirësimin e teknologjisë	Projekte pilote dhe trajnime për teknologjitë e reja bujqësore	2005 -2008	KQ, OJF, Donatorët, Dhoma e Tregtisë, QSH, Bizneset private, Universiteti Bujqësor Tiranë	900.000	Përmirësimi i teknologjisë ul shpenzimet në sektorin e bujqësisë, përmirëson efikasitetin dhe prodhimtarinë, rriten të ardhurat, duke ndikuar pozitivisht në treguesit 1, 2, 3, 6
Mungesë financimi për bizneset e përpunimit bujqësor	Ngritje e NVM të reja për përpunimin e produkteve bujqësore	Vendosja e sistemeve të kreditimit për NVM për zhvillimin e sektorit të përpunimit të produkteve bujqësore (frutave, vreshtarisë, ullirit, mishit)	2005 -2008	KQ, OJF, Donatorët, Dhoma e Tregtisë, Min. Bujqësisë, Bizneset private	5.000.000	Nëpërmjet ngritjes së NVM rritet mundësia për punësim më shumë sesa në kultivimin e tyre, nxitet rritja e prodhimit në ferma, rriten të ardhurat, duke ndikuar pozitivisht në treguesit 1, 2, 3 dhe 6
Niveli i ulët i shërbimeve turistike në zonat ku ai mund të zhvillohet (Shëngjin, Tale, Patok, Kroi i Bardhë, Liqenet e Lurës etj.)	Nxitja e turizmit malor, kulturor bregdetar dhe e peshkimit	Studim fizibiliteti për të analizuar pikat e mundshme turistike, strategjitë e marketingut, strategjitë dhe pengesat e përfshirjes së komunitetit në turizmin bregdetar, malor dhe kulturor	2005 -2006	KQ, OJF, Donatorët, Dhoma e Tregtisë.	150.000	Zhvillimi i turizmit bregdetar, malor, kulturor, etj. rrit mundësinë e punësimit të banorëve të qarkut, rriten niveli i jetesës, duke ndikuar pozitivisht në treguesit 1, 2 dhe 6
		Projekte pilot bazuar në të dhënat e studimit të fizibilitetit	2005 -2009	KQ, OJF, Donatorët, Dhoma e Tregtisë	900.000	
		Zgjerim i nismave për turizëm nëpërmjet NVM	2009 -2015	KQ, OJF, Donatorët, Dhoma e Tregtisë, Min.Rreg.T. dhe Turizmit	3.500.000	

Problemi	Projekti	Përshkrimi	Periudha kohore	Partnerët potenciale	Shpenz (Euro)	Efekti
Niveli i ulët i eksporteve bujqësore me qarqet e tjera të Shqipërisë dhe jashtë saj.	Studime për kërkesë-ofertën e tregut për produkte bujqësore nga Lezha	Studime për mundësinë e eksporteve për artikuj si: fruta, rrushi, vera, ulliri, mishi, bimët mjekësore etj.	2005 -2006	KQ, OJF, Donatorët, Dhoma e Tregtisë,	90.000	Këto studime do të shërbejnë si bazë për nisma të ardhshme për nxitjen e punësimit, duke ndikuar pozitivisht mbi treguesit 1, 2, 3 dhe 6
	Projekt certifikimi ISO	Ngritja e një sistemi për dhënien e certifikatave të cilësisë (ISO) për të mundësuar eksportimin e produkteve të qarkut Lezhë në BE (marketing + certifikata)	2005 -2009	Min. Bujqësisë, Drejt. e Bujqësisë së Qarkut, KQ, Sektori privat	350.000	Certifikimi i produkteve ISO do të mundësojë eksportimin e mallrave, duke nxitur prodhimin, duke rritur punësimin dhe të ardhurat nga hyrja në tregje më të mëdha. Ndikon pozitivisht në treguesit 1, 2, 3 dhe 6.
Braktisja e industrive të vogla të punimeve me dorë	Zhvillimi i industrisë tradicionale të punimeve me dorë	Studim i kërkesë-ofertës së tregut për eksportimin e punimeve me dorë	2005 -2006	OJF Dhoma e Tregtisë	80.000	Zhvillimi i industrisë artizanale do të krijojë mundësi punësimi dhe rritje të ardhurash, sidomos për gratë që angazhohen në aktivitete të tilla, ruan traditën kulturore të qarkut. Ndikon pozitivisht në treguesit 1, 2 dhe 6
		Projekte pilot për të testuar shitjen e produkteve sipas kërkesës	2005 -2007	OJF Dhoma e Tregtisë Donatorë	300.000	
		Mbështetje të plotë për këtë sektor me kredi më interes të ulët	2007 -2015	OJF Dhoma e Tregtisë Donatore, KQ, Min. Kulturës	850.000	
Mungesë e vendeve të tregimit	Projekt për rehabilitimin dhe rindërtimin e tregjeve	Rikonstruksioni i tregjeve ekzistuese (Lezhë, Kurbin)	2005 -2006	OJF Donatore Dhoma Tregtisë, Bizneset private, Komunitetet vendore	300.000	Rikonstruksioni i vendeve ekzistuese të tregimit dhe ndërtimi i të reja, sipas nevojës, do të nxisin rritjen e mikrobizneseve, duke ofruar më shumë pastërti dhe kulturë në shitjen e mallrave. Kjo do të rrisë punësimin dhe të ardhurat e do të ndikojë pozitivisht në treguesit 1, 2, 3 dhe 6
		Ndërtimi i tregjeve të reja (Mirditë)	2005 -2006	OJF, Donatorë, Dhoma e Tregtisë, Bizneset private, Komunitetet vendore	350.000	

OBJEKTIVI 2: Sigurimi i arsimit bazë për të gjithë

Analfabetizmi

Në qarkun tonë fenomeni i analfabetizmit nuk është problem shqetësues, pasi rajoni ynë njihet si një rajon arsimdashës. Të dhënat që jep INSTAT-i për vitin 2001 tregojnë një shifër prej 1.68% të popullsisë prezente analfabete. Kjo shifër është më e ulët, në qoftë se marrim parasysh rreth 26% të popullsisë së qarkut tonë, që nuk është regjistruar nga INSTAT, për shkak të emigrimit në vende të ndryshme të botës. Dihet që kjo popullsi e emigruar nuk është analfabete. Vëmendja kryesore te ne është kryerja e arsimit të detyrueshëm në 100% të djemve dhe vajzave.

Përmirësimi i infrastrukturës parashkollore dhe shkollore.

Për arsimin parashkollor ne synojmë:

1. Përmirësimin e objekteve parashkollore;
2. Shtimin dhe kualifikimin e personelit mësimdhënës;
3. Pajisjen e kopshteve me orëndi dhe mjete didaktike;
4. Zhdukja e shpërpjesëtimeve të mëdha që ekzistojnë mes zonave rurale dhe atyre urbane;
5. Krijimin e institucioneve të reja e të shumëllojshme, për të siguruar të drejtën e prindërve për të zgjedhur llojin e institucionit për fëmijët e tyre;
6. Rritjen e pjesëmarrjes dhe të kontributit të komunitetit dhe të biznesit në zgjidhjen e problemeve të arsimit parashkollor etj.

Cilësia e arsimit

E llogaritur me numrin e nxënësve për mësues, që te ne është si vijon:

Arsimi i detyrueshëm

Cikli i ulët - 23.07 nxënës me një mësues

Cikli i lartë - 16.73 nxënës me një mësues.

Arsimi i mesëm

19.40 nxënës me një mësues.

Në cilësinë e arsimit rëndësi të veçantë i kushtohet edhe përbërjes gjinore të popullsisë mësimdhënëse. Për qarkun tonë në arsimin e detyrueshëm 70.46% e totalit të mësuesve janë femra. Në arsimin e mesëm 55.77% e mësuesve janë femra.

Të dhënat për nivelin arsimor të mësuesve të pasqyruara në pjesën e parë të materialit janë optimiste përse u përket anës sasiore, por duhet thënë se niveli i dhënies dhe i përvetësimit të njohurive nuk është në standardet e kërkuara. Ndër faktorët që përcaktojnë çka thamë më sipër dhe bëhen pengesë serioze për mësimdhënien dhe mësimarrjen në shkollat tona ne do të rendisim:

1. Mungesën e infrastrukturës mësimore didaktike;
2. Motivimin financiar të mësuesve, që shprehet në politikën e dobët të pagave të hartuar nga qeveria shqiptare në sektorin e arsimit;
3. Mungesën e laboratorëve, kabinetëve, qendrave eksperimentale etj;
4. Mungesën e arsimit profesional, i cili është në hapat e para të tij në qarkun tonë dhe zhvillimi i tij do të çojë në rritjen e interesit të komunitetit për shkollën.

Infrastruktura

Përse u përket shkollave, duhet thënë se ka një shpërndarje në të gjithë rajonin të objekteve shkollore në të tre rrethet (shih pasqyrat në pjesën e analizës). Por duhet thënë se gjendja e tyre nuk është në nivelin e duhur. Shkollat kanë nevojë për rikonstruksione dhe mirëmbajtje, si dhe për t'u pajisur me mjetet e nevojshme didaktike për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe të përvetësimit nga nxënësit.

Nxënësit

Siç shihet nga statistikat e marra nga Drejtoria Rajonale e arsimit, kemi një përqindje të mirë të nxënësve që mbarojnë klasën e tetë dhe regjistrohen në shkollën e mesme, ku, në nivel qarku, ky regjistrim është në masën 63.97%. Rrethi i Lezhës është me 69.58%, Kurbini 60.55% dhe Mirdita 58.02%. Edhe përse u përket problemeve gjinore, ka një shifër të kënaqshme për ndjekjen e shkollës së mesme nga femrat - 51.44% e nxënësve në shkollat e mesme janë femra.

Prioritetet Strategjike

SKZHES dhe Kornizat Kombëtare	OZHM	BE	Qarku i Lezhës
<p>1. 100% regjistrim në arsimin fillor.</p> <p>2. 90% regjistrim në arsimin e mesëm dhe jo më pak se 13.5 vjet arsim për nxënës .</p>	<p>100% e djemve dhe e vajzave të mbarojnë arsimin e detyrueshëm fillor.</p> <p>2. Zbatimi i masave për të siguruar përmirësimin</p>	<p>1. Rritja e nivelit të arsimit të përgjithshëm, arsimit të lartë, formimit profesional dhe promovimi i bashkëpunimit të të rinjve.</p> <p>2. Sigurimi i infrastrukturës së nevojshme për zbatimin e standardeve të larta në të gjitha nivelet e arsimit.</p> <p>3. Përmirësimi i frekuentimit të shkollës në arsimin e detyruar shkollor.</p> <p>4. Ekuilibrimi i kërkesës dhe ofertës nëpërmjet konsolidimit të burimeve njerëzore dhe teknike.</p> <p>5. Riorganizimi i formimit profesional për të plotësuar kërkesat e tregut .</p>	<p>1. 100% e djemve dhe vajzave të mbarojnë arsimin fillor dhe një minimum 13.5 vjet arsim për nxënës deri në 2015</p> <p>2. Përmirësimi i infrastrukturës parashkollore dhe shkollore.</p> <p>3. Deri në vitin 2015 85% e nxënësve që hyjnë në klasë të parë të kenë arsimin parashkollor.</p> <p>4. Deri në vitin 2015 90% e nxënësve të mbarojnë arsimin e detyrueshëm dhe të ndjekin arsimin e mesëm.</p> <p>5. Tërheqja e nxënësve në arsimin e mesëm profesional, deri në vitin 2015 rreth 50% e nxënësve të arsimit të mesëm të jenë me arsim profesional.</p> <p>6. Rritja e cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet kualifikimit të vazhdueshëm të mësuesve .</p>

Synimet e Qarkut

- 2.1 Shtirirja e arsimit parashkollor në të gjithë rajonin;
- 2.2 Ndjekja nga 100% e djemve dhe e vajzave të arsimit të detyrueshëm dhe 90% e atyre që mbarojnë arsimin e detyrueshëm të ndjekin arsimin e mesëm;
- 2.3 Përmirësimi i infrastrukturës shkollore nëpërmjet ndërtimit të shkollave të reja, veçanërisht në zonat e mbipopulluara urbane sipas nevojave dhe mirëmbajtja e atyre ekzistuese në të gjitha komunat/bashkitë;
- 2.4 Rritja e kualifikimit të mësuesve;
- 2.5 Nxitja e zhvillimit të arsimit profesional.

Treguesit

1. Shkalla e analfabetizmit

Megjithëse të dhënat statistikore të INSTAT-it për vitin 2001 tregojnë se alfabetizimi në Lezhë kap shifrën 98.2%, pra, njerëzit alfabetë të regjistruar janë në masën 1.68%, ne mendojmë se duhet bërë një rillogaritje sipas standardeve të BE-së. Gjatë llogaritjes duhet vlerësuar numri i nxënësve në moshën 15-vjeçare që kanë mangësi në lexim, matematikë dhe shkenca të tjera ekzakte. Kërkesa e BE është që të ulët me 50% numri i 15-vjeçarëve që paraqesin këto mangësi.

2. Frekuentimi i arsimit parashkollor

Mendojmë se është një tregues specifik, i cili pasqyron në mënyrë shumë të qartë parapërgatitjen e fëmijëve për përvetësimin e programit në arsimin e detyrueshëm.

3. Raporti nxënës-mësues në arsimin e mesëm

Mesatarja e BE-së është 15.6 nxënës për mësues në shkollat e mesme. Qarku i Lezhës ka një mesatare prej 19.4 nxënës për mësues. Kjo është një mesatare e kënaqshme, por, meqenëse kërkojmë shtimin e nxënësve, që do të ndjekin arsimin e mesëm, atëherë duhet rritur edhe numri i mësuesve.

4. Niveli i arsimit të mësuesve

Ky tregues përveç përqindjes së mësuesve të arsimit të detyrueshëm me shkollë të lartë, duhet të synojmë që këta mësues të kualifikohen vazhdimisht për rritjen e nivelit të mësimdhënies sipas kërkesave të kohës.

Treguesit aktualë dhe të parashikuar

Synimi	Treguesit	Mesatarja Kombëtare e Shqipërisë (në %)	Baza e qarkut të Lezhës (në %)	2006	2009	2012	2015	Mes. BE-së nga Eurostat
1,2,3,4,5	1.Shkalla e analfabetizmit (% e popullsisë)	15,3 % (2002)	1,68 % (2001 INSTAT)	1,5 %	1,4 %	1 %	0,8 %	1.54 % (1998)
1,2,3,5	2. Frekuentimi i arsimit parashkollor	s'ka	54,5	60	65	75	85	s'ka
1,2,3,5	3. Frekuentimi i arsimit të mesëm në zonat rurale dhe urbane	s'ka	63,97	65	72	80	90	s'ka
1,4	4. Raporti nxënës/mësues në shkollat e mesme	s'ka	19,4 (DA 2004)	19.4	19	17	16	15,6
4	5. Niveli i arsimit të mësuesve në arsimin e detyrueshëm % e mësuesve me diplomë	s'ka	90,6	91	92	93	95	s'ka

Programi i zhvillimit

Synimi 1: Shtrirja e arsimit parashkollor në të gjithë rajonin.

Ky synim ka për qëllim të rrisë kontingjentin e fëmijëve që shkojnë në klasën e parë, të aftë për të përvetësuar në mënyrë cilësore programin mësimor.

Problemi	Projekti	Përshkrimi	Periudha kohore	Partnerët e mundshëm	Kostot (në Euro)	Efekt
Niveli i ulët i frekuentimit të arsimit parashkollor	Përmirësimi i infrastrukturës parashkollore	Rikonstruksioni i objekteve ekzistuese për t'i vënë në efikasitet dhe për të tërhequr fëmijët në këto mjedise	2005-2007	MPV Drejtoria Arsimore Këshilli i Qarkut Bashkitë dhe Komunitet Biznesi	450.000	Ndjekja e arsimit parashkollor nga fëmijët në masën 85%, rrit aftësinë e përvetësimit të programeve mësimore në shkolla. Kjo ndikon direkt në treguesin 2 dhe indirekt në treguesin 1
		Pajisja me orë dhe mjete didaktike për të lehtësuar përvetësimin e koncepteve dhe të programeve mësimore nga fëmijët.	2005-2007	MPV Drejtoria Arsimore Bashkitë dhe Komunitet	25.000	Fëmijët ndjehen më të predispozuar për të ndjekur arsimin parashkollor. Edukatorët e kanë më të lehtë punën me ta. Kjo ndikon direkt në treguesin 2 dhe indirekt në treguesin 1.
	Kualifikimi i personelit të arsimit parashkollor.	Trajnimi i edukatoreve dhe njohja e vazhdueshme e tyre me metodat bashkëkohore të mësimdhënies. Futja e koncepteve të reja në marrëdhënie me fëmijët.	2005-2009	MPV M.A. Drejtoria Arsimore Këshilli i Qarkut OJF-të	50.000	Përmirësohet ndjeshëm bashkëpunimi edukator-prindër-fëmijë. Fëmijët përvetësojnë më shpejt dhe më mirë programin mësimor parashkollor. Kjo ndikon indirekt në treguesin 1.

Synimi 2. Ndjekja 100% nga djemtë dhe vajzat të arsimit të detyrueshëm dhe 90% e atyre që mbarojnë këtë arsim të ndjekin arsimin e mesëm deri në 2015.

Ky synim ka për qëllim uljen e nivelit të braktisjes së shkollës dhe zbatimin e objektivit të SEKZH që kërkon një nivel arsimit jo më pak se 13.5 vjet për nxënës.

Problemi	Projekti	Përshkrimi	Përiudha kohore	Partnerët e mundshëm	Kostot (në Euro)	Efekt
Nivel jo i pranueshëm i ndjekjes së arsimit të mesëm.	Evidencimi i plotë dhe i saktë i nivelit të braktisjes në shkolla	Ngritja e një sistemi monitorues për vënien në kontroll të frekuentimit të shkollës nga nxënësit.	2005-2006	Drejtoria Arsimore Bashkitë/ komunat Organizatat ndërkombëtare Familjet Mësuesit	40.000	Do të mundësohet identifikimi i plotë i nxënësve që nuk ndjekin shkollën dhe të merren masat e duhura për përmirësimin e situatës. Kjo ndikon direkt në treguesin 1 dhe 3.
	Përmirësimi i programit arsimor, duke përfshirë aktivitete argëtuese	Shtimi i aktiviteteve kulturoro-artistike dhe sportive	2005-2007	Drejtoria Arsimore Këshilli i Qarkut OJF-të Mësues-prindër-nxënës	70.000	Rritet interesi për frekuentimin e shkollës, duke ndikuar direkt në treguesin 3.
		Blerja e bazës materiale dhe pajisjeve të duhura për këtë projekt. Përgatitja e stafit mësimdhënës	2006-2008	Drejtoria Arsimore Këshilli i Qarkut OJF-të Biznesi	450.000	
	Ndihmë për familjet e varfëra.	Evidencimi dhe dhënia e granteve për familjet e varfëra për punësimin e tyre dhe lehtësimin e vështirësive ekonomike	2005-2010	Qeveria, Drejtoria arsimore, Zyra e punësimit, Këshilli i Qarkut, biznesi.	500.000	Zbutja e varfërisë ndikon në rritjen e frekuentimit të shkollës nga nxënësit duke ndikuar direkt mbi treguesin 3.

Synimi 3. Përmirësimi i infrastrukturës shkollore nëpërmjet ndërtimit të shkollave të reja veçanërisht në zonat e mbipoplluara urbane sipas nevojave dhe mirëmbajtja e atyre ekzistuese në të gjitha komunat dhe bashkitë.

Problemi	Projekti	Përshkrimi	Periudha kohore	Partnerët e mundshëm	Kostot (në Euro)	Efekt
Infrastrukturë e papërshtatshme për t'iu përgjigjur kërkesave të mësimdhënies. Mungesë mjedisesh dhe baze didaktike.	Rehabilitimi dhe ndërtimi i shkollave të reja	Ndërtimi i shkollave të reja në zonat e mbipoplluara dhe furnizimi i shkollave me pajisje për ngrohje, biblioteka etj.	2005 - 2012	M.A Drejtoria Arsimore Këshilli i Qarkut OJF-të	5.000.000	Përmirësimi i infrastrukturës rrit nivelin e frekuentimit, përmirëson kushtet e mësimdhënies dhe mësimarrjes. Ndikon direkt në treguesit 1, 3, ,4.
	Vendosja e teknologjisë së informimit dhe komunikimit në shkolla	Paisje punë, laborator dhe infrastrukturë kompjuterike. Në shkollat e arsimit të detyrueshëm të ketë të paktën 1 laborator kompjuterash me lidhje në internet.	2005-2012	Drejtoria Arsimore OJF-të Këshilli i Qarkut Mësuesit-nxënësit Biznesi	1.000.000	Përmirësimi i mjeteve të informimit ndikon direkt në treguesit 1, 2, 3.

Synimi 4. Rritja e kualifikimit të mësuesve.

Ky synim ka për qëllim që mësuesit të përvetësojnë komponentet profesionale të mbështetura në standardet e përmbajtjes, në veçanti komponentet e reja që u nevojiten për të realizuar kurrikulat e reja dhe kërkesat e reja të kurrikulave ekzistuese.

Në kuadrin e rritjes cilësore të arsimit parauniversitar duhet të punohet për trajnimin dhe kualifikimin e mësuesve për përsosjen e modeleve dhe me metodologjinë efektive të mësimdhënies.

Problemi	Projekti	Përshkrimi	Periudha kohore	Partnerët e mundshëm	Kosoto (në Euro)	Efekt
Niveli i ulët i dhënies dhe përvetësimit të dijeve	Hartimi i programeve për zhvillimin profesional për mësuesit	Programe trajnuese për kualifikimin e mësuesve me metoda perëndimore.	2005-2010	Drejtoria Arsimore M.A, OJF-të KQ, Mësuesit	100.000	Kualifikimi i mësuesve rrit nivelin e përvetësimit të programeve mësimore nga nxënësit dhe ndikon direkt mbi treguesin 4 dhe indirekt mbi treguesin 1.
		Krijimi i qendrave të kualifikimit të mësuesve në çdo shkollë	2005-2010	Drejtoria Arsimore M.A, OJF-të, KQ, Mësuesit	150.000	
		Trajnimi dhe kualifikimi i specialistëve të Drejtorisë Arsimore dhe drejtuesve të shkollave.	2005-2010	Drejtoria Arsimore M.A, OJF-të, KQ, Mësuesit	20.000	
	Rritjes e motivimit financiar të edukatorëve	Mbështetja e politikave për rritjen e pagave për të tërhequr në punë mësues të kualifikuar	2005-2006	Qeveria Shqiptare Drejtoria Arsimore OJF-të, KQ, Mësuesit	50.000	Vendosja e pagave më të larta dhe sipas kualifikimeve nxit përkushtimin e mësuesve për një efektivitet më të madh në punën e tyre. Kjo ndikon në treguesin 1 dhe 4.

Synimi 5. Nxitja e zhvillimit të arsimit profesional

Synon pajisjen e nxënësve me kualifikime profesionale që u japin atyre shanse për punësim në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, duke u nisur nga nevoja në rritje e tregut të punës për punëtorë e teknikë sa më të kualifikuar.

Problemi	Projekti	Përshkrimi	Periudha kohore	Partnerët e mundshëm	Kostot (në Euro)	Efekti
Numri i ulët i shkollave të mesme teknike e profesionale	Projekt për mbështetjen e sistemit të shkollave të formimit profesional	Shtimi i shkollave të aftësimin të formimit profesional (AFP) sipas një studimi paraprak për nevojat e tregut të punës	2005-2007	INSTAT Drejtoria Arsimore Zyra Rajonale e Punës, Këshilli i Qarkut OJF-të Mësues-nxënës Biznesi	3.000.000	Ngritja e sistemit të shkollave të formimit profesional do të përputhë kërkesat e tregut të punës me interesat profesionale të nxënësve. Kjo do të ndikonte direkt në favor të treguesit 3
		Shpërndarje dhe mundësi të barabarta për shkollim në AFP në të gjithë qarkun me një program të detajuar	2005-2007	INSTAT Drejtoria Arsimore Zyra Rajonale e Punës, Këshilli i Qarkut OJF-të Mësues-nxënës Biznesi	70.000	
		Krijimi i një mekanizmi këshillimi dhe orientimi profesional të nxënësve që të ndihmojë ata në zgjedhjen e llojit të shkollimit profesional	2006-2008	INSTAT Drejtoria Arsimore Zyra Rajonale e Punës, Këshilli i Qarkut OJF-të Mësues-Nxënës Biznesi	30.000	
		Krijimi i një shkolle profesionale në qendër të qarkut për mësimin e teknologjive të informacionit, përdorimit të kompjuterave dhe internetit	2005-2010	INSTAT Drejtoria Arsimore Zyra Rajonale e Punës, Këshilli i Qarkut OJF-të Mësues-Nxënës Biznesi		

Objektivi 3: Nxitja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i rolit të gruas

Prioritetet Strategjike

SKZHES dhe Kornizat Kombëtare	OZHM	BE	Qarku i Lezhës
<p>Të drejta të barabarta në edukim dhe punësim.</p> <p>Përpyqjet për të adresuar barazinë gjinore kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në uljen e varfërisë në të gjitha shkallët e saj, si dhe në rritjen ekonomike. Veçanërisht gratë në zonat rurale përfaqësojnë një grup më të prekur nga varfëria. Si pjesë e axhendës për integrimin evropian, politikat dhe programet të fokusuara në sigurimin e barazisë gjinore janë të një rëndësie të veçantë</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Eliminimi i dallimeve gjinore në edukimin fillor dhe 8-vjeçar brenda 2005 dhe në të gjitha nivelet jo më vonë se 2015 2. Eliminimi i dallimeve gjinore në organet e zgjedhura dhe pozicionet vendimmarrëse në qeverisjen qendrore dhe vendore 	<p>Të drejta, mundësi dhe detyrime të barabarta, duke u fokusuar në arsyet strukturore të pabarazisë dhe nxitjen e përfaqësimit të barabartë të burrave dhe grave. Çështja gjinore duhet të jetë një pjesë e integruar e të gjithë bashkëpunimeve për zhvillim në Shqipëri. Gjithashtu, të krijohet legjislacioni për kushtet e punës dhe për mundësitë e përbashkëta të përfaqësimit për gratë dhe burrat.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Zhdukja mundësisht deri 2005 i dallimeve gjinore nga arsimiti 8-vjeçar në kalimin në atë të mesëm dhe deri 2015 në të gjithë nivelet e arsimit nëpërmjet forcimit të ligjit për sigurinë e jetës, rritjen ekonomike dhe përmirësimin e infrastrukturës. 2. Eliminimi i pabarazisë gjinore në organet e zgjedhura dhe ato vendimmarrëse në qeverisjen vendore dhe qendrore nëpërmjet rritjes së shkallës së edukimit dhe ndërgjegjësimit 3. Eliminimi i dhunës gjinore nëpërmjet forcimit të zbatimit të ligjit dhe rritjes ekonomike e punësimin.

Synimet e Qarkut:

- 3.1 Ulja e numrit të analfabetëve dhe e braktisjes së shkollës nga vajzat nëpërmjet forcimit të ligjit për sigurimin e jetës dhe përmirësimin të infrastrukturës deri në vitin 2006, si dhe sigurimi i arsimit të vajzave me probleme të veçanta sociale dhe fizike.
- 3.2 Ndjekja e të gjitha niveleve të arsimit pa dallime gjinore deri 2015.
- 3.3 Rritja e pavarësisë së gruas nëpërmjet punësimin dhe favorizimit të aktiviteteve të tyre deri 2015.
- 3.4 Rritja e pjesëmarrjes së gruas në organet vendimmarrëse qendrore dhe vendore nëpërmjet zbatimit të kritereve, ndërgjegjësimit dhe edukimit deri në vitin 2015.
- 3.5 Rehabilitimi i femrave të dhunuara dhe të trafikuar nëpërmjet ngritjes së qendrave të rehabilitimit dhe forcimit të ligjit.

Treguesit

1. Raporti djem/vajza në arsimin fillor, 8-vjeçar e të mesëm. Nga studimi i të dhënave të arsimit në aspektin gjinor, vihet re se raporti meshkuj/femra është në përpjesëtim të drejtë me numrin e popullsisë së qarkut. Shqetësues është numri i ulët i nxënësve që mbarojnë shkollën e mesme, duke përfshirë këtu edhe femrat në raport me nxënësit që mbarojnë shkollën 8-vjeçare, kryesisht në zonat rurale. Për thithjen e këtij kontingjenti nxënësish në arsimin e mesëm duhen përdorur politika nxitëse, si forcimi i ligjit për sigurimin e jetës dhe frekuentimin, përmirësimi i infrastrukturës së shkollës etj.

2. Përqindja e grave në sektorin jo-bujqësor

Meqenëse 52% e femrave të punësuar punojnë në sektorët jo bujqësorë, kjo tregon përpjekjet e tyre për t'u përshtatur me ndryshimet e ekonomisë së tregut për të mbijetuar dhe tendencat për punë më të kualifikuara, punë jo tradicionale, si në tregti, biznes, transport etj.

3. Përqindja e grave deputete

Megjithëse ka kontingjente të konsiderueshme femrash me nivele të larta arsimit, pjesëmarrja e tyre në jetën politike vendimmarrëse në parlament dhe në qeverisjen qendrore është e ulët dhe me prirje në rënie. Nga viti 1992-2004 qarku i Lezhës ka pasur vetëm një femër deputete në periudhën 1992-1996, ndërsa, aktualisht, nuk ka asnjë deputete dhe ministër.

4. Përqindja e grave në qeverisjen vendore

Megjithëse femrat janë gjysma e popullsisë dhe gjysma e forcave të punës, treguesi i pjesëmarrjes së tyre në qeverisjen vendore është shumë e ulët. Nuk ka asnjë femër kryetare bashkie, komune, këshilltare qarku dhe vetëm 4,3% janë femra këshilltare në bashki e komuna. Në administratën e qeverisjes vendore punojnë 31% femra dhe, kryesisht, në detyrën e specialistes së thjeshtë. Ky diskriminim tradicional vjen edhe për arsye të mungesës së një legjislacioni të zbatueshëm për parandalimin e tij.

Treguesit aktualë dhe të parashikuar

Synimi	Indikatorët	Mesatarja Kombëtare e Shqipërisë (në %)	Baza e qarkut të Lezhës (në %)	2006	2009	2012	2015	Mesatarja BE
3.1	Raporti djem/vajza në arsimin fillor, 8-vjeçar, të mesëm	s'ka	M 49 f 51 M 51 f 49 m48%f52%	50	50	50	50	s'ka
3.2	% e gruas në sektorin jo bujqësor	s'ka	Sektori jo bujqësor-48 Sektori bujqësor-52	50	50	48	45	45,3
3.3	% e grave deputete	5,7 % (2004)	0	5	10	20	20	24,3
3.4	% e grave në qeverisjen vendore	s'ka	17	25	30	40	50	s'ka
3.4	% e femrave në administratën vendore	s'ka	31	40	45	50	50	s'ka

Programi i Zhvillimit

Problemi	Projektet	Përshkrim i detajuar	Koha e realizimit	Partnerët potencialë	Kosto (e përafërta)	Efektet
1. Analfabetizmi i femrave dhe braktisja e shkollës	Evidencimi i analfabetëve dhe i atyre që braktisin shkollën Evidencimi i fëmijëve me nevoja veçanta	Hartimi i të dhënave për të gjithë qarkun, për këto fenomene Nxjerrja e rezultateve të ndërthurura, për të arritur në pasojat	2005	Pushteti vendor Shkollat Pindërit OJF-të	pa llogaritur	Masat e përmendura do të ndihmonin në njohjen e gjendjes, për të mundësuar më pas në uljen e analfabetizmit dhe në përmirësimin e nivelit arsimor
	1.2. Ngritja e qendrave për arsimim të diferencuar	Ngritja e qendrave veçanërisht për fëmijë të ngjuar dhe me mangësi fizike	2006	DA P. Vendore OJFtë	pa llogaritur	Duke organizuar mënyrë të tilla të kontaktit me nxënësit, rriten në mënyrë të ndjeshme mundësitë për të gjithë fëmijët dhe në veçanti ato femra për t'u integruar në shoqëri dhe arritur më pas nivele të tjera të zhvillimit
	1.3. Zbatimi i ligjit për arsimin e detyruar	Zbatimi i sanksioneve ligjore	2005	Drejt arsimore P. vendore Prindërit	pa llogaritur	Duke zbatuar masat administrative ligjore, do të krijohen mundësitë që ndjekja e shkollës të ishte më e lartë, duke çuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në shkollimin e të gjithë femrave që banojnë në qarkun tonë dhe duke eliminuar kështu mentalitetin dhe neglizhencën

Problemi	Projektet	Përshkrim i detajuar	Koha e realizimit	Partnerët potencialë	Kosto (e përafërta)	Efektet
2. Përqindja e ulët e femrave në arsimin e mesëm dhe atë të lartë	2.1. Forcimi i ligjit të sigurimit jetës 2.2. Trajnime ndërgjegjësimi	Pasiguria e jetës për vajzat dhe konceptet patriarkale zona rurale	2006-2015	Pushteti qendror dhe vendor Prindërit OJF-të Donatorët	pa llogaritur	Nëpërmjet këtyre masave, vetë komuniteti do të jetë më i ndërgjegjshëm për t'i dhënë mundësinë, sidomos femrave për të ndjekur të gjitha nivelet e arsimit, duke rritur në mënyrë të ndjeshme rolin e femrës në qarkun tonë dhe duke krijuar premiset për përmbushjen e të gjithë indikatorëve
	2. Rritja e kualifikimit për femrat	Duhen përmirsuar politikat arsimimit të femrave	2015	Shoqatat jo qeverit.+sh grave Ministria e Arsimit	pa llogaritur	Në bazë të gjithë nismave të ndërmarra deri më tani, kualifikimi i vazhdueshmë i femrave dhe nxitja e tyre me forma të ndryshme u ka dhënë dhe u jep mundësinë atyre të përfaqësohen dhe të bëhen nismëtare në arritjen e rezultateve pozitive në dobi të komunitetit të tyre
3. Përqindja e ulët e femrave në punë	3.1 Përmirësimi i politikave të punësimit të femrave	Krijimi i rregulloreve dhe ngritja e kriterëve të cilat nxisin punësimin e femrave	2005-2015	Partitë politike Parlamenti P. vendore Biznesi	pa llogaritur	Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe rregullator u siguron femrave mundësi të përbashkëta për punësim dhe rrit interesin e tyre për punësim, duke krijuar një bazë të gjerë për një zhvillim të qëndrueshëm që respekton çështjet gjinore. Në këtë mënyrë përmirësohet mirëqenia, rrit pavarsinë e femrave dhe forcohet pozicioni i tyre në familje

Problemi	Projektet	Përshkrim i detajuar	Koha e realizimit	Partnerët potencialë	Kosto (e përafërta)	Efektet
4. Përqindja e ulët e femrave në drejtim	Rritja e përfaqësimit të femrave në drejtim	Vendosja e kriterëve dhe rregulloreve në nivelet qendrore dhe vendore për përfshirjen e femrave në drejtim	2005	Pushteti qendror dhe vendor Shoqatat e grave	pa llogaritur	Përfshirja e femrave në drejtim, rrit shanset për krijimin e një administrate më demokratike, e cila do të eliminonjë çështjet gjinore dhe do të përmirësojë kushtet e bashkëpërfaqësimit për të gjithë.
5. Femra të dhunuara	Forcimi ligjit që mbrojnë të drejtat e grave	Zbatimi me përpikëri i rregulloreve dhe sanksioneve ligjore që mbrojnë femrat nga dhunimi	2005 - 2008	Pushteti qendror dhe ai vendor Biznesi OJF-të Donatorët	pa llogaritur	Duke zbatuar këto rregullore dhe masa do të krijonte mundësitë për femrat që të mbroheshin, si nga ana ligjore, por edhe nga ana financiare, duke marrë rol aktiv në familje dhe duke rritur mundësitë për të siguruar të ardhura e për të qenë aktive në komunitet e për të gjeneruar zhvillim
	Krijimi i kushteve për punësimin e tyre	Krijimi i kushteve për punësim dhe u kriterëve për të marrë në konsideratë këtë shtresë të popullsisë	2005 - 2015			
	Ngritja e qendrave të rehabilitimit dhe fuqizimi i rolit të shoqatave	Krijimi i qendrave të specializuara për t'i ardhur në ndihmë kësaj popullsie dhe fuqizimi nëpërmjet riaktivizimit të atyre ekzistuese dhe ngritjes së shoqatave të reja me kapacitete të mirëformuara	2005 - 2008			

Objektivi 4: Përmirësimi i kujdesit shëndetësor

Përmirësimi i infrastrukturës shëndetësore dhe i pajisjeve në qytete, fshatra dhe veçanërisht në zonat e largëta të qarkut të Lezhës (sidomos në rrethet e Mirditës) është një përparësi e lartë. Hapi i parë për përmirësimin e infrastrukturës dhe të pajisjeve në qytete dhe fshatra dhe veçanërisht në zonat e thella të qarkut, do të jetë kryerja e një analize të detajuar të objekteve shëndetësore në zonat rurale dhe urbane të qarkut të Lezhës. Ky proces duhet të kryhet nga ekspertë vendas, të zgjedhur, si brenda territorit të qarkut, dhe jashtë tij, për të nxjerrë në pah me saktësi:

- Shpenzimet për çdo ndërhyrje përsa i përket ndërtimit të godinave dhe furnizimit me pajisje.
- Rivendosjen ose rishpërndarjen e qendrave shëndetësore sipas gjendjes së re të dendësisë së popullsisë pas vitit 1990.

Punimet rehabilituese duhet të përqendrohen, jo vetëm në problemet teknike të infrastrukturës, por më e rëndësishme është zgjidhja e problemeve të sistemeve të ndryshme, siç është cilësia e sistemit sanitar të zonës përreth. Problemet e infrastrukturës duhet të shikohen edhe në lidhje me mundësinë për partneritete publike-private. Shërbimet shëndetësore, farmaceutike dhe dentare private janë prezente në qark dhe mund të mbështesin projekte bankare, duke përfshirë edhe favorizim sipas nevojës.

Me të mbaruar plani i veprimit mbi shpërndarjen dhe shpenzimet, një aspekt tjetër i rëndësishëm i nismave për përmirësimin e infrastrukturës shëndetësore do të ishte promovimi i programeve që shërbejnë për përmirësimin e qeverisjes në qark.

Puna duhet të fillojë me Drejtorinë e Programim Zhvillimit, në mënyrë që të përmirësohet aftësia e departamentit për të vëzhguar dhe koordinuar zbatimin, si dhe për të monitoruar rezultatet e ndërhyrjeve aktuale dhe të ardhshme në Sektorin e Shëndetësisë së qarkut.

Zhvillimi i një programi për uljen e vdekshmërisë së nënave (megjithëse ky nuk është problem në qarkun e Lezhës) dhe foshnjave është një përparësi tjetër për sektorin shëndetësor në qarkun e Lezhës. Shëndeti i nënës dhe fëmijës janë evidencuar si çështje zhvillimi të një rëndësie të veçantë për qarkun e Lezhës. Këtu përfshihen çështja e nivelit ekonomik dhe kulturor i familjes dhe i nënës, në veçanti, sidomos në zonat rurale, çështja e imunizimit, si dhe numri i madh i aborteve.

Prandaj është e domosdoshme që në zhvillimin e programimit sektorial mbi këtë çështje, të hartohet një kuadër programi afat-shkurtër dhe afat-mesëm për të siguruar që të përfshihen të gjitha aspektet e këtij problemi. Në kuadrin afat-shkurtër, programet duhet të përmbajnë:

- a. Programe edukimi për nënat me synim shëndetin e fëmijës.
- b. Programe edukimi për përdorimin e kontraceptivëve, si dhe për planifikimin familjar.
- c. Programe për imunizimin e fëmijëve në masën 100 % në zonat rurale.

Aktivitete të tjera si:

- 1- Fushata të ndërgjegjësimit publik (fletëpalosje, botime, postera, aktivitete të edukimit publik).
- 2- Takime me OJQ-të ose me grupe pune mbi çështje specifike që lidhen me shëndetin e nënës dhe fëmijës.

- 3- Certifikimi i ilaçeve nëpër farmaci, mund të ndërmerren në një periudhë afat-mesme.

Duhet të ndërmerren projekte afat-gjata që synojnë përmirësimin e shëndetit të nënës dhe fëmijës. Në këtë kuadër duhet të:

- 1- organizohen trajnime, kualifikime dhe specializime me vizion afat-gjatë.
- 2- përmirësohet infrastruktura rajonale e shëndetësisë me spitale, qendra shëndetësore dhe ambulanca.
- 3- pajisen me mjete dhe me aparatura bashkëkohore për të arritur standardet e BE-së.

Përparësi tjetër është rritja e aftësive dhe e numrit të personelit të kualifikuar mjekësor. Humbja e ekspertizës teknike dhe profesionale, që u shkaktua nga emigrimi, është një problem me pasoja të mëdha për qarkun e Lezhës.

Kjo dukuri është problematike në shumë qarqe të vendit, pasi ekspertët mjekësorë po largohen nga zonat e thella për në zonat me popullsi më të dendur dhe infrastrukturë më të zhvilluar.

Nga kjo lëvizje e këtij lloji kontingjenti këto zona të qarkut ngelen me mangësi në shërbimet profesionale mjekësore. Për të ulur këtë lëvizje, si dhe për të shtuar numrin e mjekëve të specializuar deri në masën që plotësojnë nevojat e banorëve duhet të krijohen programe nxitëse për të tërhequr mjekët dhe dentistët e rinj për të punuar në zonat e thella, sidomos në Mirditë, që është rrethi më problematik, ku kërkohet stimulimi financiar i këtyre mjekëve, si dhe kualifikimi i tyre sipas nevojave të popullatës.

Prioritetet Strategjike

SKZHES dhe Kornizat Kombëtare	OZHM	BE	Qarku i Lezhës
<p>1. Mundësi dhe barazi në shërbimet shëndetësore në të gjithë territorin e vendit, si dhe përmirësimi i cilësisë së tyre</p> <p>2. Përmirësimi i treguesve të shëndetësisë nëpërmjet ndërhyrjeve specifike në sektorin e shëndetësisë</p> <p>3. Rritja e mundësive të grave për kujdes shëndetësor</p> <p>4. Eliminimi i diskriminimit të vajzave në lidhje me trajtimin mjekësor (sidomos në zonat rurale)</p> <p>5. Eliminimi i trafikimit të femrave dhe ndihma për viktimat e dhunës</p>	<p>1. Ulja e vdekshmërisë foshnjore. Synimi për këtë objektivi është të ulët 2/3 e shkallës së vdekshmërisë së fëmijëve nën 5 vjeç</p> <p>2. Përmirësimi shëndetit të nënës. Synimi i këtij objektivi është të ulët 75% përqindjen e grave që vdesin gjatë lindjes</p> <p>3. Lufta kundër HIV/AIDS, malarjes dhe sëmundjeve të tjera. Synimi i këtij objektivi është të ndalojë përhapjen e HIV/AIDS, si dhe rastet e sëmundjeve të tjera të rrezikshme</p>	<p>1. Rritja e mjeteve financiare për këtë sektor</p> <p>2. Riorganizimi i shërbimeve shëndetësore</p> <p>3. Përmirësimi i infrastrukturës dhe i pajisjeve</p> <p>4. Promovimi i pjesëmarrjes së sektorit privat në ofrimin e shërbimeve shëndetësore.</p>	<p>1. Përmirësimi i infrastrukturës shëndetësore në qytete dhe fshatra, duke trajtuar në mënyrë më të veçantë zonat e thella të qarkut të Lezhës</p> <p>2. Ngritja e nivelit të njohurive profesionale të personelit shëndetësor, sidomos atij parësor</p> <p>3. Program gjithëpërfshirës zhvillimi në uljen e shkallës së vdekshmërisë foshnjore dhe amësore</p> <p>4. Shtrirja e shërbimeve të planifikimit familjar në zonat rurale dhe veçanërisht ato të thella. Përmirësimi i informacionit, edukimit dhe komunikimit mbi planifikimin familjar</p>

Synimet e Qarkut:

- 4.1 Përmirësimi i infrastrukturës shëndetësore dhe i pajisjeve në qytete, fshatra dhe veçanërisht në zonat e thella të qarkut të Lezhës;
- 4.2 Zhvillimi i programeve të plota për të ulur shkallën e vdekshmërisë së nënave dhe foshnjave;
- 4.3 Rritja e aftësive dhe e numrit të personelit të kualifikuar mjekësor dhe dentar në linjë me normat e BE-së

Treguesit

1. Shkalla e vdekshmërisë së fëmijëve 1-5 vjeç: Vdekshmëria e fëmijëve të moshës 1-5 vjeç është relativisht e lartë, sidomos në rrethin e Kurbin. Në këtë tregues një ndikim të madh kanë konsultoret e grave dhe të fëmijëve që në rrethin më problematik siç është Kurbin janë më të pakta, duke pasur parasysh numrin e banorëve dhe shtrirjen gjeografike të tij. Gjithashtu, në vdekshmërinë e fëmijëve në qarkun e Lezhës ndikojnë dhe niveli ekonomik, social dhe kulturor i familjes, por, në veçanti, i nënës.

2. Shkalla e vdekshmërisë foshnjore: Ky tregues së bashku me treguesin A janë përdorur dhe si një tregues i tërthortë për çrrënjosjen e varfërisë në këtë strategji. Për pjesën e shëndetësisë ky është një tregues i drejtpërdrejtë që nxjerr në pah kushtet dhe kujdesin shëndetësor (ambientet dhe infrastrukturën), shëndetin e nënës, aftësitë dhe kapacitetet e mjekëve dhe mundësinë e përfitimit nga kujdesi shëndetësor.

3. Shkalla e vdekshmërisë së nënës (për 1000 lindje): Vdekshmëria e nënës në qarkun e Lezhës nuk është shqetësuese. Kemi vetëm një rast në rrethin e Mirditës, në vitin 2001, pra, përveç 0,32/1000 lindje në vitin 2001 në shkallë qarku, në vitet tjera është 0/1000 lindje. Por duhet të kemi parasysh që statistikat në lidhje me këtë tregues mund të mos jenë të sakta, sepse mund të ketë dhe raste të paraportuara, të cilat ndikojnë, si në shkallën e vdekshmërisë së nënës, edhe në shkallën e vdekshmërisë së foshnjave.

4. Përqindja e fëmijëve njëvjeçarë të vaksinuar ndaj fruthit: Vaksinimi i fëmijëve njëvjeçarë në qarkun tonë i kalon 90% të mbulimit. Masat parandaluese për sëmundjet, sidomos vaksinimi në qarkun e Lezhës me gjithë përqindjen e lartë të mbulimit, ka ndryshim në varësi të zonës dhe vaksinës. Në zonat

e thella rurale sidomos të rretheve Mirditë dhe Kurbin mungon vaksinimi i plotë.

5. Përqindja e lindjeve të asistuara nga personeli mjekësor: Përqindja e lindjeve në institucion është e lartë dhe vëmë re një rritje të vazhdueshme nga viti në vit. Megjithatë, ka dhe shumë raste të lindjeve jashtë tij, por duhet theksuar se dhe në këto raste janë asistuar nga infermiere/mami.

6. Shërbimi dentar, rapoti dentist/1000 banorë: Në qarkun e Lezhës ekzistojnë një sërë klinikash dentare publike dhe private, gjithsesi numri i dentistëve në raport me popullsinë është shumë i vogël, për një popullsi prej 210.416 banorë ka vetëm 30 stomatologë, pra, 0.2 dentistë /1000 banorë. Kjo e dhënë tregon se jemi shumë larg standardeve të BE-së, që është 0.61 dentistë / 1000 banorë. Duhet theksuar se në zonat rurale shërbimi dentar është një problem në të tre rrethet e qarkut, sidomos në Kurbin dhe Mirditë.

7. Objektet shëndetësore dhe numri i mjekëve të përgjithshëm në qarkun e Lezhës: Ka vetëm 3 spitale në të gjithë qarkun, të shpërndarë nga 1 spital në secilin rreth. Kapaciteti i këtyre spitaleve është gjithsej 327 shtretër. Ka gjithsej 87 ambulanca, 139 konsultore fëmijësh/nënash, 61 qendra shëndetësore, 23 farmaci dhe 3 maternitetet, me një kapacitet prej 100 shtretërish gjithsej. Qarku i Lezhës ka një popullsi prej 210.416 banorësh, të cilëve u shërbejnë vetëm 68 mjekë të përgjithshëm dhe këta të shpërndarë në mënyrë jo të rregullt në raport me nevojat e popullatës për shërbim shëndetësor. Raporti mjek-pacientë në qark është 0.32 mjekë/1000 banorë, pra, raporti mjek/pacientë në qark bie nën standardet e BE-së, që është 1.3 mjekë/1000 banorë.

Treguesit aktualë dhe të parashikuar

Synimi	Treguesit	Mesatarja kombëtare e Shqipërisë	Niveli bazë i qarkut të Lezhës	2007	2011	2015	Mesatarje e BE-së (të dhëna nga Eurostat)
4.1, 4.2, 4.3	Shkalla e vdekshmërisë së fëmijëve 1-5 vjeç/1000 lindje	s'ka	2,5	2	1,7	1,2	s'ka
4.1, 4.2, 4.3	Shkalla e vdekshmërisë foshnjore /1000 lindje	20,5 (2000, MSH)	9,6	7,9	5,9	4,5	4,5
4.2, 4.3	Vdekshmëria e nënës /1000 lindje	22,69 (2001, OBSH)	0	0	0	0	5,1 (2000)
4.1, 4.3	Përqindja e vaksinimit ndaj fruthit/rubeolës	s'ka	>90 %	95 %	97 %	100 %	s'ka
4.1, 4.2	% e lindjeve të asistuara nga personel i kualifikuar	s'ka	>99 %	99,5 %	99,7 %	100 %	s'ka
4.1, 4.2	Raporti dentist/1000 banorë	0,411 (1998, OBSH)	0.2	0,35	0,47	0,61	0,61
4.1, 4.3	Mbulimi me mjekë të përgjithshëm/1000 banorë	s;ka	0.32	0,51	0,87	1,3	1,3

Program Zhvillimi

Synimi 3.1 Përmirësimi i infrastrukturës shëndetësore dhe i pajisjeve në qytet dhe fshat, veçanërisht në zonat e thella të qarkut të Lezhës.

Problemi	Projekti	Përshkrimi	Harku Kohor	Partnerët potencial	Kostot (në Euro)	Efekti
Mungesa e infrastrukturës dhe e pajisjeve të kujdesit shëndetësor	Analizë e shpenzimeve për ngritjen e infrastrukturës së kujdesit shëndetësor në qarkun e Lezhës	Një plan veprimi i detajuar për shpenzimet dhe për shpërndarjen e objekteve e të pajisjeve sipas nevojave në qark mbi bazën e statistikave për popullsinë dhe faktorët rrethues që ndikojnë.	2005-2006	KQ, QSH/MSH Donatorët Institucionet kërkimore	e pallogaritur	Vendosja në hartë e burimeve dhe e nevojave është hapi i parë për zhvillimin e një sistemi më të mirë shëndetësor për banorët e qarkut të Lezhës. Kështu, kjo do të ndikojë indirekt mbi të gjithë treguesit me anë të rekomandimeve të planit të tij.
	Përmirësimi i infrastrukturës së kujdesit shëndetësor	Ndërtim dhe rehabilitim i qendrave shëndetësore	2005-2009	KQ, QSH/MSH Donatorët		Infrastruktura më e mirë për objektet shëndetësore do të ndikojë pozitivisht mbi treguesit 1, 2 dhe 3
	Modernizimi & zëvendësimi i pajisjeve të kujdesit shëndetësor	Përmirësimi dhe zëvendësimi i pajisjeve mjekësore me vëmendje të veçantë ndaj zonave të thella të qarkut	2005-2009	KQ, QSH/MSH Donatorët		Pajisje më të mira dhe më të përshtatshme sidomos për disa zona të qarkut do të ndikojnë pozitivisht mbi treguesit 1, 2, 3 & 4 dhe indirekt mbi treguesit 5, 6 dhe 7
Mungesa e koordinimit në nivel vendor që mbikëqyr zbatimin dhe koordinimin e nismave për infrastrukturën shëndetësore	Program për zhvillimin e kapaciteteve të qeverisjes	Planifikim për zhvillimin e kapaciteteve për të pasur sukses në koordinimin e zbatimit dhe monitorimit të nismave për infrastrukturën shëndetësore	2005-2007	KQ, QSH/MSH Donatorët		Koordinimi më i mirë në sektorin shëndetësor mes autoriteteve vendore do të ndikojë pozitivisht mbi të 7 treguesit

Synimi 3.2: Zhvillimi i programeve të plota për të ulur shkallën e vdekshmërisë së nënave dhe foshnjave

Problemi	Projekti	Përshkrimi	Harku kohor	Partnerët Potencial	Kostot (në Euro)	Efektë
Mungesa e sigurisë së ushqimit që ndikon te nënat dhe fëmijët në rrezik	Program emergjent ushqimi për nënat dhe fëmijët	Ndihma në ushqime për fëmijët dhe gratë në rrezik, veçanërisht për ato që banojnë në zonat e thella rurale të Mirditës dhe Kurbinit	2005-2007	KQ, QSH/MSH Donatorët		Ky projekt emergjent do të ndikojë direkt mbi treguesit 1, 2 dhe 3
	Projekt Mikro-ushqyes	Program shumë sektorial për të nxitur ofrimin afat-shkurtër dhe përshtatjen afat-gjatë të ushqimeve të pasuruara me vitaminë dhe vlera ushqyese	2005-2007	KQ, QSH/MSH Donatorët Institucionet kërkimore		Ushqimi i përmirësuar me vlera ushqyese do të ndikojë mbi shëndetin e nënës dhe foshnjave, duke ndikuar kështu direkt mbi treguesit 2 dhe 3
Sëmundjet e fëmijërisë	Program imunizimi për fëmijët	Fushata imunizimi për fëmijët në rrezik	2005-2008	QSH Donatorët OJF-të		Fëmijët që nuk janë vaksinuar ndaj fruth/rubeolës, poliometitit etj., do të përfitojnë nga ky program, duke ndikuar kështu direkt mbi treguesin 4
	Certifikimi i ilaçeve	Krijimi i një sistemi për certifikimin e origjinalitetit të ilaçeve farmaceutike nëpër farmaci	2005-2008	QSH Qarku Donatorët Institucionet kërkimore		Kontrolli i cilësisë së ilaçeve do të ndikojë mbi treguesit 1, 2 dhe 3

Problemi	Projekti	Përshkrimi	Harku kohor	Partnerët Potencial	Kostot (në Euro)	Efekti
Mungesa e informimit mbi problemet e shëndetit të nënës dhe fëmijës	Fushata ndërgjegjëse	Fushatë e përzier mediatike për ndërgjegjësim (publikime, fletëpalosje, postera, ngjarje publike) mbi problemet e shëndetit të nënës dhe fëmijës. Fushata do të përdorë hapësira me qira (si ato të mjediseve sportive) për të përhapur mesazhe mbi higjienën.	2005-2006	OJF-të QK, QSH	e pallogaritur	Përmirësimi i shpërndarjes së informacionit mbi problemet shëndetësore të nënës dhe fëmijës do të ndikojë mbi treguesit 1, 2 dhe 3
	Forume/Grupe pune të OJF-ve	Ngritja e OJF-ve dhe i grupeve të veprimit shumësektorialë, me qëllim “rrahjen e ideve”, problemeve specifike dhe zgjidhjet e problemeve të nënave, fëmijëve dhe zbatimi i tyre.	2005-2006	Qarku OJF-të, Donatorët		Partneritetet në nivel qarku mes OJF-ve, organizatave të shoqërisë civile, komunitetet etj. mund të çojnë në gjetjen e zgjidhjeve të reja dhe vendore për problemet që lidhen me shëndetin e nënës dhe fëmijës, duke ndikuar kështu direkt mbi treguesit 1, 2 dhe 3
Mungesë aftësie monitoruese brenda Drejtorisë së Programimit dhe Zhvillimit	Zhvillimi i kapaciteteve të Qeverisjes së qarkut	Trajnimi dhe zhvillimi i një sistemi për përmirësimin e monitorimit të projekteve për shëndetin e nënës dhe fëmijës	2005-2010	QSH, Donatorët, Qarku		Një sistem i përmirësuar monitorues dhe i mbledhjes së të dhënave do të përmirësojë formulimin e ndërhyrjeve dhe të ndikojë kështu direkt mbi treguesin 1, 2 dhe 3
Shëndeti riprodhues dhe shërbime shëndetësore për planifikim familjar të pamjaftueshëm/ të papërshtatshëm	Shëndeti riprodhues, planifikimi familjar dhe programi STI	Trajnim i personelit mjekësor, duke theksuar nevojën për të ofruar shërbime cilësore për të nxitur kërkesën	2005-2007	QSH, Donatorët, Qarku MAGs		Rehabilitimi i shërbimeve shëndetësore në fushën e planifikimit familjar dhe gjinekologjisë, në kombinim me një fushatë publike ndërgjegjëse, do të ndikojë drejtpërdrejt mbi treguesin 3

Synimi 3.3: Rritja e aftësive dhe e numrit të personelit të kualifikuar mjekësor dhe dentar në linjë me normat e BE-së

Problemi	Projekti	Përshkrimi	Harku kohor	Partnerë Potencialë	Kostot (në Euro)	Efekti
Mungesa e personelit të kualifikuar mjekësor	Programe nxitëse për mjekët e rinj	Të sapodiplomuarit në UT në mjekësi dhe stomatologji do të marrin stimuj monetarë apo të tjerë për të punuar në zonat e thella të qarkut të Lezhës	2005-2009	Donatorë, QSH, Institucionet akademike	e pallogaritur	Rritja e numrit të mjekëve dhe dentistëve do të ndikojë direkt mbi treguesit 6 dhe 7
	Mekanizma nxitës për personelin mjekësor vendor	Nxitet nga ana financiare personeli mjekësor, që qëndron në rajon dhe që është kualifikuar nëpërmjet programeve të “binjakëzimit”	2005-2010	QSH Qarku		Një mekanizëm nxitës për mbajtjen e profesionistëve të trajnuar lokalë do të ndikojë mbi treguesit 6 dhe 7, si dhe mbi treguesit 1, 2 dhe 3 nëpërmjet rritjes së numrit të kapacitetit të personelit mjekësor, që vepron në rajon.
	Program binjakëzimi	Rotacione afatshkurtëra deri afatmesme në qarkun e Lezhës të realizuara nga pjesëmarrësit në programin e binjakëzimit dhe anasjelltas	2005-2010	Donatorë, QSH, Institucionet akademike		Programet e binjakëzimit me Universitetet europiane dhe institutet kualifikuese do të ndikojnë pozitivisht mbi treguesit 6 dhe 7, duke tërhequr profesionistë të rinj të këtyre praktikave në qark, si dhe ndikon indirekt mbi treguesit 1, 2 dhe 3 nëpërmjet rritjes së kapacitetiteve të mjekëve dhe dentistëve që marrin pjesë në projekt.
		Organizimi i një sërë seminaresh për mjekët dhe dentistët e qarkut të Lezhës mbi temat dhe teknikat mjekësore përkatëse, të dhëna nga mjekët e BE-së.	2005-2009	Donatorë, QSH, Institucionet akademike		

Objektivi 5: Garantimi i qëndrueshmërisë së mjedisit

Llojet e rrezikuara

Rajoni i Lezhës, me gjithë territorin e tij të vogël (1462 km²), është një vend me florë e faunë të pasur. Larmia e klimës, topografisë, gjeologjisë, gjeomorfologjisë formon kushte për një larmi habitatesh, flore e faune. Falë daljes në detin Adriatik, rajoni i Lezhës dallohet për një biodiversitet të pasur detar e bregdetar. Brenda territorit të saj vendosen pothuajse të gjitha habitatet që i përkasin vendit tonë, si: pyje (pyje gjethegjërë, halorë dhe të përzier, pyje gjysmë natyrore, pyje të mbjellë), shkurre dhe shkurreta (gjetherënëse dhe gjithnjë të gjelbërta ose makia), sipërfaqe me bimësi barishtore (kullota) dhe kënetore, përranj dhe lumenj, liqene, rezervuarë, kanale, laguna bregdetare e kënetat të kripura, dunat ranore, grykëderdhjet (deltat lumore), vegjetacioni hidrofil etj.

Lagunat bregdetare të Kune - Vainit e Patokut, janë nga më të spikaturat për shpendët dimëruar të ujit. Llojet globalisht të rrezikuara, si breshka e Mesdheut *Caretta caretta*, dhe foka e Mesdheut *Monachus monachus*, kanë një pjesë të arealit të tyre në këtë rajon, ndërsa pelikani kaçurrel *Pelecanus crispus* konsiderohet i rastësishëm ose i zhdukur (prezent deri në vitin 1994). Pothuajse në të gjithë zonën malore takohet ujku (*Canis lupus*), i cili është zhdukur në pjesën më të madhe të Europës. Në Bjeshkët e Oroshit dhe në malin e Skënderbeut takohet një tjetër gjitar i madh, ariu (*Ursus arctos*), i cili ka pasur të njëjtin fat në Europë, si dhe ujku.

Politikat dhe praktikatat ekzistuese të zhvillimit edhe në këtë rajon kanë pasur dhe akoma kanë një ndikim në ekosistemet natyrore e gjysmë natyrore, duke bërë që mjaft bimë e kafshë të jenë zhdukur, të jenë në zhdukje e sipër apo të rralla e të keqësuar.

Kushtet e reja të krijuara nga fillimet e zhvillimit të ekonomisë së tregut të lirë diktojnë akoma më shumë njohjen e gjendjes aktuale, në të cilën ndodhen taksonet bimore e shtazore, për identifikimin e llojeve të rrezikuara dhe për marrjen e masave mbrojtëse.

Pasqyrë e numrit të llojeve të rrezikuara për rajonin e Lezhës (Lezhë, Kurbini, Mirditë) (Sipas Librit të Kuq, botim i vitit 1997)¹.

Legjislacioni mjedisor

Legjislacioni mjedisor, si pjesë përbërëse e administrimit të mjedisit, përbën një parakusht për zhvillimin e qëndrueshëm, në përgjithësi, dhe për mbrojtjen e mjedisit, në veçanti. Plotësimi i kuadrit ligjor përkatës konsiderohet një instrument i rëndësishëm për zbatimin e politikave mjedisore.

Pas vitit 1991 u bënë përpjekje që mbrojtja e mjedisit të jetë pjesë përbërëse e politikave të zhvillimit të vendit, duke filluar, kështu, krijimi i një kuadri të ri ligjor, proces i cili është në vazhdim.

Në nene të veçanta të Kushtetutës janë sanksionuar synimet e shtetit “për një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm”, për “shfrytëzimin racional të pyjeve, ujërave, kullotave dhe burimeve të tjera natyrore mbi bazën e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm”, si dhe për të drejtën që ka kushdo që “të informohet për gjendjen e mjedisit dhe për mbrojtjen e tij”.

Ligji Nr 7664 datë 21.01. 1993 “Për mbrojtjen e mjedisit” konsiderohet ligji bazë i mjedisit, të cilit i janë bërë amendamente me Ligjin Nr 8364, datë 2.7.1998, duke sjellë përmirësime të karakterit institucional e organizativ².

Në kreun e tretë të këtij Ligji, “Lejet (licensat) për veprimtaritë që ndikojnë ndaj mjedisit” përcaktohen veprimtaritë për të cilat jepet leja, si dhe organet që i japin ato. Cilido që, në një mënyrë ose në një tjetër me aktivitetin e tij do të ndërhyjë në mjedis, duhet të respektojë rregulla dhe detyrime të caktuara, të cilat kanë për qëllim mbrojtjen e mjedisit.

Në kreun e pestë të këtij Ligji, për “Detyrat dhe të drejtat e organeve qendrore dhe lokale për mjedisin”, në Nenin 42 përcaktohet se:

“Këshillat e komunave, bashkive ose rretheve dhe njësitë përkatëse administrative, ku veprojnë, kanë këto të drejta dhe detyra kryesore:

- i) të ndjekin zbatimin e ligjeve dhe të akteve të Këshillit të Ministrave për problemet e mbrojtjes së mjedisit; ii) të marrin masa dhe të sigurojnë mbrojtjen dhe ripërtëritjen e

Taksonet	Ex	E	V	R	I	K*	K	T	C	Shuma
Bimë										
Kërpudha	-	2	1	1	-	-	-	-	-	4
Bimë detare	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Bimë të larta	-	1	8	3	-	-	1	-	-	13
Bimë Total	-	3	9	4	-	-	1	-	-	17
Shqipëria	3	41	29	108	1	6	7	5	-	200
Shoqërimet bimore	1	5	10	8	-	-	-	-	-	27
Shqipëria	2	24	30	43	1	1	1	1	1	104

Tab.1 - Numri i llojeve të rrezikuara për Qarkun e Lezhës (Burimi: Libri i Kuq 1997)

¹ Libri i Kuq përdor shkallën e rrezikimit të llojeve bimore e shtazore sipas përcaktimeve të IUCN 1994 (Union Botëror për Ruajtjen e Natyrës), i cili kategorizon: Lloje /takson i zhdukur (Ex), në rrezik zhdukjeje (E), i keqësuar (V), i rrallë (R), me status të papërcaktuar (I), nën shqyrtim (K*), i njohur në mënyrë të pamjaftueshme (K), i shqetësuar (T), kandidat (C).

Taksonet	Ex	E	V	R	I	K'	K	T	C	Shuma
Kafshë										
Molusqe të tokës e të ujërave të ëmbla		2	-	1	-	-	4	-	-	7
Molusqe detare		2	-	8	3	-	5	-	-	18
Krustace	-	1	1	21	-	-	1	2	-	26
Insekte	-	-	4	15	1	-	1	-	-	21
Ekinodermate	-	-	-	6	1	-	-	-	-	7
Peshq	-	3	1	4	-	-	3	-	-	11
Amfibë	-	-	-	-	-	-	4	-2	1	7
Reptilë	-	-	-	13	-	-	9	1	-	23
Shpendë	2	2	9	13	6	-	10	2	-	44
Gjitarë	-	3	2	2	-	-	-	-	-	7

Kafshë total										
Rajoni Lezhë	2	13	17	83	11	4	33	7	1	17
Shqipëria	7	45	77	258	46	25	60	10	4	532

Gjithsej Rajoni	3	21	39	95	11	4	34	7	1	215
Shqipëria	12	110	136	409	48	32	68	16	5	836

Tab.2 - Llojet e të listuara në Librin e Kuq të hasura në Qarkun e Lezhës
(Burimi: ARM Lezhë, 2004)

Taksonet	Lezhë	Kurbini	Mirditë	Shuma Rajoni	Shqipëria
Bimë					
Kërpudha	-	-	4	4	45
Bimë detare	-	-	-	-	25
Bimë të larta	10	2	2	13	130
Bimë Total	10	2	6	17	200
Shoqërimet bimore	21	20	3	27	104
Kafshë					
Molusqe të tokës e ujërave të ëmbla	3	1	2	7	41
Molusqe detare	18	-	-	18	46
Krustace	26	-	-	26	59
Insekte	16	6	11	21	121
Ekinodermate	7	-	-	7	17
Peshq	9	5	1	11	60
Amfibë	6	4	5	7	15
Reptilë	23	12	12	23	36
Shpendë	39	6	4	44	104
Gjitarë	5	3	4	7	33
Kafshë total	152	37	48	171	532
Gjithsej bimë + kafshë	183	59	44	215	836

Tab.3 - Llojet e të listuara në Librin e Kuq të hasura në Qarkun e Lezhës
(Burimi: ARM Lezhë, 2004)

mjedisit; të hartojnë dhe të publikojnë programet dhe masat e tyre të mbrojtjes së mjedisit të bashkërenduara me organet kompetente të specializuara për mjedisin; iii) të informojnë publikun për gjendjen e mjedisit dhe për veprimtaritë lokale të ndërmarra, subjekt i vlerësimit të ndikimit ndaj mjedisit; iv) të ushtrojnë kontroll për gjendjen e mjedisit sipas dispozitave të këtij ligji; v) të administrojnë dhe të shpërndajnë fondet lokale të mjedisit të krijuara sipas këtij ligji; të caktojnë vendet e depozitimit dhe të përpunimit të mbeturinave të prodhimit dhe të popullatës në mënyrë që ato të mos dëmtojnë mjedisin.

Përveç këtij Ligji bazë, që trajton drejtpërdrejt problemet e mbrojtjes së mjedisit, ekzistojnë edhe ligje të tjera specifike për një fushë të caktuar, por që synojnë, në të njëjtën kohë, mbrojtjen e mjedisit, pasi me mjedisin janë të lidhura pothuajse të gjitha aktivitetet njerëzore.

Bazuar në ligjin për pushtetin lokal, këshillat e bashkive e të komunave miratojnë programet e zhvillimit social-ekonomik në juridiksionin përkatës dhe mbikëqyrin zbatimin e tyre. Në praktikat e deritanishme vihen re:

i) mungesa nga strukturat e pushtetit lokal e një vizioni e strategjie zhvillimi (mungesa e njohjes reale të gjendjes, e informacionit, e përvojës, e kualifikimit etj); ii) prirjet për të anashkalluar ligjet në marrjen e vendimeve ose në emër “të mospengimit të zhvillimit”; iii) mungesa e përgatitjeve për të përfutuar projekte zhvillimi nga faktorë e subjekte të ndryshme (sidomos të jashtme) ose pritshmëria që ndërhyrjet të vijnë të gatshme etj.

Shqipëria është e angazhuar dhe zbaton detyrimet që rrjedhin nga nënshkrimi i një sërë marrëveshjeve ndërkombëtare, konventave dhe protokolleve, të cilat janë instrumente ligjore në fushën e mjedisit dhe që synojnë mbrojtjen e përbashkët të tij.

Me gjithë kuadrin e gjerë ligjor mjedisor dhe nënshkrimin e konventave, shfrytëzimi pa kriter i florës e faunës në rajon, degradimi i zonave të mbrojtura, shfrytëzimi pa kriter i zhavoreve në shtretërit e lumenjve, prerjet pa leje në pyje, ndërtimet jashtë zonave të planifikuara, keqadministrimi i burimeve ujore nëntokësore po e përkeqësojnë mjedisin, duke dëmtuar rëndë burimet e zhvillimit në të ardhmen.

Organizimi institucional

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes së Mjedisit (AKM) është organi më i lartë qeveritar që merret me problemet e mbrojtjes së mjedisit. Që në formimin e saj (më 1991, me 3 persona) ka njohur disa organizime strukturore (aktualisht, me 70 persona). Struktura aktuale e AKM-së jepet në skemën e mëposhtme.

Duke qenë organi qendror koordinues përgjegjës për mbrojtjen e mjedisit në RSH, detyrat dhe përgjegjësitë e AKM-së (sipas raportit të fundit të AKM-së për gjendjen e mjedisit në Shqipëri) janë:

i) përcakton strategjinë e qeverisë në fushën e mbrojtjes së mjedisit, koordinon funksionet e ministrive, institucioneve të tjera qendrore dhe organeve lokale; ii) organizon monitorimin e mjedisit në shkallë kombëtare dhe propozon hapa konkrete për mbrojtjen e ajrit, ujit, tokës dhe të burimeve gjenetike të vendit; iii) përcakton politikat kryesore dhe përparësitë në investime për të mbrojtur mjedisin, që janë në vijueshmëri me zhvillimet ekonomike dhe shoqërore të vendit; iv) miraton normat e shkarkimeve të lëngëta, të gazta, të ngurta në ajër, në ujë dhe në tokë, si dhe nivelet e pranueshme të substancave toksike në mbetjet e rrezikshme; v) përfaqëson pikën fokale kombëtare për shumë programe dhe çështje mjedisore.

Agjencia Rajonale e Mjedisit Lezhë (ARM Rajoni i Prefekturës Lezhë) është formuar në qershor të vitit 1994, në zbatim të VKM nr 599, datë 20.12.1993 “Për krijimin e Agjencive Rajonale të Mbrojtjes së Mjedisit në Prefektura”. ARM-ja Lezhë ka funksionuar me 2 persona, me zyrë në Lezhë e Laç.

ARM-të e ngritura në nivel prefekturë kanë këto detyra e përgjegjësi kryesore:

i) kontrollojnë dhe detyrojnë zbatimin e kuadrin ligjor mjedisor; ii) ndjekin dhe zbatojnë procedurat paraprake të liçensimit mjedisor; iii) grumbullojnë dhe përpunojnë të dhëna për gjendjen e mjedisit në nivel rrethi e prefekturë.

Për një zhvillim rajonal të qëndrueshëm

Objektivat për një zhvillim rajonal të qëndrueshëm duhet të fokusojnë sisteme të integruara të menaxhimit mjedisor që të parashikojnë në çdo hap evitimin sa më shumë që të jetë e mundur të ndikimeve në mjedis. Veç të qenurit legal, objektivat duhet të jenë në përshtatje me kërkesat e popullatës dhe me fleksibilitet që t’u përshtatet standardeve e objektivave që mund të miratohen në të ardhmen. Moszbatimi i tyre rrit koston për investitorët. Të kushtëzuar nga situata mjedisore aktuale, në mënyrë të menjëhershme objektivat do të synonin në:

i) përdorimin racional të burimeve të natyrës (florës, faunës, inerteve, ujit etj.), mbrojtjen e biodiversitetit, rehabilitimin e burimeve të dëmtuara, me qëllim që të jenë të barabarta për brezat e ndryshëm; ii) rritjen e kapaciteteve institucionale dhe të përgjegjësive të tyre për të zbatuar veprimet dhe projektet e rekomanduara; iii) nxitjen dhe inkurajimin e industrisë së turizmit, që bazohet në konservimin e natyrës; iv) rritjen e alternativave të punësimit që të maksimizohen përfitimet e popullatës nëpërmjet veprimtarive të harmonizuara me mjedisin.

Ekoturizmi - turizëm që bazohet në konservimin e natyrës

Pozicionimi si objektivi parësor i aktiviteteve të turizmit e në veçanti të ekoturizmit është deklaruar si një mundësi e madhe e rajonit të Lezhës për zhvillim. Në këtë kuptim habitatet e pasura të tokave të lagunave renditen në vendin e parë. Ato tërheqin dhe mund të tërheqin vizitorë të interesuar për studime, vëzhgime

2 Në nenin 1 të këtij Ligji përcaktohet se “Mbrojtja e mjedisit përbën një kusht themelor për sigurimin e zhvillimit të shoqërisë dhe një përparësi kombëtare dhe ka këto elemente strategjike:

- parandalimin dhe uljen e ndotjes së ujit, ajrit dhe tokës,
- ruajtjen e shumëllojshmërisë biologjike të mjedisit biogeografik natyror të vendit,
- shfrytëzimin racional të burimeve natyrore dhe shmangien e mbishfrytëzimit të tyre,
- riaftësimin ekologjik të zonave të dëmtuara nga veprimtaria njerëzore ose fenomenet natyrore shkatërruese,
- ruajtjen e ekuilibrit ekologjik dhe të cilësisë së jetës dhe përmirësimin e saj.

e eksperiencave natyrore, turistë që kombinojnë pushimet me soditjen e natyrës dhe me ata që janë të interesuar për problemet e mjedisit, ekoturistë, në përgjithësi. Këta vizitorë kërkojnë larmi të karakteristike të mjedisit dhe vlera të veçanta peizazhore. Ngushtimi i korridorit ekologjik bregdetar të Kune - Vainit e Patokut, spostimet e ngulmimit e popullatës në afërsi të tyre kanë bërë që hapësira në fjalë të mos përballojë densitet të lartë turizmi.

Prioritetet Strategjike

SKZHES dhe Kornizat Kombëtare	OZHM	BE	Qarku i Lezhës
<p>1. Ristrukturimi dhe konsolidimi i strukturave të menaxhimit të mjedisit në nivelin e qeverisjes vendore.</p> <p>2. Kontrolli i prerjes së paligjshme të drurëve</p> <p>3. Kalimi i pyjeve dhe i kullotave nën pronësinë e komunave e bashkive.</p> <p>4. Plotësimi i kuadrit ligjor për menaxhimin e përbashkët të pyjeve e kullotave nga shteti dhe banorët</p> <p>5. Mbrojtja nga erozioni i tokës, duke mbjellë pemë dhe menaxhuar derdhjet e ujërave.</p> <p>6. Forcimi dhe zgjerimi i organizatave mjedisore dhe të peshkimit në rang kombëtar dhe qarku</p>	<p>1. Integrimi i parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm në politikat dhe programet e vendit.</p> <p>2. Ruajtja e burimeve natyrore. Ulja e raportit të popullsisë pa ujë të pijshëm të pastër dhe infrastrukturë të përshtatshme për ujërat e zeza</p>	<p>1. Lufta kundër degradimit të mjedisit dhe rritja e vëmendjes ndaj:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Cilësisë së ujit - Ndotjes së ajrit - Monitorimit të nivelit të ndotjes - Nxitjes së efikasitetit të energjisë - Sigurisë së uzinave industriale - Planifikimit urbanistik - Menaxhimit të mbetjeve - Mbrojtjes së pyllit (florës dhe faunës) <p>2. Garantimi i integritetit të problemeve mjedisore në politikat dhe programet sektoriale.</p> <p>3. Integrimi i parimit të zhvillimit të qëndrueshëm në përdorimin e burimeve natyrore.</p> <p>4. Përmirësimi i situatës në zonat e përcaktuara si të nxehta.</p>	<p>1. Përfshirja e parimit të qëndrueshëm me politikat e programet <u>vendore</u> dhe kthimi në të kundërt i prirjes së humbjes së burimeve mjedisore.</p> <p>2. Përgjysmimi brenda vitit 2015 i numrit të njerëzve pa furnizim të mjaftueshëm me ujë të pijshëm të sigurt, nëpërmjet gjetjes së burimeve natyrore të pastra dhe sigurimi i infrastrukturës së përshtatshme higjieno sanitare.</p> <p>3. Mbrojtja e pasurive natyrore nga ndikimi i faktorëve njerëzorë.</p> <p>4. Zhvillimi dhe përdorimi në mënyrë të qëndrueshme i burimeve natyrore dhe nxitja e turizmit rigjenerues.</p>

Synimet e Qarkut:

- 5.1 Rikthimi i vëmendjes ndaj burimeve të rinovueshme natyrore, duke u kushtuar vëmendje të veçantë mbrojtjes dhe shtimit të pyjeve e zonave të mbrojtura, si dhe të sipërfaqeve të gjelbra në zonat urbane.
- 5.2 Ulja e rreziqeve për shëndetin (me vëmendje të veçantë deri në vitin 2015), duke përgjysmuar numrin e njerëzve që nuk kanë mundësi të furnizohen me ujë të pijshëm brenda standardeve të sigurisë –synim i OZHM; përmirësimi i sistemit të mbledhjes dhe depozitimit të mbetjeve në vendet e caktuara, si dhe zbatimi i standardeve ligjore për shkarkimet në ajër.
- 5.3 Përfshirja e parimit të qëndrueshmërisë së mjedisit në politikat dhe programet e qarkut, si dhe ruajtjes së burimeve natyrore.

Treguesit

1. Sipërfaqja e tokës së mbuluar me pyje

Një pjesë e rëndësishme e qëndrueshmërisë së mjedisit në qarkun tonë lidhet me sipërfaqen e pyjeve, jo vetëm për jetesën e botës shtazore, por edhe me të ardhmen ekonomike.

Pavarësisht se aktualisht kemi 58% të sipërfaqes të mbuluar me pyje, kjo është një shifër e ulët në krahasim me të kaluarën. Kjo për shkak të një sërë veprimtarish të paligjshme.

2. Rrezikimi i faunës

Sipas të dhënave, qarku i Lezhës ka tregues të lartë të llojeve të rrezikuara, në krahasim me mesataren e BE-së. Prandaj mbetet një nevojë urgjente për të mbrojtur dhe ruajtur të gjitha llojet faunistike, si dhe vendbanimet e tyre. Për të ndaluar rritjen e llojeve të rrezikuara dhe për përmirësimin e gjendjes së tyre kërkohen përpjekje të mëdha nga të gjithë aktorët, në mënyrë që qarku ynë të arrijë standardet e BE-së.

3. Rastet e diarresë

Ky tregues jep të dhëna të dobishme për sa i përket cilësisë së përgjithshme të ujit në qarkun e Lezhës. Pavarësisht se shkaqet e diarresë nuk kufizohen vetëm tek uji, ky indikator mbetet relevant meqë diarrea në të shumtën e rasteve shkaktohet nga ndotja e ujit.

Treguesit aktualë dhe të parashikuar

Synimi	Treguesit	Mesatarja Kombëtare e Shqipërisë	Qarku i Lezhës	2007	2010	2013	2015	Mesatarja e BE (të dhëna nga Agjencia Europiane e Mjedisit)
5.1, 5.3	Përqindja e sip. totale të mbuluar me pyje	35 (2000, UNECE)	58% (2003, Kadastra)	61	64	66	69,5	Ska të dhëna
5.1, 5.3	Fauna e rrezikuar	Gjitarët 56 (2000, UNECE)	7	5	3	2	0	Prej 250 llojesh, 42% rrezikohen (1993)
		Shpendët 31 (2000, UNECE)	44	30	16	8	0	Prej 520 llojesh 15% rrezikohen (1993)
		Zvarrani-kët N/A	23	18	10	5	0	Prej 199 llojesh, 45% rrezikohen (1993)
		Insektet N/A	21	17	11	4	0	N/A
		Peshq të ujërave të ëmbla N/A	11	7	5	2	0	Prej 227 llojesh ,52% rrezikohen (1993)
5.2	Rastet e diarresë (për 100.000)	Nuk ka të dhëna	1365	937	620	310	0	Nuk ka të dhëna

Programi i Zhvillimit

Synimi 5.1: Rikthimi i vëmendjes ndaj burimeve të rinovueshme natyrore, duke i kushtuar vëmendje të veçantë mbrojtjes së kësaj pasurie, shtimit të zonave të mbrojtura, si dhe të sipërfaqeve të gjelbra në zonat urbane.

Problemi	Projekti	Përshkrimi	Harku kohor	Partnerët	Kostot (në Euro)	Efekti
Ritmi i lartë i humbjes së pasurisë pyjore	Projekt për mbjelljen e pemëve	Studim i përgjithshëm për të dalluar zonat parësore për pyllëzim dhe sasinë e fidaneve që nevojiten	2006	KQ, OJF-të, ARM Komuniteti DSHP	17.000	Ripyllëzimi do të ndikojë drejtpërdrejt mbi treguesit ndryshe 1 dhe jo drejtpërdrejt mbi treguesin ndryshe 2, pasi do të sigurojë mjedisin e duhur për jetesën e disa prej llojeve të listuara në tabelë.
		Rimbjellja e shpejtë e zonave parësore të identifikuara më lart	2006-2007	KQ, OJF-të Donatorët	110.000	
	Program ndërgjegjësimi	Nxitja e sipërmarrjes për krijimin e fidanishteve pyjore	2005	KQ, OJF-të, Donatorët	70.000	Programet e ripyllëzimit duhet të balancohen me ato të ndërgjegjësimit dhe me aktivitete për uljen e varfërisë, duke garantuar kështu qëndrueshmërinë e tyre. Ky projekt do të ndikojë drejtpërdrejt në treguesin 1.
		Në fushën e mediatike për të theksuar rreziqet e prerjeve të paligjshme të pyjeve, si për dru zjarri, ashtu dhe për lëndë ndërtimi.	2005-2006	KQ, OJF-të, Donatorët		
	Projekt për kontrollin e dëmtimit nga insektet	Ngritja e sistemit të kontrollit brenda Agjencisë Mjedisore të qarkut.	2005-2006	KQ, OJF-të, Donatorët, ARM	90.000	Kontrolli dhe shfarosja e insekteve do të ndalojë degradimin, duke ndikuar kështu mbi treguesin 1.
		Lufta ndaj insekteve të dëmshme (duke gjetur metodat që respektojnë mjedisin)	2006-2010	KQ, OJF-të, Donatorët, ARM	450.000	

Problemi	Projekti	Përshkrimi	Harku kohor	Partnerët	Kostot (në Euro)	Efekti
Përmbytja e zonës fushore	Projekt për ndalimin e përmbytjes	Krijimi i hartës së përmbytjes dhe prioritizimi i ndërhyrjeve	2006	KQ, OJF-të, Donatorët	12.000	Eliminimi i përmbytjes do të ndikonte pozitivisht në mbrojtjen e tokës dhe të biodiversitetit të kësaj zone, si dhe infrastrukturën banuese, për pasojë, dhe në aspektin ekonomik.
		Ulja e përmbytjes dhe përpjekjet për parandalimin e plotë të saj me anë të: <ul style="list-style-type: none"> - Studimit për zvogëlimin e prurjeve të ngurta të zonës kodrinore malore. - Studimit për lumenjtë Mat, Drin, Gjadër e Droje. - Vënia në efikasitet e hidrovoreve dhe e rrjetit kullues ekzistues. - Studimit për urbanizimin e zonave rurale. 	2006-2010	KQ, OJF-të, Donatorët, ARM, Komunitetet lokale	1.100.000	
Humbja e parametrave hidrodinamike të lumit Drin dhe ndikimi i tij në degradimin e lagunave	Studim kompleks i lumit Drin.	Studim i parametrave hidrodinamike: <ul style="list-style-type: none"> - Funksioni e kapacitetet e stacioneve të pompimit - Biodiversiteti 	2007-2008	KQ, OJF-të, Donatorët, ARM, Komunitetet lokale	200.000	Shtimi i sasisë së ujit në shtratin e lumit Drin dhe thellimi i tij ndikojnë dukshëm në rritjen e kapacitetit të përcjelljes së prurjeve e, për pasojë, në gjallërimin e lagunave.
		Projekt për thellimin e shtratit të lumit Drin.	2006-2008		100.000	
		Ndërtimi i veprës marrëse të ujit në Vaun e Dejës.	2008		350.000	
Erozioni	Projekt për uljen e e erozionit	Krijimi i hartës së erozionit dhe prioritizimi i ndërhyrjeve.	2005-2006	KQ, OJF-të, Donatorët, ARM, Komunitetet lokale	70.000	Erozioni shkakton prishjen e zonave të gjelbra dhe të pyjeve çdo vit. Treguesi 1 dhe 2 do të ndikohen pozitivisht nëpërmjet uljes dhe eliminimit të erozionit të pyjeve dhe mjediseve natyrore
		Ulja e erozionit dhe përpjekjet për zhdukjen e tij	2005-2010		1.250.000	
Shkatërrimi i hapësirave të gjelbra urbane dhe ndotja	“Pastrim dhe gjelbërim urban” në qarkun e Lezhës	Rahabilitim në shkallë të ulët i parqeve dhe administrimi i përshtatshëm i mbetjeve dhe nxitja e aktorëve të interesuar për mbrojtjen e mjedisit.	2005-2006	KQ, OJF-të, Donatorët, ARM, Komunitetet lokale	1.800.000	Rehabilitimi i hapësirave të gjelbra urbane do të ndikojë direkt mbi treguesin 1
Ndotjet industriale (Zonat e nxehta)	Projekt për pastrimin dhe rehabilitimin e zonave të nxehta (Rubik e Laç)	Studim dhe prioritizim i zonave me ndotje të lartë	2005-2006	KQ, OJF-të, Donatorët, ARM, Komunitetet lokale	55.000	Pastrim i ”zonave të nxehta“ do të rivitalizojë tokën dhe biodiversitetin dhe elementet e tjerë natyrorë përreth tyre, duke ndikuar direkt mbi treguesit 1 dhe 2
		Pastrim dhe rehabilitim i zonave të nxehta.	2006-2011	KQ, OJF-të, Donatorët, ARM	E pa llogaritur	

Synimi 5.2 Ulja e rreziqeve për shëndetin (me vëmendje të veçantë deri në vitin 2015), duke përgjysmuar numrin të njerëzve që nuk kanë mundësi të furnizohen me ujë të pijshëm brenda standardeve të sigurisë –synim i OZHM; përmirësimi i sistemit të mbledhjes dhe depozitimit të mbetjeve në vendet e caktuara, si dhe zbatimi i standardeve ligjore për shkarkimet në ajër.

Problemi	Projekti	Përshkrimi	Harku kohor	Partnerët potencialë	Kostot (në Euro)	Efekti
Dëmtimi i infrastrukturës së furnizimit me ujë (Orari i kufizuar i furnizimit me ujë)	Projekt për rehabilitimin e sistemit të ujit	Riparim i rrjedhjeve në sistemin e furnizimit me ujë	2005-2006	KQ, OJF-të Donatorët, ARM, Komunitetet lokale	200.000	Zgjidhja e problemit të ndërhyrjeve të paligjshme në rrjet dhe gjoba për rregullimin e dëmeve do të përmirësojnë sigurinë dhe mundësinë e pasjes së ujit të pastër, duke ndikuar kështu pozitivisht në treguesin 3.
		Evidencim i lidhjeve të paligjshme, nxjerrja e parametrave, ndërprerja e detyrueshme, nëse është e nevojshme.	2005-2006		100.000	
		Asistencë teknike në lidhje instalimin e matësave të ujit	2005-2006		1.2500.000	
Cilësia e ujit të pijshëm	Projekt për administrimin e ujit .	Zhvillimi i politikës së qarkut për cilësinë e ujit në linjë me standardet Kombëtare dhe Europiane	2005-2006	KQ, Institucionet kërkimore, OJF-të, Donatorët, ARM, Komunitetet vendore	30.000	Përmirësimi i objekteve të testimit të ujit dhe politikat rregullatore për standardet sanitare do të ndikojnë pozitivisht mbi treguesin 3.
		Rinovimi i pajisjeve ekzistuese për testimin dhe kontrollin e ujit.	2005-2007		320.000	
	Projekt për eliminimin e burimeve të ndotjes së ujit.	Studim mbi burimet e hapura të mbetjeve që ndotin ujin. Rekomandime për veprime dhe politika zhvillimi.	2005-2006		70.000	Zgjidhja e këtij problemi do të ndikonte pozitivisht mbi treguesin 3 dhe do të ndikonte mbi treguesin 2 përsa i përket përmirësimit të kushteve të mjedisit për peshqit e ujërave të ëmbla, duke ulur kështu numrin e llojeve të rrezikuara
		hvim i sistemit të grumbullimit, depozitimit dhe riciklimit të mbetjeve	2006-2011		5.100.000	

Problemi	Projekti	Përshkrimi	Harku kohor	Partnerët potencialë	Kostot (në Euro)	Efekti
	Program ndërgjegjësimi	Në fushën multimediatike për të theksuar pasojat që sjellin shpimet pa kriter nga familjet e ndryshme. Ndërgjegjësim për mirëpërdorimin e ujit të pijshëm.	2005	KQ, Komunitetet lokale, OJF, Donatorët	20.000	Eliminimi i shpimeve pa kriter në këto zona do të çonte në ruajtjen e rezervave ujore, si dhe në ruajtjen e ndotjes së tyre apo kripëzimin, gjë e cila do të ndikojë direkt në treguesin 3.
Dëmtimi dhe mungesa e infrastrukturës bashkëkohore për largimin dhe përpunimin e ujërave të përdorura	Projekt i përmirësimit të sistemit të largimit të ujërave të përdorura.	Rikonstruksion i rrjetit të kolektorëve në : bashkinë Lezhë, Besëlidhja bashkinë Laç, Mamurras, Rubik dhe Rrëshen.	2005-2007	KQ, OJF-të Donatorët Komunitetet vendore	500.000	Garantohet cilësia e ujit të pijshëm, i ujërave sipërfaqësore dhe atyre nëntokësore, duke ndikuar kështu në treguesit 2 e 3.
	Projekt për ndërtimin e impianteve të trajtimit të ujërave të përdorura.	Ndërtimi i linjave të trajtimit të ujërave të përdorura në bashkitë e qarkut.	2008-2014	KQ, OJF-të Donatorët Komunitetet vendore	1.000.000	
Mbishfrytëzimi i ujërave nëntokësore të akuafireve të F.Kuqes e B.Matës për konsum dhe për ujitje.	Studim mbi rezervat ujore nëntokësore, problematika që lidhet me shfrytëzimin e tyre.	Studim i cili të përcaktojë rezervat e ujit në këto akuifere dhe problemet që dalin nga shfrytëzimi pa kriter i tyre, si dhe për vendosjen e matësave në çdo shpim.	2006-2008	KQ, OJF-të Donatorët Komunitetet vendore	50.000	
Cili është problemi	Projekte për rehabilitimin dhe vënien në efikasitet të sistemit ujitës	Studim për vënien në efikasitet të rrjetit ujitës ekzistues, si dhe nevojat për rrjete të reja.	2005-2007	KQ, OJF-të Donatorët Komunitetet vendore	50.000	

Synimi 5.3 Përfshirja e parimit të qëndrueshmërisë së mjedisit në politikat dhe programet e qarkut, si dhe të ruajtjes së burimeve natyrore. Në këtë synim përcaktohet parimi i përfshirjes aktive të burrave dhe grave në identifikimin e problemeve, në vlerësimin dhe në zbatim.

Problemi	Projekti	Përshkrimi	Harku kohor	Partneret potenciale	Kostot (in Euro)	Efekt
Mungesa e Planeve Lokale të Veprimit në Mjedis për të gjitha bashkitë dhe komunat	Projekt për hartimin e Planeve Lokale të Veprimit në Mjedis.	Përfaqësuesit (numër i barabartë i burrave dhe i grave) nga bashkitë dhe komunat do të bëjnë përpjekje për të ndërmarrë aktivitete planifikuese për mjedisin në komunitetin e tyre	2005-2006	KQ, OJF-të Donatorët Komunitetet vendore REC.	100.000	Planet Lokale të Veprimit në Mjedis do të ndikojnë pozitivisht në menaxhimin e këtyre zonave.
Mungesë e njohurive të reja mbi llojet e rrezikuara dhe vendbanimeve të tyre	Projekt për inventarizimin dhe katalogimin e llojeve të rrezikuara dhe vendbanimet e tyre	Studim shumëvjeçar për të inventarizuar dhe kataloguar llojet e rrezikuara të vendbanimeve të tyre në qarkun e Lezhës.	2005-2010	KQ, Insitucionet kërkimore dhe shkencore OJF-të Donatorët Komunitetet vendore	650.000	Do të kontribuojë në planifikimin më efektiv të nismave për eliminimin e shkaqeve kryesore të rrezikimit të tyre, duke ndikuar kështu pozitivisht mbi treguesin 2
Mungesa e ekspertizës së qeverisjes lokale dhe shoqërisë civile mbi çështjen e qëndrueshmërisë së mjedisit dhe të planifikimit në mbështetje të mjedisit.	Projekt mbi ngritjen e kapaciteteve në lidhje me problemet e mjedisit.	Trajnime dhe vizita shkëmbyese në vend dhe në vendet me eksperiencë pozitive në përfshirjen e qëndrueshmërisë së mjedisit në planifikimin për zhvillim.	2005-2007	KQ, (Drejtoria e personelit Qeveria Shqiptare Insitucionet kërkimore dhe shkencore Donatorët.	90.000	Njohuri mbi qëndrueshmërinë e mjedisit dhe përfshirja e tij në ciklin e projektit do të ndikojë pozitivisht mbi të tre treguesit.
Mosmenaxhimi i tokave	Projekt për të drejtat dhe përdorimin e kullotave dhe pyjeve	Studim për strukturat ekzistuese të menaxhimit të kullotave dhe të pyjeve, kufijtë e tyre, si dhe politikë për përmirësimin e menaxhimit dhe të zgjidhjes së problemit të pronave.	2005-2009	KQ, Insitucionet kërkimore dhe shkencore OJF-të Donatorët Komunitetet vendore	550.000	Strategjitë e qarta për menaxhimin tokave do të mundësojnë kryerjen e planifikimeve më efektive për ruajtjen, dhe përdorimin e qëndrueshëm të tyre, duke ndikuar kështu pozitivisht mbi të tre treguesit.
Mungesë aftësish menaxhuese në raste katastrofash	Projekt për ngritjen e kapaciteteve të Zyrës së Emergjencave Civile	Rritja e kapaciteteve të Zyrës për tu marrë me të gjitha aspektet e menaxhimit të fatkeqësive nëpërmjet pajisjes me logjistikën e përshtatshme dhe kualifikimit të stafit.	2005-2007	KQ, Donatorët	25.000	Menaxhimi i fatkeqësive është një parakusht për zhvillim të qëndrueshëm njerëzor dhe arritje të OZHM-ve.

Shtojcat

Llogaritja e HDI

Llogaritja e HDI mbështetet në tre faktorë, jetëgjatësinë, nivelin e analfabetizmit dhe GDP për frymë. Sipas kësaj metode është e mundur që nëpërmjet një treguesi të vetëm, indeksit të zhvillimit njerëzor (HDI-së) të përcaktohet niveli i zhvillimit të një qarku. Rezultatet e llogaritjeve tregojnë ndryshime të dukshme në nivelin e zhvillimit njerëzor midis rajoneve të ndryshme të vendit.

	Familje gjithsej 2003	Familje gjithsej me përkrahje sociale	Nr. personave që trajtohen me përkrahje sociale gjithsej	Fondi mujor (000/lek)	Lekë/Frymë nga përkrahja sociale
Qarku Lezhë	51.677	9.012	40.920	24.347	594,9
Rr.Lezhë	22.167	2.298	10.375	6.292	606,5
B.Lezhë	6.076	786	3.345	2.553	793,2
K.Balldre	2.038	68	386	100	259,07
K.Blinisht	1.371	96	369	150	406,5
K.Dajç	1.739	31	144	45	312,5
K.Kallmet	1.453	122	503	186	369,7
K.Kolsh	1.341	137	660	318	481,8
K.Shëngjin	2.554	201	828	508	613,5
K.Shënkoll	2.834	141	841	306	363,8
K.Ungrej	916	574	2613	1.874	717,18
K.Zejmen	1.845	142	686	252	367,35
Rr.Kurbin	17.928	3.492	15.267	8.938	585,45
B.Laç	7.866	1.867	7.983	5.330	667,67
B.Mamurras	5.348	821	3.740	1.818	486,10
K.Fush-Kuqe	1.798	-	-	-	-
K.Milot	2.916	804	3.544	1.790	505,08
Rr.Mirditë	11.582	3.222	15.278	9.117	596,7
B.Rrëshen	3.700	735	3.511	2.525	719,17
B.Rubik	2.367	484	2.166	1.511	697,6
K.Fan	1.558	721	3.340	1.902	569,46
K.Kaçinar	778	391	1.936	743	383,78
K.Kthellë	1.053	152	766	366	477,81
K.Orosh	1.286	430	1.974	1.205	610,44
K.Selitë	840	309	1.585	865	545,74

Familje me përkrahje sociale (Burimi: KQ, 2003)

Emërtimi	Gjendja në fund të muajit			Sipas grupmoshave				Sipas nivelit arsimor			
	Gjithsej	Femra	K/ Familjar	15-19	20-24	25-34	35 e lart	8-vje-çare	Mesme	Prof.	e lartë
Punë- kërkues të papunë Mirditë	3.846	1.401	2.311	539	1.663	1.016	628	949	2.353	476	68
Punë- kërkues të papunë Kurbin	8.287	4.093	3.716	395	1.078	2.512	4.302	4.345	2.416	1456	70
Punë- kërkues të papunë Lezhë	3.552	1.812	1.771	99	435	796	2.222	2.182	495	687	188

Të dhënat për papunësisë për Qarkun (INSTAT 2003)

	Popullsia e papunë mbi 15 vjeç	Meshkuj të papunë mbi 15 vjeç	Femra të papunë mbi 15 vjeç	Popullsia aktive (Gjithsej)	Meshkuj	Femra
Qarku Lezhë	14.646	7.525	7.121	109.681	52.874	56.807
Rr.Lezhë	3.685	1.859	1.826	46.913	22.512	24.401
B.Lezhë	1.761	648	1.113	10.097	4.853	5.244
K.Balldre	193	143	50	4.711	2.187	2.524
K.Blinisht	27	21	6	2.975	1.401	1.574
K.Dajç	194	108	86	3.590	1.689	1.901
K.Kallmet	56	45	11	3.981	1.977	2.004
K.Kolsh	169	121	48	3.523	1.713	1.810
K.Shëngjin	407	152	255	4.755	2.194	2.561
K.Shënkoll	201	145	56	5.938	2.836	3.102
K.Ungrej	148	120	28	2.679	1.348	1.331
K.Zejmen	529	356	173	4.664	2.314	2.350
Rr.Kurbin	6.771	3.451	3.320	37.081	17.983	19.098
B.Laç	3.191	1.265	1.926	13.460	6.499	6.961
B.Mamurras	1.948	1.233	715	12.083	5.924	6.159
K.Fush-Kuqe	290	161	129	3.974	1.850	2.124
K.Milot	1.342	792	550	7.564	3.710	3.854
Rr.Mirditë	4.190	2.215	1.975	25.687	12.379	13.308
B.Rrëshen	1.374	556	818	7.904	3.791	4.113
B.Rubik	1.005	347	658	4.852	2.250	2.602
K.Fan	511	439	72	3.812	1.904	1.908
K.Kaçinar	310	179	131	2.019	1.023	996
K.Kthellë	255	210	45	2.604	1.228	1.376
K.Orosh	505	285	220	2.727	1.324	1.403
K.Selitë	230	199	31	1.769	859	910

Të dhënat për papunësisë për Qarkun (INSTAT 2003)

	Të punësuar	Të papunë	Jo ekonomikisht aktive	Popullsia aktive (Gjithsej)
Qarku Lezhë	53.048	14.646	41.987	109.681
Rr.Lezhë	24.917	3.685	18.311	46.913
B.Lezhë	4.753	1.761	3.583	10.097
K.Balldrë	2.523	193	1.995	4.711
K.Blinisht	1.638	27	1.310	2.975
K.Dajç	1.574	194	1.822	3.590
K.Kallmet	2.627	56	1.298	3.981
K.Kolsh	2.340	169	1.014	3.523
K.Shëngjin	2.614	407	1.734	4.755
K.Shënkoll	3.618	201	2.119	5.938
K.Ungrej	1.207	148	1.324	2.679
K.Zejmen	2.023	529	2112	4.664
Rr.Kurbin	15.529	6.771	14.781	37.081
B.Laç	5.697	3.191	4.572	13.460
B.Mamurras	4.866	1.948	5.269	12.083
K.Fush-Kuqe	1.855	290	1.829	3.974
K.Milot	3.111	1.342	3.111	7.564
Rr.Mirditë	12.602	4.190	8.895	25.687
B.Rrëshen	3.926	1.374	2.604	7.904
B.Rubik	2.225	1.005	1.622	4.852
K.Fan	2.183	511	1.118	3.812
K.Kaçinar	1.027	310	682	2.019
K.Kthellë	1.173	255	1.176	2.604
K.Orosh	1.282	505	940	2.727
K.Selitë	786	230	753	1.769

Të dhënat për papunësinë për Qarkun (INSTAT 2003)

	Sipërfaqja e mbjellë (në ha.)						Prodhimi (në ton)					
	Grurë	Misër	Foragjere	Perime	Fasule	Patate	Grurë	Misër	Foragjere	Perime	Fasule	Patate
Qarku	2.780	3.065	11.999	2.061	826	376	16.274	13.903	149.918	40.242	886	5.592
Kurbin	230	410	3.173	458	180	40	658	2.132	107.088	11.540	100	280
Lezhë	2.400	1.745	7.301	1.344	446	196	14.860	7.503	18.640	23.369	446	1.626
Mirditë	150	910	1.525	259	200	140	380	4.268	24.190	5.333	340	2.800

Emërtimi	Nr.pemëve gjithsej	Numri i drufrutorëve					Vreshtari Sip. ha.
		Mollë	Dardha	Pjeshkë	Ullinj	Agrume	
Qarku Lezhë	243.401	37.728	19.724	15.850	28.955	1.350	242,4
Rr.Lezhë	67.755	16.206	10.314	6.774	18.221	790	165
B.Lezhë	=	=	=	=	=	=	=
K.Balldre	8.236	3.670	2.710	1.440	5	111	0,2
K.Blinisht	6.543	990	720	480	4.053	=	45
K.Dajç	6.130	910	2.540	680	1.700	=	53
K.Kallmet	13.306	1.096	480	750	8.900	80	15
K.Kolsh	6.547	890	1.640	870	132	15	3
K.Shëngjin	2.865	1.090	620	670	51	134	3
K.Shënkoll	6.510	3.900	870	640	350	450	12
K.Ungrej	4.297	610	44	643	=	=	30
K.Zejmen	13.321	3.050	690	551	3.030	=	4
Rr.Kurbini	58.639	9.760	4.100	2.130	10.734	560	30
B.Laç	7.120	3.660	430	410	520	=	2
B.Mamurras	17.000	4.150	1.470	520	8.900	260	21
K.Fush-Kuqë	10.000	450	200	=	=	250	4
K.Milot	24.519	1.500	2.000	1.200	164	50	3
Rr.Mirditë	117.007	11.762	5.310	6.946	=	=	47,4
B.Rrëshen	11.870	3.300	220	150	=	=	36,1
B.Rubik	18.350	1.550	1.120	2.450	=	=	3,1
K.Fan	24.760	1.000	900	1.900	=	=	=
K.Kaçinar	13.800	1.450	570	1.000	=	=	1,4
K.Kthellë	22.067	1.907	950	500	=	=	5,3
K.Orosh	16.585	1.700	600	500	=	=	1,5
K.Selitë	9.575	855	950	446	=	=	=

Gjendja e bujqësisë në Qark
(Burimi:Drejtorja e Bujqësisë - Dhjetor 2003)

Emërtimi	Nr.njësive blegtorale	Numri i kreveve				
		Gjedhë	Të leshta	Të dhirta	Derra	Bletë
Qarku Lezhë	32.130	42.839	55.095	60.230	35.970	3.911
Rr.Lezhë	14.400	19.650	22.800	13.500	20.030	1.211
B.Lezhë	=	=	=	=	=	=
K.Balldre	1.835	2.780	5.700	1.980	2.600	125
K.Blinisht	1.380	1.470	2.260	820	1.380	160
K.Dajç	1.789	3.400	1.400	50	1.500	200
K.Kallmet	1.280	1.300	1.500	1.000	1.400	150
K.Kolsh	1.066	1.070	640	2.200	800	96
K.Shëngjin	1.411	1.980	1.500	700	2.300	130
K.Shënkoll	2.428	3.500	3.800	300	6.500	140
K.Ungrej	1.332	1.750	4.400	4.050	850	110
K.Zejmen	1.879	2.400	1.600	2.400	2.700	100
Rr.Kurbin	8.370	11.089	11.795	16.330	5.440	1.200
B.Laç	1.058	1.512	1.210	630	1.210	200
B.Mamurras	2.950	3.592	4.815	3.620	1.520	300
K.Fush-Kuqe	1.392	3.015	2.260	160	1.198	200
K.Milot	2.970	2.970	3.510	11.920	1.512	400
Rr.Mirditë	9.360	12.100	20.500	30.400	10.500	1.500
B.Rrëshen	1.610	2.500	3.500	3.500	1.700	200
B.Rubik	1.234	1.000	820	5.500	1.480	200
K.Fan	1.630	2.200	4.500	4.800	1.870	200
K.Kaçinar	830	780	570	3.460	1.000	230
K.Kthellë	2.080	2.200	4.690	3.950	2.040	250
K.Orosh	1.086	1.920	3.100	3.590	1.470	220
K.Selitë	890	1.500	3.320	5.600	940	200

Gjendja e blektorisë në Qark
(Burimi:Drejtoria e Bujqësisë - Dhjetor 2003)

	Qarku	Kurbin	Lezhë	Mirditë
Gjithsej	1.718	517	744	457
Femra%	65	64,2	66,1	62

Mësues sipas rretheve (Burimi: Drejtoria Arsimore, 2004)

	Qarku	Kurbin	Lezhë	Mirditë
Gjithsej (nr)	100	30	33	37
Femra (nr)	23	9	7	7
Femra (%)	23	30	21	18,9

Drejtues arsimit sipas rretheve (Burimi: Drejtoria Arsimore, 2004)

	Kurbin	Lezhë	Mirditë	Qarku	Republika
Forca pune (gjithsej)	18.844	26.798	14.806	60.439	1.089.000
Femra%	43	40	42	41,6	39
Të punësuar	10.557	23.237	10.960	44.754	92.600
Femra%	30,5	40,5	44	39,4	37
Pa punë gjithsej	8.287	3.552	3.846	15.685	163.030
Femra%	49	51	36	46,6	47

Bilanci i punësimit të femrave (Burimi: INSTAT 2003)

	Bujqësi	Industri	Ndërtim	Tregti	Transport	Hoteleri	Peshkim	Arsim	Shëndet	Tjetër
Gjithsej	31.399	1.344	3.455	4.698	2.980	1.761	87	2.621	1.233	10.518
Femra %	43	30	23	69	24	33	6.8	61	71	40

Punësimi sipas aktiviteteve ekonomike (Burimi: INSTAT 2001)

	Pa diplomë	Filllore	8 vjeçare.	Mesme e përgj.	M prof.	Universitet	Gjithsej Qarku
Gjithsej	9.806	68.173	2.837	18.936	6.554	4.248	10.968
Femra %	68	51	42	50	45	38	56.807
Gj. Qytet	1.936	16.060	1.051	8.893	3.455	2.842	34.237
Femra%	71	52	46	53	48	38	17.797
Gj. Fshat	6.970	52.113	1.876	10.070	3.009	1.406	75.444
Femra %	67	51	40	48	42	39	39.010

Të punësuar sipas nivelit të shkollimit (Burimi: INSTAT 2001)

Njësia	Nr. i punonjësve të administratës		Nr. i Këshilltarëve	
	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra
Bashkia Lezhë	45	14	25	3
Prefektura Lezhë	47	14	-	-
Qarku Lezhë	38	11	42	-
Bashkia Laç	52	25	25	3
Bashkia Mamurras	30	10	25	2
Bashkia Rrëshen	39	15	17	2
Bashkia Rubik	21	10	17	1
Komuna Zejmen	15	6	15	-
Komuna Shënkoll	21	4	17	-
Komuna Kolsh	11	2	13	-
Komuna Shëngjin	17	6	15	1
Komuna Balldre	17	7	15	-
Komuna Dajç	14	-	15	1
Komuna Blinisht	12	1	15	1
Komuna Kallmet	14	6	15	-
Komuna Ungrej	12	2	13	1
Komuna Milot	24	10	15	1
Komuna Fush-Kuqe	17	5	15	-
Komuna Kthellë	13	5	15	-
Komuna Kaçinar	9	2	15	-
Komuna Selitë	12	2	13	1
Komuna Fane	14	3	15	-
Komuna Orosh	12	8	15	-
Gjithsej	468	147	387	17

Raporti i femrave në administratë (Burimi: KQ, 2004)

	Gjithsej	Meshkuj	Femra	% Femra
Ligjvënës, nëpunës të lartë, drejtues	232	227	5	2,1
Specialistë	1.351	1.049	302	22
Teknikë+nd/specialistë	3.254	1.507	1.747	53
Nëpunës të thjeshtë	2.819	1.525	1.294	45
Punëtorë të pakualifikuar	3.741	2.853	888	42

Punësimi sipas profesioneve (Burimi: INSTAT 2001)

Bashkia/komuna	Nr. mjekëve të përgjithshëm	Nr mjekëve peditër
Bashkia Lezhë	6	3
Komuna Shëngjin	4	
Komuna Balldre	5	
Komuna Shënkoll	4	
Komuna Zejmen	4	
Komuna Manati	2	
Komuna Kallmet	3	
Komuna Dajç	2	
Komuna Blinisht	2	
Komuna Kashnjet	1	
Bashkia Rrëshen	4	2
Bashkia Rubik	4	1
Komuna Fane	2	
Komuna Orosh	1	
Komuna Kthellë	1	
Komuna Kurbnesh	1	
Komuna Kaçinar	1	
Bashkia Laç	8	4
Bashki Mamurras	7	2
Komuna Milot	3	1
Komuna Fushë Kuqe	3	
Totali	68	13

Gjendja e shëndetësisë në Qark (Drejtorja e Shëndetit Publik 2004)

Monumentet e natyrës ³

Rrethi Lezhë

1. Rëra e Hedhur
2. Rrapi i Grykës
3. Rrepet e Kolshit
4. Shpella e Hutit
5. Shpella e Sukës së Vogël
6. Dritarja tektonike e Mirditës
7. Rivat e Drinit
8. Këneta e Kashtës
9. Rivat e Drinit
10. Rrapi i Pirajave (Blinisht)
11. Lisi i Markatomajt
12. Pylli (dushk, frashër, shkozë) i Shënmërisë Kallmet (1 ha)

Rrethi Mirditë

1. Kanioni i Shehut të Keq
2. Shpella Kusia e Nue Gjonit
3. Rrobulli i Blaçit
4. Guri i Gjonit
5. Guri i Nuses
6. Kroi i Bardhë
7. Mrizi i Shënaprenës
8. Rrapi i Kaçinarit
9. Lisat e Shpalit
10. Lisat e Marpepës

Rrethi Kurbin

1. Tarraca Detare e Laçit
2. Gryka e Shkopetit
3. Frashëri - Kurbin
4. Lisat e Shënmillit
5. Plepi i Bardhë
6. Shpella e Shënavlashit (Shënandoi)
7. Gështenja e Vjetër
8. Rrapi i Daulles
9. Burimi i Vinjollit
10. Ishulli i Cabakut
11. Kordoni litoral i Bregut të Ri
12. Selvitë e Shënmërisë

³ Shpallur me Vendim, Nr.676, datë 20.12.2002, për shpalljen zonë e mbrojtur të monumenteve të natyrës shqiptare

